



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Prefekturën e Qarkut Korçë

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE” PREFEKTURA E QARKUT KORÇË

Tiranë, shtator 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtimet	3
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-8
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit në Prefekturën e Qarkut Korçë	4-5
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-6
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-8
II	HYRJA	8-12
1	Objektivat dhe qëllimi	8
2	Identifikimi i çështjes	8-9
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
4	Përgjegjësitë e audituesve	9
5	Kriteret e vlerësimit	9
6	Standardet e auditimit	10-11
7	Metoda e auditimit	11-12
8	Dokumentimi i auditimit	12
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12-93
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Prefektura e Qarkut Korçë	12-14
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	14-93
2.1	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2022-2023	14-26
2.2	Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve për periudhën 01.01.2022-31.12.2023	26-38
2.3	Auditim mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.	38-93
IV	REKOMANDIME	94-101

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MB	Ministria e Brendshme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
KB	Këshill Bashkiak
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
OE	Operator Ekonomik
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit të zhvilluar në Prefekturën e Qarkut Korçë.

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Prefektura e Qarkut Korçë është një institucion qendror në nivel vendor i cili funksionon në zbatim të Ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut” dhe akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e administratës shtetërore dhe nëpunësve civil.

Misioni i Prefektit është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave në nivel qarku. Prefekti për veprimtarinë e vet përgjigjet përpara Këshillit të Ministrave, Kryeministrit dhe Ministrave.

Për periudhën e audituar nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2023, menaxherët kryesorë të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë sipas nivelit të organizimit janë: ish-Prefekti z. Dh. S. deri më datë 14.04.2022, dhe më pas Prefekti z. N. J., në cilësinë Nëpunësit Autorizues dhe znj. V. M., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: Përmbledhja ekzekutive; Hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; Përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 3 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen Gjetjet dhe Rekomandimet dhe në fund janë Anekset.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Rëndësia e auditimit të përputhshmërisë të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë për periudhën e aktivitetit 2022-2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor, konsiston dhe në kontrollin e përdorimit sa më efektiv e transparent të fondeve të akorduara, të burimeve në përdorim të këtij institucioni, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe të ndihmojë nëpërmjet rekomandimeve të dhëna për përmasimin e sistemeve.

Pra prefekturat janë subjekt i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien dhe administratës publike.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Qëllimi është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me përdorimin e fondeve publike dhe verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Prefektura e Qarkut Korçë funksionon në bazë Ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”; Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, akteve ligjore/nënligjore dhe rregullores së brendshme. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2022-2023;
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2023;

- Auditim mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 917 mijë lekë i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave konstatohet se, institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 12 gjetje dhe ka dhënë 12 rekomandime të cilat janë klasifikuar në kategorinë masa organizative.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

- Për vitet 2022-2023 në katër raste Prefekti i Qarkut Korçë nuk i është drejtuar gjykatës kompetente duke kërkuar deklarimin e pavlefshmërisë së këtyre akteve të rishqyrtuara;
- Nga auditimi me zgjedhje i akteve normative të miratuara nga Prefekti i Qarkut Korçë për periudhën objekt auditimi, konstatohet se janë konfirmuar 13 akte normative të cilat nga bashkitë janë dërguar me mangësi në dokumentacionin shoqërues respektivisht: 5 akte me objekt dhënien me qira të sipërfaqeve (ngastrave) të fondit pyjor kullosor pa statusin juridik të pronës, plan vendosjet dhe raportet teknike; 1 akt-normativ për dhënien e ndihmës ekonomike pa formularët e aplikimit dhe të përzgjedhjes fitues nga përfituesit e ndihmës ekonomike dhe 7 akte normative për dhënien e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore pa vërtetimin për rënie zjarri, çertifikatat familjare, urdhrat për ngritjen e komisioneve për konstatimin e dëmit, procesverbalet për konstatimin e dëmeve etj.
- Në 1 rast Prefekti i Qarkut Korçë ka miratuar në heshtje Vendimin nr. 111, datë 30.06.2022, të KB Korçë “Miratimin hapje dritare në pronë shtet”, pra nuk ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore apo rishqyrtimin e këtij akti.
- Nga Prefekti i Qarkut Korçë për vitet 2022-2023, në 6 raste është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë të akteve të organeve të njësisive të vetëqeverisjes vendore i pabazuar në ligj.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

- Prefekti i Qarkut Korçë t'u drejtohet në rrugë institucionale organeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit të vet që, pranë institucionit të prefektit duhet të paraqiten për verifikimin e ligjshmërisë, vetëm aktet me karakter normativ;
- Prefektura e Qarkut Korçë të marrë masa që të mos pranojë dhe konfirmojë aktet normative të dërguara nga bashkitë të pa shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm justifikues i cili garanton se vendimarrja ka respektuar të gjitha përcaktimet ligjore kur jepet në përdorim apo shfrytëzim një pasuri publike. Gjithashtu, të kërkohet nga bashkitë që i gjithë dokumentacioni i dërguar nga bashkitë të jetë i inventarizuar dhe me listën e dokumentacionit që përmban dosja;
- Nga Prefekti i Qarkut Korçë të merren masa në vazhdimësi që, mos të lejojë kalimin në heshtje të akteve me karakter normativ, por të shprehet lidhur mbi bazueshmërinë ligjore të tyre;
- Prefektura e Qarkut Korçë të marrë masa për rikthimin, shqyrtimin e akteve normative në fushën e tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarburet dhe derivatet e tyre, të cilat kanë të bëjnë me uljen e tarifave vendore në rastet e zëvendësimit të liçencës përgjatë vitit të fundit të mandatit të kryetarit të bashkisë, me qëllim mos favorizimin e subjekteve të caktuara në vitin e fushatës zgjedhore.
- Nga Prefekti i Qarkut Korçë të analizohet situata dhe të merren masa që në vazhdimësi së bashku me Sektorin Juridik, për ato akte të cilat janë të pa bazuara në ligj të natyrës për caktimin e kuotave ushqimore për kopshtet dhe çerdhet, ngritjen e këshillave vendor, të kthehen për rishqyrtim drejt Këshillave Bashkiak përkatës për t'u bërë saktësimi i bazës ligjore dhe më pas të shprehet për bazueshmërinë e tij.
- Prefektura e Qarkut Korçë të marrë masa për shqyrtimin e kujdesshëm të dokumentacionit dhe hapave që kanë ndjekur Bashkitë në çështjet e dhënien së lejeve të ndërtimit pa kaluar në sistemin e-leje dhe tejkalimin e afateve për dhënien me qira të pasurisë shtetërore, duke mos u mjaftuar vetëm me faktin e bazës ligjore të cituar në vendime apo relacione, por të verifikohet edhe në mënyrë të dokumentuar se janë ezauruar të gjitha këto përcaktime ligjore, përpara vendimarrjes për përfundimin e procesit.
- Prefektura e Qarkut Korçë të marrë masa për rikthimin, shqyrtimin e akteve normative në fushën e dhënies së ndihmës financiare për përbalimin e fatkeqësive natyrore, të cilat kanë pasaktësi në përllogaritjen e preventivave të vlerësimit të dëmit, me qëllim dhënien e shpërblimit financiar në përputhje me legjislacionin e emergjencave civile.

3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:

Për auditimin e përputhshmërisë:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit "Prefektura e Qarkut Korçë" për periudhën 01.01.2022, deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, c) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

Opinioni:

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit "Prefektura e Qarkut Korçë" janë

*evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**, e shprehur kjo në bazën për opinion.*

Baza për opinionin e kualifikuar:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e opinionit të modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë dhe vlerën e materialitetit prej 917 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2023, si dhe anomalitë e mëposhtme:

-Në zbatimin e procedurave të prokurimit është konstatuar se: Në 2 raste janë vendosur kritere jo në përputhje me shërbimin/investimin e kërkuar, nuk janë të argumentuara dhe çënojnë pjesëmarrjen e OE të interesuar; në 2 raste nuk argumentohet mënyra e përlllogaritjes së fondit limit; në 1 rast OE nuk ka përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në ftesën për ofertë; në 2 raste nuk mallrat nuk janë bërë hyrje në institucion brenda afateve të përcaktuara në kontratën e furnizimit;

-Nuk ka të dokumentuar kërkesat për nevojat buxhetore nga secili sektor, por rezultoi se PBA-të dhe Plani Vjetor hartohen duke u mbështetur në realizimin e zërave buxhetorë të dy viteve pararendëse;

-Ka diferenca të vlerave të PBA-ve dhe të Projektplaneve Vjetore si në raport me planin fillestar ashtu edhe me atë të ndryshuar, që në gjykimin e grupit të auditimit tregon për planifikim jo të studiuar të fondeve buxhetore në PBA mbi nevojat e institucionit, duke mos u mbështetur në kërkesat e strukturave, por vetëm në realizimet e viteve të mëparshme;

-Në disa raste nga Prefekti i Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore për të cilat nuk konsiderohen si akte me karakter normativ por si akte administrative individuale dhe kolektive;

-Për vitet 2022-2023 nuk janë marrë masat për verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve normative brenda afatit të parashikuar në ligj (çdo tre muaj);

-Për vitet 2022-2023, nga Prefekti i Qarkut Korçë nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e Organit Këshillues;

-Për vitet 2022-2023 në 4 raste Prefekti i Qarkut Korçë nuk është drejtuar gjykatës kompetente duke kërkuar deklarin e pavlefshmërisë së këtyre akteve të rishqyrtuara;

-Për vitet 2022-2023 nga Prefekti i Qarkut Korçë janë konfirmuar **13 akte** normative të cilat nga bashkitë janë dërguar me mangësi në dokumentacionin shoqërues respektivisht: **5** akte me objekt dhënien me qira të sipërfaqeve (ngastrave) të fondit pyjor kullësor pa statusin juridik të pronës, plan vendosjet dhe raportet teknike; **1** akt normativ për dhënien e ndihmës ekonomike pa formularët e aplikimit dhe të përzgjedhjes fitues nga përfituesit e ndihmës ekonomike dhe **7** akte normative për dhënien e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore pa vërtetimin për rënie zjarri, çertifikatat familjare, urdhrat për ngritjen e komisioneve për konstatimin e dëmit, procesverbalet për konstatimin e dëmeve etj.;

-Në 1 rast për Vendimin nr. 111, datë 30.06.2022, të Këshillit Bashkiak Korçë është miratuar nisja e punimeve në pronën shtetërore, për të cilin Prefekti i Qarkut Korçë nuk ka konfirmuar apo refuzuar konfirmimin mbi bazueshmërinë ligjore;
-Nga Prefekti i Qarkut Korçë për vitet 2022-2023, në 6 raste është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë të akteve të organeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore i pabazuar në ligj.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 563/2 prot., datë 31.05.2024, i ndryshuar me shkresën nr. 563/3 prot., datë 25.06.2024, dhe shkresën nr. 563/4 prot., datë 07.11.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 03.06.2024, deri më 26.07.2024, në institucionin Prefektura e Qarkut Korçë u krye auditimi “Mbi përputhshmërinë” për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2023. Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. M. H, (Përgjegjës grupi)
2. K. G, anëtar
3. B. Sh, anëtar

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit: Objekti i auditimit të përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar, i cili do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Në përfundim të auditimit, do hartohet Raporti Përfundimtar i Auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë.

2. Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në ç’masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të Prefekturës dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Prefektit të Qarkut Korçë.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura

auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Prefektit të Qarkut Korçë.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Prefekti i Qarkut Korçë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisë publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, si dhe shprehjen e ligjshmërive të vendimeve të këshillave bashkiak.

Prefekti nëpërmjet konfirmimit ose jo të vendimeve të KB, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore fondet speciale të tyre, administrimin e pronave publike të bashkive etj.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit “Prefektura Qarkut Korçë” për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet:

a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;

b) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar;

c) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, vlerësimi dhe alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Prefektit të Qarkut Korçë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të

sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit: Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Prefekturës së Qarkut Korçë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Prefekturës së Qarkut Korçë. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj.;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI, INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit*”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur (IFAC);
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm etj.;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”;
- Ligji nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “*Për prefektin*”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunëve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabinetëve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit*” i ndryshuar;
- VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*”;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar;
- Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 27.09.2019, “*Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore*”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar;
- Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” i ndryshuar;
- Urdhri i Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017, “*Për miratimin e detyrave të Administratës së Prefektit të Qarkut*”;
- Rregullore e Brendshme “*Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH*”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 197, datë 12.10.2022;
- Rregullore e Brendshme “*Mbi procedurat e auditimit në KLSH*”, miratuar me Vendimin nr. 7, datë 17.01.2024, të Kryetarit të KLSH;
- Rregullore mbi organizimin e funksionimin e Institucionit të Prefektit etj.

6. Standardet e auditimit: ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj.; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodat e auditimit: Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin¹. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

¹ *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushruar ekzaminohet përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët:

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepcave ose të çdo regjistrimi tjetër.

6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “Jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

7. Verifikimi i transaksioneve:

Është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

8. Intervistimi:

Është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

9. Raporte dhe informacione:

Janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

10. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm:

Grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit: Është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme.

Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të aktkonstatimeve, u përgatit Projektraporti i Auditimi i cili u dërgua në subjekt me shkresën nr. 563/6, datë 09.08.2024. Nga ana e Prefekturës së Qarkut Korçë janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr. 343/17 prot., datë 13.09.2024. Në përfundim nga audituesit u përgatit Raporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Prefektura e Qarkut Korçë.

Misioni i Prefektit të Qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave, në nivel qarku. Prefekti i Qarkut është përfaqësues i Këshillit të Ministrave, në nivel qarku. Prefektura e Qarkut Korçë funksionon në bazë të Ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”; Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, akteve ligjore/nënligjore dhe rregullores së brendshme.

✓ 1912-1924

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Qeveria shqiptare bëri organizimin administrativ të sanksionuar në “Kanunin e Përtashëm të Administratës Civile të Shqipërisë” të shpallur më 22 nëntor 1913. Vendi u nda në prefektura dhe krahina. Prefekturat ishin tetë: Berati, Dibra, Durrësi, Gjirokastra, Elbasani, Korça, Shkodra dhe Vlora.

✓ 1925-1945

Organizimi dhe funksionimi i administratës vendore u përcaktua sipas ligjit organik të Bashkisë, të miratuar më 1921 dhe më pas me Kodin Civil të miratuar gjatë vitit 1928. Nënprefektura ishte njësi administrativo-territoriale, me funksione administrative. Prefektura ishte njësi më e madhe e qeverisjes vendore e drejtuar nga Prefekti, i cili emërohej nga Ministri i Brendshëm dhe aprovohej nga Kryeministri dhe më pas nga Mbreti. Nënprefekti propozohej nga Prefekti.

Prefekti kishte funksione ekzekutive. Në Prefekturë e Nënprefekturë mungonin organet e zgjedhura. Këshilli Administrativ i Prefekturës përbëhej nga shefat e zyrave dhe nga disa (si rregull 2) anëtarë të zgjedhur nga populli për dy vjet.

Në vitin 1927 Shqipëria kishte 10 Prefektura, 39 Nënprefektura dhe 69 krahina me 2351 fshatra. Në vitin 1934 kishte 10 Prefektura, 30 Nënprefektura, 160 Komuna, me 2351 fshatra. Në vitin 1940 kishte 10 Prefektura 30 Nënprefektura, 23 Bashki, 136 Komuna dhe 2551 fshatra.

✓ 1945-1992

Pas vitit 1945, u bënë shumë ndryshime në strukturën e ndarjes administrative. Në këtë periudhë kishte 10 Prefektura dhe 61 Nënprefektura. Në vitin 1946 u bë ndarja e re Administrative me 10 Prefektura, 39 Nënprefektura. Në vitin 1947 u suprimuan Nënprefekturat dhe në vitin 1953 Qarku zëvendësoi Prefekturën.

✓ Prefektët 1992 dhe në vijim:

Më pas në bazë të Ligjit nr. 7608, datë 22.09.1992, “ Për prefekturat” u krijuan 12 Prefektura si njësi që drejtohen nga Këshilli i Ministrave.

✓ Fushat e veprimtarisë së Institucionit të Prefektit të Qarkut:

- Marrëdhëniet e Prefektit të Qarkut me degët territoriale;
- Verifikimi i ligjshmërisë së akteve;
- Verifikimi i përgjegjësive të deleguara;
- Shqyrtimi i ankesave dhe zgjidhja e konflikteve;
- Emergjencat Civile.

Prefektura e Qarkut të Korçës është një nga 12 prefekturat në Shqipëri me një sipërfaqe prej 3.711 km². Prefektura e Qarkut Korçë përfshinë Bashkitë Korçë, Pogradec, Devoll, Kolonjë, Maliq dhe Pustec. Qendra e Qarkut të Korçës ndodhet në qytetin e Korçës. Qarku i Korçës kufizohet në verilindje dhe në lindje me Maqedoninë, në jug me Greqinë në jugperëndim me Qarkun e Gjirokastrës, në perëndim me Qarkun e Beratit dhe në veriperëndim me Qarkun e Elbasanit. Qarku i Korçës ka një popullsi prej 258,100 banorë.

✓ **Forma dhe mënyra e organizimit:**

Struktura organizative e miratuar, sipas pasqyrës si vijon:

- Prefekti i Qarkut Korçë
- Nënprefekti Pogradec, Kolonjë dhe Devoll
- Sekretari i Përgjithshëm
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
- Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara
- Sektori i Zhvillimit Urban
- Sektori Juridik
- Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave
- Zyra e Gjendjes Civile Korçë, Kolonjë, Devoll dhe Pogradec

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2022-2023.

2.1.1. Programimi i PBA-së dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023.

- Nga Prefekti i Qarkut Korçë nuk kanë dalë urdhrat për ngritjen e grupit të punës për hartimin e PBA-së për çdo fazë të tij, gjë e cila është shoqëruar edhe me mungesën e takimeve për çdo fazë të përgatitjes së PBA-ve, edhe me mos nxjerrjen e urdhrave nga ana e Titullarit të institucionit për ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP).

- Nuk ka të dokumentuar kërkesat për nevojat buxhetore nga secili sektor, por konstatohet se PBA-të dhe Plani Vjetor hartohen duke u mbështetur në realizimin e zërave buxhetorë të dy viteve pararendëse.

- Ndonëse nga Titullari kanë dalë për çdo vit urdhrat për ngritjen e GMS me nr. 6, datë 14.01.2022, me shkresën nr. 34 prot., datë 14.01.2023, dhe nr. 14, datë 08.03.2023, me shkresën nr. 252 prot., datë 08.03.2023, nga auditimi konstatohet se nuk ka takime të dokumentuara të GMS për të diskutuar mbi tavanet buxhetore dhe nevojave të institucionit për investime.

Tabela nr. 1: Programimi i shpenzimeve në PBA 2022-2024/2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve.

Nr.	PBA 2022-2024 Shpenzimet sipas programeve	Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024	
		Vlera	% ndaj totalit	Vlera	% ndaj totalit	Vlera	% ndaj totalit
1	Administrata e Prefektit të Qarkut	47,100	94	55,850	95	47,400	94
2	Gjendja Civile	3,000	6	3,065	5	3,165	6

Nr.	PBA 2023-2025 Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		Vlera	% ndaj totalit	Vlera	% ndaj totalit	Vlera	% ndaj totalit
1	Administrata e Prefektit të Qarkut	43,200	90.6%	44,100	90.6%	44,100	90.6%
2	Gjendja Civile	4,450	9.4%	4,550	9.4%	4,550	9.4%

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Nga analiza e detajuar e informacionit të pasqyruar edhe në tabelë, konstatohet se diferencat e buxheteve nga një vit në tjetrin për secilën PBA, ka ardhur si rezultat i planifikimit të këtyre shpenzimeve:

- Shtesa e pagave sipas VKM-ve të realizuar në vitin 2023;
- Pajisje kompjutera, fotokopje, lidhja në rrjet e pajisjeve, vendosja e kondicionerëve nëpër zyrat e institucionit, që i përkasin llogarisë 231 “Investime” në vlerën 2,700 mijë lekë;

Kërkesa e dytë si e përcaktuar, nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë përsëriten çdo vit me hartimin e PBA dhe Planit Vjetor.

Ndërsa programet buxhetore të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë për buxhetin e vitit 2022 si viti i parë në PBA 2022-2024 dhe vitit 2023 si vit i parë në PBA 2023-2025, hartuar dhe miratuar nga MB referuar programeve të miratuara nga MFE për t'u patur në konsideratë nga Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme gjatë përgatitjes së PBA-ve, pasqyrohen si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 2.

000/Lekë

Udhëzimi nr. 7 datë 25.02.2022			Kodi buxhetuar	Emërtimi i Programit Buxhetor	Viti 2022		Viti 2023	
Funksioni	N/ Funksioni	Kodi Programit			Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	011	01160	1160	Prefektura e qarkut Korçë	35,680	34,294	42,902	40,996
		01170	1170	Gjendja Civile	4,083	3,723	5,150	4,839
20 Programe				2 Programe	39,763	38,017	48,052	45,835

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Nga auditimi konstatohet se Prefektura e Qarkut Korçë ka planifikuar fonde për dy programe: Prefekti i Qarkut Korçë dhe Gjendja Civile.

Për vitin 2022 buxheti i miratuar në total është në vlerën 39,763 mijë lekë dhe për vitin 2023 është planifikuar në vlerën totale 48,052 mijë lekë ose 8,289 mijë lekë më shumë se ai i vitit 2022. Gjithashtu dhe realizimi i buxhetit ka ardhur në rritje nga viti 2022 në vitin 2023 me 7,818 mijë lekë. Për vitin 2022 realizim plan/fakt është në masën 95.6% dhe për vitin 2023 është në masën 95.3%.

Programet afatmesme janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin nr. 57, datë 02.06.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008”. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

Tabela nr. 3: Ndarja e shpenzimeve sipas zërave buxhetorë në PBA 2022-2024/2023-2025.

000/Lekë

Nr.	PBA 2023-2025 Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		Vlera	% ndaj totalit	Vlera	% ndaj totalit	Vlera	% ndaj totalit
1	Paga (600)	29,800	62.5	30,350	62.4	31,050	63.8
2	Sigurime (601)	5,150	10.8	5,300	10.9	5,600	11.5
3	Shpenzime operative (602)	10,000	20.9	11,000	22.6	11,000	22.6
4	Shpenzime për investime (231)	2,700	5.8	2,000	4.1	1,000	2.1
5	Transferta për buxhetet familjare dhe individët (600)	0	0	0	0	0	0
	Totali	47,650	100	48,650	100	48,650	100

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Nga analiza e detajuar e informacioni të pasqyruar edhe në tabelën e mësipërme konstatohet se, në PBA 2022-2024 peshën më të madhe në buxhet e ka llogaria 600 “Paga dhe përfitimet e punonjësve” nga 62.4% deri në 63.8% dhe peshën më të vogël e ka llogaria 231 “Investime” nga 2.1% deri në 5.8%. Gjithashtu llogaria 600 “Paga dhe përfitimet e punonjësve” ka rritje të ndjeshme në buxhet nga viti në vit parashkuar në këtë zë.

Tabela nr. 4.

000/Lekë

Nr.	PBA 2024-2026 Shpenzimet sipas programeve	Viti 2024		Viti 2025		Viti 2026	
		Vlera	% ndaj totalit	Vlera	% ndaj totalit	Vlera	% ndaj totalit
1	Paga (600)	39,600	68.7	40,700	68.9	41,300	69.1
2	Sigurime (601)	6,780	11.7	7,400	12.5	7,950	13.3
3	Shpenzime operative (602)	8,500	14.8	9,000	15.2	9,500	15.9
4	Shpenzime për investime (231)	2,700	4.8	2,000	3.4	1,000	1.7
5	Transferta për buxhetet familjare dhe individët (600)	0	0	0	0	0	0

Totali	57,580	100	59,100	100	59,750	100
---------------	---------------	------------	---------------	------------	---------------	------------

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Nga analiza e detajuar e informacioni të pasqyruar edhe në tabelën e mësipërme konstatohet se, në PBA 2023-2025 peshën më të madhe në buxhet e ka llogaria 600 “Paga dhe përfitimet e punonjësve” nga 68.7% deri në 69.1% dhe peshën më të vogël e ka llogaria 231 “Invesitme” nga 1.7% deri në 4.8%. Gjithashtu llogaria 600 “Paga dhe përfitimet e punonjësve” ka rritje të ndjeshme në buxhet nga viti në vit parashkuar në këtë zë.

Ndërsa shpenzimet buxhetore të planifikuara dhe realizuara në institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë për planin e buxhetit të vitit 2022 si viti i parë në PBA 2022-2024 dhe vitit 2023 si viti i parë në PBA 2023-2025, pasqyrohen si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 5.

000/Lekë

Emërtimi i shpenzimit	Viti 2022		Diferenc	Realizimi në %	Viti 2023		Diferenca	Realizimi në %
	Plan	Fakt			Plan	Fakt		
600	25,745	24,850	895	96.5	33,645	33,412	233	99.3
601	4,529	4,100	429	90.5	5,620	5,544	76	98.6
602	8,529	8,107	422	95.1	8,687	6,829	1,858	78.6
230-231	0	0	0	0	0	0	0	0
606	960	960	0	100	100	50	50	50
466	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	39,763	38,017	1,746	95.6	48,052	45,835	2,217	95.4

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Duke bërë analizën e të dhënave të tabelës sa më sipër konstatohet se:

- Për vitin 2022 peshën kryesore në buxhet e zë llogaria 600 “Paga dhe përfitimet e punonjësve” në vlerën 25,745 mijë lekë dhe peshën më të vogël e zë llogaria 606 “Transferime për buxhetet familjare e individë” në vlerën 960 mijë lekë. Pesha specifike e llogarive 600 “Paga dhe përfitimet e punonjësve”, 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” të shpenzimeve të shpenzimeve ndaj totalit të shpenzimeve është 30,274 mijë lekë ose në masën 76.1%, ndërsa llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime” dhe 606 “Transferime për buxhetet familjare e individë” zënë 23.9% të totalit të buxhetit të planifikuar.

- Për vitin 2023 peshën kryesore në buxhet e zë llogaria 600 “Paga dhe përfitimet e punonjësve” në vlerën 33,645 mijë lekë dhe peshën më të vogël e zë llogaria 606 “Transferime për buxhetet familjare e individë” në vlerën 100 mijë lekë. Pesha specifike e llogarive 600 “Paga dhe përfitimet e punonjësve”, 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” të shpenzimeve të shpenzimeve ndaj totalit të shpenzimeve është 39,265 mijë lekë ose në masën 81.7%, ndërsa llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime” dhe 606 “Transferime për buxhetet familjare e individë” zënë 18.3% të totalit të buxhetit të planifikuar. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e nevoja të Sektorëve të Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë.

PBA 2022-2024/2023-2025 dhe Buxheti vjetor për vitet 2022/2023 kanë pësuar këto ndryshime si më poshtë:

Tabela nr. 5.

Nr.	PBA 2022-2024	P. Buxheti 2022
1	Nr. 601/6 prot., datë 14.02.2022	
2	Nr. 2810/10 prot., datë 15.04.2022	
3	Nr. 4858/1 prot., datë 18.05.2022	
4	Nr. 4355/3 prot., datë 07.06.2022	
5	Nr. 7664/2 prot., datë 09.08.2022	
6	Nr. 8701/3 prot., datë 13.09.2022	
7	Nr. 8334/4 prot., datë 17.10.2022	
8	Nr. 11025/4 prot., datë 10.11.2022	
9	Nr. 13504/3 prot., datë 17.01.2023	

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Ndryshimet e propozuara dhe të miratuara nga MB në buxhetin e Prefekturës së Qarkut Korçë për vitet 2022-2023, kanë pasqyruar lëvizjet në buxhet sipas kodeve të programit, kapitullit, artikullit e vlerës, të cilat janë shoqëruar edhe me relacionet përkatëse, konform Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Pra miratimet nga MB për PBA/Buxhetin vjetor dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit ushtrimor, janë miratuar konform koadrit ligjor në fuqi.

➤ Planifikimet sipas PBA-së me ndryshimet:

Tabela nr. 6.

000/Lekë

Emërtimi	PBA 2022-2024		Buxheti 2022		PBA 2023-2025		Buxheti 2023	
	Të ardhura	Shpenzime	Të ardhura	Shpenzime	Të ardhura	Shpenzime	Të ardhura	Shpenzime
Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës								
Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës								
Trashëguar nga Transferta specifike								
Plani i të ardhurave viti ushtrimor								
Granti								
Transferta specifike								
Paga (600)		29,800		25,745		40,700		33,645
Sigurime shoqërore (601)		5,150		4,529		7,400		5,620
Shpenzime operative (602)		10,000		8,529		9,000		8,687
Transferta (604+606+609) Fondi Rezervë		2,700		960		2,000		100
Inv (230 +231)		0		0		0		0
Investime nga FZHR e M. Linjës		0		0		0		0
Të tjera (166, 651, 603, 604, 606)		0		0		0		0
Totali		47,650		39,763		59,100		48,052

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Planifikimi buxhetor mbështetet në fondet që planifikon dhe akordon për Prefekturën e Qarkut Korçë, MB nga buxheti i saj në 2 programet përkatëse me kodet 01160 dhe 01170. Nga auditimi konstatohet se, Prefektura e Qarkut Korçë nuk trashëgon për vitin pasardhës fonde të papërdorura në llogarinë e vet.

Planifikimi i buxheteve të Prefekturës së Qarkut Korçë për vitet 2022 dhe 2023 është bërë në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimeve të MFE dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021 etj.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga MB me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo vit buxhetor.

Tabela nr. 7.

000/Lekë

Artikulli	Emërtimi/2022	Plani	Nryshimet shtesa	Ndryshim pakësim	Plani ndryshime	Realizimi	Diferenca	%
600	Paga shpizime të tjera	23,745	500	1,760	22,485	21,763	722	96.8
601	Kont.sig.shoq shënd	4,013		110	3,903	3,585	318	92
602	Mallra e shërbim	9,212		840	8,372	8,026	346	95.9
606	Trans. Buxh. Familjar	0	920		920	920	0	100
231	Shpenz per investime	0	0	0	0	0	0	
01160	Shuma	36,970	1,420	2,710	35,680	34,294	1,386	96.1
600	Paga shpiz.tjera	2,400	860		3,260	3,086	174	94.7
601	Kont. Sig.shoq shënd	470	156		626	516	110	82.4
602	Mallra e shërbime	0	157		157	81	76	52
606	Trasfert tek individet	0	40		40	40	0	100
01170	Shuma	2,870	1,213		4,083	3,723	360	91
Buxheti TOTALI		39,840	2,633	2,710	39,763	38,017	1,746	95.6

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Tabela nr. 8.

000/Lekë

Artikulli	Emërtimi/2023	Plani	Nryshimet	Ndryshim pakësim	Plani ndrysh.	Ralizimi	Difer	%
600	Paga shpiz.tjera	24.085	5.360		29.445	29.284	161	99.4
601	Kont. sig.shoq shënd	4.103	777		4.880	4.854	26	99.5
602	Mallra e shërbim	8.477			8.477	6.808	1.669	80.3
606	Trans. buxh. familjar	0	100		100	50	50	50
231	Blerje pajisje zyre	0	0		0	0	0	0

231	Ndërtime rikonstruk.	0	0	0	0	0	0	0
01160	Shuma :	36.665	6.237	42.902	40.996	1.906	96	
600	Paga shpz.tjera	3.400	800	4.200	4.128	72	98,3	
601	Kont. sig.shoq shënd	580	160	740	690	50	93,2	
602	Mallra e sherbim	0	210	210	21	189	10	
606	Trans. buxh. familjar	0			0		0	
01170	Shuma	3.980	1.170	5.150	4.839	311	94	
Buxheti TOTALI:		40.645	7.407	48.052	45.835	2.217	95	

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me Degën e Thesarit Korçë. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të viteve 2022 dhe 2023, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet.

2.1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njëjësive vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës.

Tabela nr. 9.

00/Lekë

Art.	Emërtimi	Prefektura e Qarkut Korçë nga Buxheti i shtetit Viti 2022							Realizimi në %
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti i vitit para ardhës Viti 2021	PBA Plan Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	Çelja në thesar 2022	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
600	Paga	24,545	29,800	26,145	25,745	25,745	24,849	896	96.5
601	Sigurime Shoqërore	4,014	5,150	4,483	4,529	4,529	4,101	428	90.5
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	8,635	10,000	9,212	8,529	8,529	8,107	510	95
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0	0	0	0	0
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0	0	0
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	51	2.700	0	960	960	960	0	0
Nën Totali	Shpenzime Korrente	37,245	46,750	39,840	39,763	39,763	38,017	1,746	95.6
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	0
NënTotali	Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali (korrente + kapitale)		37,245	46,750	39,840	39,763	39,763	38,017	1,746	95.6

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Tabela nr. 10.

000/Lekë

Prefektura e Qarkut Korçë nga buxheti i shtetit Viti 2023									
Art.	Emërtimi	1	2	3	4			(6)=(4)-(5)	Realizimi në %
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	PBA Plan Viti 2023	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	Çelja në thesar 2023	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
600	Paga	24,849	40,700	27,485	33,645	33,645	33,412	233	99.3
601	Sigurime Shoqërore	4,101	7,400	4,683	5,620	5,620	5,544	76	98.6
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	8,107	9,000	8,477	8,687	8,687	6,829	1,858	78.6
603	Subvencione	0	0	0	0		0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0	0	0	0	0
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0	0	0
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individe	960	2,000	0	100	100	50	50	50
Nën-Totali	Shpenzime Korrente	38,017	59,100	40,645	48,052	48,052	45,835	2,217	95.4
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0	0
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	0	0	0
Nën-Totali	Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali (korrente + kapitale)		38,017	59,100	40,645	48,052	48,052	45,835	2,217	95.4

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelat e mësipërme konstatohet se, ka diferenca të vlerave të PBA-ve dhe të Projekt-planeve vjetore si në raport me planin fillestar ashtu edhe me atë të ndryshuar, që në gjykimin e grupit të auditimit tregon për planifikim jo të studiuar të fondeve buxhetore në PBA mbi nevojat e institucionit, duke mos u mbështetur në kërkesat e strukturave por vetëm në realizimet e viteve të mëparshme.

- Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me miratim nga ministria e linjës, të pasqyruara këto edhe në tabelat respektive.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet gjithashtu se analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj; gjatë viteve 2022-2023 është bërë raportimi periodik 4 mujor, 8 dhe 12 mujor i realizimit të buxhetit në MB.²

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitet 2022/2023 konstatohet se PBA 2022-2024 dhe 2023-2025 të jetë realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Ndryshimet e bëra për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve.

2.1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimi. Vlerësimi i risqeve buxhetore.

Shpenzimet buxhetore të planifikuara dhe realizuara në institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë për Planin e buxhetit të vitit 2022 si viti i parë në PBA 2022-2024 dhe vitit 2023 si viti i parë në PBA 2023-2025, pasqyrohen si në tabelën më poshtë:

² Informacioni i detajuar pasqyrohet më poshtë në rubrikën Monitorimi i buxhetit

Tabela nr. 11.

000/Lekë

Emërtimi i shpenzimit	Viti 2022		Diferenc	%	Viti 2023		Diferenca	%
	Plan	Fakt			Plan	Fakt		
600	25,745	24,849	896	96.5	33,645	33,412	233	99.3
601	4,529	4,101	428	90.5	5,620	5,544	76	98.6
602	8,529	8,107	510	95	8,687	6,829	1,858	78.6
230-231	0	0	0	0	0	0	0	0
606	960	960	0	100	100	50	50	50
466	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	39,763	38,017	1,746	95.6	48,052	45,835	2,217	95.4

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Duke bërë analizën e të dhënave të tabelës konstatohet se:

-Për vitin 2022 peshën kryesore në buxhet e zë llogaria “Paga dhe përfitimet e punonjësve” në vlerën 25,745 mijë lekë, 601 “Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” në vlerën 4,529 mijë lekë, 602 “Blerje mallra dhe shërbime” në vlerën 8,529 mijë lekë dhe 606 “Transferime për buxhetet familjare e individë” në vlerën 960 mijë lekë. Llogaritë 600-601 zënë peshën specifike ndaj totalit të buxhetit në vlerën 30,274 mijë lekë ose në masën 76.1% ndërsa llogaritë 602-606 në vlerën 9,489 mijë lekë ose në masën 23.9% të totalit të buxhetit të planifikuar.

Në total buxheti për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 39,763 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 38,017 mijë lekë në masën 95.6% me një diferencë mos realizimi në vlerën 1,746 mijë lekë.

-Llogaria “Paga dhe përfitimet e punonjësve” është planifikuar në vlerën 25,745 lekë dhe realizuar në vlerën 24,849 lekë ose në masën 96.5% me një diferencë mos realizimi në vlerën 896 mijë lekë.

-Llogaria 601 “Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” është planifikuar në vlerën 4,529 lekë dhe realizuar në vlerën 4,101 lekë ose në masën 90.5% me një diferencë mos realizimi në vlerën 428 mijë lekë.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime” është planifikuar në vlerën 8,529 lekë dhe realizuar në vlerën 8,107 lekë ose në masën 95% me një diferencë mos realizimi në vlerën 510 mijë lekë.

-Llogaria 606 “Transferime për buxhetet familjare e individë” është planifikuar në vlerën 960 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 960 mijë lekë ose në masën 100%.

-Për vitin 2023 peshën kryesore në buxhet e zë llogaria “Paga dhe përfitimet e punonjësve” në vlerën 33,645 mijë lekë, 601 “Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” në vlerën 5,620 mijë lekë, 602 “Blerje mallra dhe shërbime” në vlerën 8,687 mijë lekë dhe 606 “Transferime për buxhetet familjare e individë” në vlerën 100 mijë lekë. Llogaritë 600-601 zënë peshën specifike ndaj totalit të buxhetit në vlerën 39,265 mijë lekë ose në masën 81.7% ndërsa llogaritë 602-606 në vlerën 8,787 mijë lekë ose në masën 18.2% të totalit të buxhetit të planifikuar.

Në total buxheti për vitin 2023 është planifikuar në vlerën 48,052 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 45,835 mijë lekë në masën 95.4% me një diferencë mos realizimi në vlerën 2,217 mijë lekë.

-Llogaria “Paga dhe përfitimet e punonjësve” është planifikuar në vlerën 33,645 lekë dhe realizuar në vlerën 33,412 lekë ose në masën 99.3% me një diferencë mos realizimi në vlerën 233 mijë lekë.

-Llogaria 601 “Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” është planifikuar në vlerën 5,620 lekë dhe realizuar në vlerën 5,544 lekë ose në masën 98.6% me një diferencë mos realizimi në vlerën 76 mijë lekë.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime” është planifikuar në vlerën 8,687 lekë dhe realizuar në vlerën 6,829 lekë ose në masën 78.6% me një diferencë mos realizimi në vlerën 1,858 mijë lekë.

-Llogaria 606 “Transferime për buxhetet familjare e individë” është planifikuar në vlerën 100 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 50 mijë lekë ose në masën 50%.

Në fillim të vitit ushtrimor 2022 në strukturën organizative të institucionit kanë qenë 4 vende vakante nga të cilët 2 specialist në Sektorin e Planifikimit Përballimit të Emergjencave Civile dhe dhe Krizave, 1 specialist në Sektorin e Monitorimit të kompetencave Vendore dhe Funksioneve të

Deleguara dhe 1 specialist në Sektorin e Zhvillimit Urban. Gjatë vitin 2022 u krijua 1 pozicion vakant i Sekretarit të Përgjithshëm dhe deri në fund të viti është plotësuar 1 pozicion vakant konkretisht 1 Sektorin e Planifikimit Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave.

Në lidhje me mos realizimin e shpenzimeve për vitin 2023 ka ndodhur për shkak, mos realizimit të procesit të pronave të institucionit në ASHK Korçë për arsye të kthimit dhe mos konfirmimit të planit të rilevimit nga ASHK, ulja e vlerës së kontratës për ruajtjen dhe sigurinë fizike të institucionit me OE "I. G" pas ndryshimeve ligjore në muajin korrik të viti 2023 dhe ulja e konsumit të energjisë elektrike të institucionit.

Për zbatimet e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Korçë si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Korçë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar të vitit, të miratuar nga Buxheti i shtetit ose të diktura nga transferta e deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit, rezulton se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.

2.1.4. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre:

➤ Një pasqyrim mbi parashikimin e të ardhurave të Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë që sigurohen nga veprimtaria e vet sipas PBA respektive, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 12. **Lekë**

A	Të ardhurat e veta PBA 2022-2024	2022	2023	2024
	Fonde të trashëguara			
I	Totali			
1	Transferta e pakushtëzuar			
2	Transferte specifike			
3	Tjera... (Të ardhura nga pullat e Gjendjes Civile)	64,800	56,825	0
II	Shuma e transfertave	64,800	56,825	0
III	Transferta te pritshme (Ministri e linjës)			
	Totali i burimeve të veta (I+II+III)	64,800	56,825	0

Tabela nr. 13. **000/Lekë**

A	Të ardhurat e veta PBA 2023-2025	2023	2024	2025
	Fonde të trashëguara			
I	Totali			
1	Transferta e pakushtëzuar			
2	Transferte specifike			
3	Tjera... (Të ardhura nga pullat e Gjendjes Civile)	56,825	0	0
II	Shuma e transfertave	56,825	0	0
III	Transferta te pritshme (Ministri e linjës)			
	Totali i burimeve të veta (I+II+III)	56,825	0	0

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën sa më sipër konstatohet se, institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë parashikon në PBA vetëm të ardhurat nga pullat e Gjendjes Civile. Vlera e parashikuar me ulje nga viti në vit konkretisht për vitin 2022 në vlerën 64,800 lekë, për vitin 2023 në vlerën 56,825 lekë dhe për vitin 2024 në vlerën 0 lekë.

Të ardhurat e arkëtuara nga aktiviteti i Institucionit në bankat e nivelit të dytë në kredi të llogarisë së të ardhurave/llogaria ekonomike 7081006, i kalojnë Institucionit të PQ Korçë nëpërmjet një kërkesë Degës së Thesarit Korçë në zbatim të VKM nr. 432, datë 28.06.2006, dhe Udhëzimit të përbashkët nr. 2919, datë 21.11.2006 për përdorim të fondeve në masën 100%.

-Nga akt Rakordimi me Degën e Thesarit Korçë në mbyllje të çdo viti buxhetor përfshirë në periudhën tonë audituese, rezultoi si më poshtë:

Tabela nr. 14.

000/Lekë

Nr.	Llogaria e të ardhurës	Emërtimi i të ardhurës	Progresive dhjetor 2022
1	7113013	Nga shitja e dokumenteve të ankandit	0
2	7113099	Të tjera nga mallra e shërbime	0
3	7081006	Taksa e akteve dhe pullave	0
4	7190880	Të tjera jo tatimore	0
Totali			0
Nr.	Llogaria e të ardhurës	Emërtimi i të ardhurës	Progresive dhjetor 2023
1	7113013	Nga shitja e dokumenteve të ankandit	0
2	7113099	Të tjera nga mallra e shërbime	0
3	7081006	Taksa e akteve dhe pullave	0
4	7190880	Të tjera jo tatimore	0
Totali			0

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Akt Rakordimi i datës 05.01.2023, për të ardhurat e vitit 2022 për llogari të Prefekturës së Qarkut Korçë dhe Akt-Rakordimi i datës 04.01.2024, për të ardhurat e vitit 2023 për llogari të institucionit, janë nënshkruar nga specialisti i Degës së Thesarit Korçë, përgjegjës Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse mbështetëse dhe nga Prefekti i Qarkut Korçë.

Nga auditimi i dokumentacionit, librit të bankës dhe informacionit të pasqyruar në tabelë konstatohet se, nga Prefektura e Qarkut Korçë nuk janë parashikuar si të ardhura për t'u arkëtuar vlera e detyrimit të akumuluar ndër vite e ndaj 4 debitorëve, e cila është e regjistruar në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" me një vlerë prej 222,595 lekë.

➤ Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Ministrinë Brendshme:

Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 195/1 prot., datë 13.03.2023, dhe shkresën nr. 264 prot., datë 08.03.2024, ka përcjellë mbylljen e llogarive vjetore për vitet 2022 dhe 2023 në Ministrinë e Brendshme dhe Degës së Thesarit Korçë me shkresën nr. 256 prot., datë 09.03.2023, dhe shkresën nr. 191 prot., datë 21.02.2024. Në zbatim Ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, konstatohet se, janë bërë raportimet 4, 8 dhe 12 mujore mbi situacionet e shpenzimeve, të ardhurave dhe detyrimeve të prapambetura për vitet 2022 dhe 2023 në MB sipas formateve të kërkuara nga MB sipas shkresave si më poshtë:

- Shkresa me nr. 475 prot., datë 09.05.2022, për 4 mujorin me objekt "Dërgohen situacionet e të ardhurave, shpenzimeve dhe tabela nr. 1/3 numrit të punonjësve";
- Shkresa me nr. 832 prot., datë 07.09.2022, për 8 mujorin me objekt "Dërgohen situacionet e të ardhurave, shpenzimeve dhe tabela nr. 1/3 numrit të punonjësve";
- Shkresa me nr. 16 prot., datë 05.01.2023, për 12 mujorin "Dërgohen situacionet e të ardhurave, shpenzimeve dhe tabela nr. 1/3 numrit të punonjësve";
- Shkresa me nr. 396 prot., datë 04.05.2023, për 4 mujorin "Dërgohen situacionet e të ardhurave, shpenzimeve dhe tabela nr. 1/3 numrit të punonjësve";
- Shkresa me nr. 749 prot., datë 31.08.2023, për 8 mujorin me objekt "Dërgohen situacionet e të ardhurave, shpenzimeve dhe tabela nr. 1/3 numrit të punonjësve";
- Shkresa me nr. 66 prot., datë 16.01.2024, për 12 mujorin "Dërgohen situacionet e të ardhurave, shpenzimeve dhe tabela nr. 1/3 numrit të punonjësve";

➤ Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës:

Me miratimin e PBA dhe Planit vjetor buxhetor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë lidhur me fondin rezervë, fondi i kontigjencës, fondi i emergjencës dhe fondi për Covid-19, informacioni si më poshtë:

Tabela nr. 15.

Lekë

Emërtimi	Viti 2022		Viti 2023	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Fond Rezervë	0	0	0	0

Fond Emergjence	0	0	0	0
Fond Kontigjence	0	0	0	0
Mbrojtja Civile	0	0	0	0
Fonde për Covid 2019	0	0	0	0
Totali	0	0	0	0

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si Ministrinë e linjës etj.).

1. Në PBA 2022-2024/2023-2025 dhe Planin vjetor 2022/2023, Prefektura e Qarkut Korçë nuk ka planifikuar fonde buxhetimi për programin “likujdimi i detyrimeve të prapambetura”, pasi PQ Korçë nuk ka detyrime të prapambetura:

Tabela nr. 16.

Lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi deri më 31.12.2021	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2022	Total detyrime	Shlyerja e detyrimeve 2021 gjatë 3 mujorit të parë të 2022	Detyrimi deri në 31.12.2022
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministrinë e linjës	0	0	0	0	0
b. Investime të veta	0	0	0	0	0
Investime	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	0	0	0	0	0
Vendime gjyqësore	0	0	0	0	0
Të tjera	0	0	0	0	0
Totali	0	0	0	0	0

Tabela nr. 17.

Lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi deri më 31.12.2022	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2023	Total detyrime	Shlyerja e detyrimeve 2022 gjatë 3 mujorit të parë të 2023	Detyrimi deri në 31.12.2023
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministrinë e linjës	0	0	0	0	0
b. Investime të veta	0	0	0	0	0
Investime	0	0	0	0	0
Mallra dhe shërbime	0	0	0	0	0
Vendime gjyqësore	0	0	0	0	0
Të tjera	0	0	0	0	0
Totali	0	0	0	0	0

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

2. Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë ka raportuar çdo vit debitorët ndaj tij, dhe i ka klasifikuar si “debitorë pa shpresë arkëtimi”:

Tabela nr. 18.

Lista e debitorëve deri në 31.12.2023				
Nr.	Emër Mbiemër	Viti i krijimit	Shuma totale	Arveja e krijimit
1	B. A	Para vitit 2000	9,688	Shpenzime të pajustificuara
2	R. K	Para vitit 2000	20,000	Fatura pa dokumentacion
3	M. M	Para vitit 2000	36,421	Shpenzime telefoni
4	E. R	2021	156,486	Page marrë tepër
Totali			222,595	

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Përpunoi Grupi i Auditimit.

Nga ana e SFSHM është raportuar me mbylljen e pasqyrave financiare edhe Prefekti i Qarkut Korçë. Nga auditimi konstatohet se nga SFSHM:

- Është bërë njoftimi i debitorëve nëpërmjet shërbimit postar;
- Me mbylljen e Pasqyrave Financiare është bërë raportimi në Degën e Thesarit, MB, Drejtorinë e Statistikave Korçë;
- Me mbylljen e vitit ushtrimor, akt rakordimeve me thesarin, çdo fillim viti nuk është njoftuar Sektori Juridik mbi listën e debitorëve, me qëllim planifikimin vjetor të ndjekjes së procedurave

ligjore;

-Është vënë në dijeni Prefekti i Qarkut, por nga ana e tij nuk janë marrë masat për të mbledhur në një takim GMS mbi trajtimin e kësaj çështjeje, për një analizë të detajuar mbi arsyet e lënies në heshtje për një periudhë disavjeçare, personat përgjegjës, si dhe hartimin e një plan masash për arkëtimin e detyrimit në buxhetin e Prefekturës së Qarkut Korçë;

-Vlera debitore *konstatohet* e kontabilizuar në llogarinë 468 “debitorë të ndryshëm” (verifikim në bilanc për llogarinë 7206);

-Nuk janë ndjekur hapat procedurialë administrative dhe më pas ligjorë (sipas rastit) për arkëtimin e detyrimit të mbartur ndër vite;

Nga Njësia e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Brendshme, në Raportin Përfundimtar të Auditimit me nr. 827/5 prot., datë 04.04.2023, administruar pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë me praktikën nr. 827/5 prot., datë 04.04.2023, lidhur me situatën debitore është lënë ky rekomandim i rikërkuar: “Menaxhimi i lartë të marrë në analizë gjetjen e auditimit lidhur me përfshirjen në listëprezencë përmbledhëse të KVVTP-së dhe rrjedhojë pagesën e padrejtë si specialist KVVTP-je të punonjësit z. E. R, pa ushtruar në fakt këtë funksion, duke përfituar padrejtësisht 156,486 lekë. Menaxhimi i lartë të nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe të ndjekë rrugën ligjore të arkëtimin të përfitimit të padrejtë të pagës nga E. R në vlerën 156,486 lekë”.

Aktualisht procesi gjyqësor ndodhet në Gjykatën e Apelit Tiranë. Nga ana e institucionit të Prefektit është bërë njoftimi për detyrimin e likuidimin e tij me shkresën nr. 90 prot., datë 25.01.2021. Më datë 08.02.2021, punonjësi kthen përgjigjen për mospranimin e shumës debitore. Me shkresën nr. 259 prot., datë 09.03.2021, institucioni njofton arkëtimin në rrugë gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Korçë. Me Vendimin nr. 41-2022-810 (214), datë 17.03.2021, gjykata vendos rrëzimin e padisë me paditës Prefektin e Qarkut Korçë dhe të paditurin z. E. R, si të pa bazuar në ligj dhe në prova. Nga ana e institucionit brenda afatevligjore është depozituar kërkesa ankimore pranë Gjykatës së Apelit Korçë, aktualisht ka kaluar në Apel. Deri në këtë moment nuk ka asnjë njoftim për zhvillimin e gjyqit.

2.1.5. Verifikimi i masave të programit të emergjencave dhe mbrojtjes civile për masat e marra për fakeqësitë natyrore si tërmetet, përmbytjet, dëmtimet nga zjarri, vlerësimet e dëmeve nga fatkeqësitë e ndryshme për përmirësimin e cilësisë së jetës së njeriut duke promovuar përvojat më të përhapura dhe shërbime të sigurt dhe efikase.

Mbështetur në Ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 9, “Vlerësimi i riskut”, neni 14 “Plani për emergjencat civile”, neni 28 “Prefekti i qarkut”, si dhe në detyrat e vëna për këtë qëllim, janë përgatitur dhe dërguar për qëllim analizimi dhe planifikimi në AKMC dy dokumentet kryesore të fushën e Mbrojtjes Civile:

1. Me Urdhrin nr. 40, datë 16.05.2024, të Prefektit të Qarkut Korçë është miratuar Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në nivel Qarku, dërguar në AKMC me shkresën nr. 463/1 prot., datë 16.05.2024.

2. Me Urdhrin nr. 41, datë 16.05.2024, të Prefektit të Qarkut Korçë është miratuar Plani i Qarkut për Emergjencat Civile, dërguar në AKMC me shkresën nr. 464/1 prot., datë 16.05.2024.

Në funksion të hartimit dhe përgatitjes së tyre është zbatuar metodologjia dhe detyrat e vëna nga AKMC për hartimin dhe përgatitjen e dokumenteve strategjike në nivel vendor. Struktura përkatëse e Prefekturës së Qarkut Korçë ka marrë pjesë në takime dhe trajnime të zhvilluara nga AKMC, si dhe ato të zhvilluara në nivel prefecture me strukturat e EC të bashkive, institucionet shtetërore në nivel vendore etj. Janë përgatitur shkresa, urdhëra dhe udhëzime të ndryshme në funksion të kësaj detyre.

Prefekti i Qarkut Korçë për vitet 2022-2023 ka pasur korrespondencë me bashkitë dhe institucionet e ndryshme kërkimore, shkencore dhe Universitetin “F. S. N.” etj. për mbledhjen, grumbullimin e informacionit të nevojshëm dhe shfrytëzimin e tij sipas risqeve të përcaktuara në Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në nivel Kombëtar.

Në lidhje me këtë situatë Prefekti i Qarkut Korçë me Urdhrin nr. 4, datë 09.01.2024, “Për krijimin dhe funksionimin e sekretariatit teknik në nivel qarku procesin e hartimit të dokumenteve strategjike për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, në nivel lokal” ka ngritur grupin e punës për ndjekjen e detyrave që lidhen me hartimin e dokumenteve strategjike në nivel qarku e bashki.

Me shkresën nr. 31/1 prot., datë 09.01.2024, “Në vëmendjen tuaj”, ka ritheksuar edhe njëherë nevojën e rritjes së bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe bashkive, në funksion të realizimit sa më mirë të kësaj detyre, ku janë kryer dhe organizuar takime e konsultime në shkallë prefektore për këtë qëllim.

Në lidhje me administrimin e Emergjencave Civile Verore dhe Dimërore nga institucioni i Prefektit janë ndjekur hapat si më poshtë:

-Janë përgatitur praktikat për takimet me Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel qarku për administrimin e emergjencave civile verore për periudhën Maj-Tetor 2022 dhe 2023 dhe dimërore për periudhën Nëntor-Mars të vitit pasardhës.

-Me Urdhrin nr. 85, datë 28.10.2022, për ngritjen e Komisionit të Prefektit dhe ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Mbrojtjes Civile në shkallë qarku.

-Është hartuar rregullorja me nr. 1101, datë 29.12.2023, “Mbi funksionimin e komisionit të mbrojtjes civile në nivel qarku”.

-Është hartuar programi i Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë për veprimtaritë e përbashkëta në funksion të administrimit të emergjencave verore dhe dimërore.

-Përpara fillimit të secilës fazë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut janë zhvilluar takime me strukturat e MC të bashkisë (Sektorët e Emergjencave Civile, shërbimin e MZSH-së, Shërbimin Pyjor, Drejtoritë/Sektorët e Ujitjes dhe të Kullimit në bashki) deri në takimet me banorë të ndryshëm në përgjithësi dhe në zonat me risk zjarri apo izolimi nga dëbora dhe reshjet e dëborës në veçanti, në bashkëpunim me drejtuesit kryesore në bashki, strukturat e EC të bashkive, Strukturat e Policisë së Shtetit sipas shtrirjes së tyre etj.

-Janë kryer takime me subjektet kontraktore që mirëmbajnë akset kryesore nacionale dhe ato turistike në shkallë Qarku, Drejtorinë e Rajonit Qëndër-Lindje (Mirëmbajtja Rrugore në Korçë), Drejtorët/Sektorët e Mirëmbajtjes së rrugëve rurale, dytësore dhe lidhës në bashki, strukturat e Policisë së Qarkullimit Rrugor etj., në funksion të mirëmbajtjes dimërore të akseve kryesore nacionale, atyre turistike dhe rrugëve dytësore e lidhëse në bashki etj.

-Janë zhvilluar, sondazhe të ndryshme në bashki lidhur me gjendjen e kapaciteteve operacionale, masat e marra për përbalimin e rasteve të fatkeqësive natyrore, zjarreve bllokimin e rrugëve nga dëbora, përqëndrimin dhe akomodimin e personelit manovrator dhe të teknikës, gjendjen teknike të ujëmbledhësve dhe të rezervuarëve etj.

-Nga strukturat përkatëse të Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë janë ndjekur në terren rastet problematike të krijuara në shkallë qarku, duke koordinuar dhe bashkërenduar punën me të gjitha strukturat për minimizimin e efekteve negative të shkaktuara deri në normalizimin e situates.

Ndërmjet strukturat të emergjencave civile në bashki, të shërbimit të MZSH-së, Shërbimit Pyjor, Drejtorive/Sektorëve të Ujitjes së Kullimit ka pasur komunikim të vazhdueshëm për administrimin e situatave problematike të krijuara. Përpara çdo faze verore dhe dimërore janë kryer takime me sektorët duke shkëmbyer informacionin e nevojshëm etj.

-Janë kryer takime të vazhdueshme për sensibilizimin e opinionit lidhur me domosdoshmërinë e marrjes së masave në fushën e mbrojtjes civile, mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, ruajtjen dhe mbrojtjen e pronës publike e private, masat dhe sanksionet ligjore që zbatohen, etj si pjesë e rëndësishme e sigurimit të jetës dhe aktivitetit normal të komunitetit dhe në rastet e fatkeqësive natyrore dhe ato që shkaktohen nga veprimtaria njerëzore.

Për sa i përket rasteve të rënies së zjarreve gjatë vitit 2022-2023 janë përballuar me forcat dhe kapacitetet e vetë bashkive pa nevojën e kapaciteteve shtesë. Për vitet 2022-2023 janë reduktuar rastet e rënies së zjarreve, nuk ka patur raste të rënies së zjarreve në sipërfaqe me pyje dhe me kohëzgjatje të madhe për t'u fikur. Zjarret kanë qënë kryesisht në sipërfaqe me shkurre ferra, kullotë, grurë të korrur etj.

Për rastet e rënies së zjarreve në banesa, janë zbatuar procedurat e nevojshme ligjore për vlerësimin e dëmeve të shaktuara deri në shlyerjen nga ana financiare të dëmeve të shaktuara, sipas akteve ligjore e nënligjore të përcaktuara për këtë qëllim. Në shkallë qarku janë 124 rezervuarë dhe ujëmbledhës prej tyre 45 janë vlerësuar të digave të mëdha. Për administrimin sa më të mirë të tyre dhe evitim të situatave problematike që mund të krijohen është bashkëpunuar me Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM), përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtorinë Rajonale të Ujitjes e Kullimit dhe bashkitë lidhur me gjendjen teknike të digave, administrimin, dekomisionimin e digave problematike etj. Përgjatë viteve 2022-2023, struktura e emergjencave civile ka marrë pjesë në trajnime, seminare të ndryshme duke kërkuar dhe aplikuar përvojën më të mirë në fushën e mbrojtjes civile.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Prefektura e Qarkut Korçë është paraqitur observacioni me shkresën nr. 343/17 prot., datë 10.09.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 563/7 prot., datë 13.09.2024, nga z. N. J. Prefekt i Qarkut Korçë dhe znj. V. M. Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit: 1. Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit nr.5, për parashikimin në PBA të të ardhurave për t'u arkëtuar nga debitorët, ato parashikohen si të tilla për vitin ushtrimor në çdo PBA, konkretisht pasqyra 1/A, të tjera (debitorë) në vlerën 223 mijë lekë.

2. Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit nr. 5, për njoftimin e debitorëve në çdo fillim viti (pa shpresë arkëtimi) ju informojmë se: Këta debitorë janë krijuar prej më shumë se 20 vitesh dhe pas përpjekjeve me njoftime vjetore nga ana e Sektorit të Financës në bashkëpunim edhe me Sektorin Juridik, përsëri nuk është arritur arkëtimi i këtyre detyrimeve. Sqarojmë se institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë nuk disponon dokumentacion të mjaftueshëm për të ndjekur praktikën ligjore për tre raste. Rasti i katërt (i cituar edhe nga ana juaj) është duke u ndjekur në rrugë gjyqësore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimet e ngritura nga ana juaj ju bëjmë me dije se, në thelb nuk kundërshtoni problematikën e ngritur nga grupi i auditimit, pra vlerën e detyrimeve por evidentoni pamundësinë për kryerjen e arkëtimit të detyrimeve për shkak të pamundësisë së disponimit të dokumentacionit përkatës apo periudhës së gjatë kohore që janë krijuar këta debitorë. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

2.2. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.

-Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit);

-Auditim për zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit të kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.

a. Për periudhën nga data **01.01.2022, deri më 31.12.2022**, Prefektura e Qarkut Korçë ka realizuar në total për 14 objekte prokurimi 44 procedura prokurimi me fond limit 1,500,000 lekë pa Tvsh dhe me vlerë kontrate 1,378,056 lekë pa Tvsh. Të dhënat mbi realizimin e procedurave të

prokurimit me vlera të vogla për vitin 2022 paraqiten në **Tabelën nr. 1, Aneksi nr. 1**, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Me Urdhrin nr. 11, datë 31.01.2022, të z. Dh. S. Prefekt i Qarkut Korçë është ngritur Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla (në vijim KPVV) për vitin 2022 i përbërë nga znj. L. B. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. S. M, znj. M. Z.

Nga 44 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit 1,500,000 lekë pa Tvsh janë audituar 3 procedura me fond limit në vlerën 906,666 lekë pa Tvsh ose në masën 60.4% të fondit limit (në total janë audituar 3 procedura për arsye se 41 procedurat e tjera janë me fond limit në 100,000 lekë në formë shkresore), konkretisht si më poshtë:

1. Me Urdhrin nr. 1, datë 09.02.2022, të Prefektit të Qarkut Korçë z. Dh. S. në cilësinë e Titullarit të AK, është urdhëruar komisioni për procedurat e prokurimit me vlera të vogla i përbërë nga znj. L. B kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. M. Z, znj. S. M. i cili ka filluar procedurën me objekt **“Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil 10 ppm) për sasinë 5,800 litra”**, me fond limit 800,226 lekë pa Tvsh.

-Kjo procedurë ka nisur referuar kërkesës me nr. 1 prot., datë 07.01.2022, të hartuar nga znj. E. E, me detyrë Specialist pranë SFSHM dhe z. J. K, me detyrë Magazinier, kërkesë e cila është miratuar nga titullari i institucionit. Për nevojat e institucionit në kërkesë, kërkohet furnizimi me karburant Diesel (10 ppm) i sasisë prej 5,800 litra.

-Më datë 08.02.2022, nga KPVV është mbajtur procesverbali për përlllogaritjen e çmimit të karburantit Gazoil (10 ppm) dhe fondit limit.

-Me procesverbalin nr. 1/1, datë 09.02.2022, KPVV ka hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit, miratuar nga titullari i institucionit.

-Me shkresën nr. 1/2 prot., datë 09.02.2022, nga KPVV është hartuar procesverbali për dërgimin e ftesës për ofertë pesë OE.

-Më datë 10.02.2022, nga KPVV është mbajtur formulari për njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit, për një lapsus në vendosjen e kriterëve.

Procedura ka rifilluar me Urdhrin nr. 1/1, datë 10.02.2022, të Prefektit të Qarkut Korçë z. Dh. S, në cilësinë e Titullarit të AK, është urdhëruar KPVV i përbërë nga znj. L. B, kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. M. Z, znj. S. M, i cili ka filluar procedurën me objekt **“Furnizimi me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil 10 ppm) me kartë elektronike për sasinë 5,800 litra”**, me fond limit 800,226 lekë pa Tvsh.

-Me procesverbalin nr. 1/2, datë 10.02.2022, KPVV ka hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit, miratuar nga titullari i institucionit.

-Me shkresën nr. 1/3 prot., datë 10.02.2022, nga KPVV është hartuar procesverbali për dërgimin e ftesës për ofertë pesë OE.

-Më datë 14.02.2022, në SPE është publikuar klasifikimi përfundimtar ku kanë ofertuar pesë OE me ofertat përkatëse nga të cilët katër OE janë kualifikuar dhe OE “A.” është s’kualifikuar për arsye se vlera e ofertuar është më lartë nga fondi limit.

-Nga KPVV është mbajtur procesverbali për s’kualifikimin e OE “G.” për mos paraqitje pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve kohore.

-Më datë 16.02.2022, nga OE “M. M.” ka paraqitur në SPE kërkesën për tërheqje nga procedura për arsye të mos përputhjes së specifikimeve teknike. Nga KPVV është mbajtur procesverbali i datës 17.02.2022, për kalimin tek OE i radhës.

-Duke qenë se OE të renditur në klasifikimin përfundimtar janë me të një vlerë ofertë, KPVV ka nisur procedurën për hedhjen e shortit sipas shkresës me nr. 1/4 prot., datë 16.02.2022, duke njoftuar në SPE më datën 16.02.2022, OE “D. S” dhe OE “P. A.”.

-Më datë 17.02.2022, nga KPVV është mbajtur procesverbali i hedhjes së shortit, ku ka rezultuar se nuk është paraqitur asnjë nga OE të njoftuar në SPE.

Procedura ka rifilluar me Urdhrin nr. 1/2, datë 22.02.2022, të Prefektit të Qarkut Korçë z. Dh. S, në cilësinë e Titullarit të AK, është urdhëruar KPVV i përbërë nga znj. L. B kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. M. Z, znj. S. M, i cili ka filluar procedurën me objekt **“Furnizimi me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil 10 ppm) me kartë elektronike për sasinë 5,591 litra”**, me fond limit 799,858 lekë pa Tvsh.

-Më datë 22.02.2022, nga KPVV është mbajtur procesverbali për përlllogaritjen e çmimit të karburantit Gazoil (10 ppm) dhe fondit limit.

-Nga auditimi konstatohet se, nuk argumentohet sasia e kërkuar e karburantit prej 5,591 litra (Gazoil 10 ppm) konkretisht në dokumentin e mbajtur nga KPVV për përlllogaritjen e fondit limit nuk përcaktohet numri i mjeteve që do të furnizohen me karburant, furnizimet e viteve të mëparshme dhe analiza e detajuar mbi konsumin e sasisë së karburantit për secilin mjet së bashku me plan shpërndarjen për mjetet e institucionit. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 76, pika 2.

-Me procesverbalin nr. 1/3, datë 22.02.2022, KPVV ka hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit.

-Në lidhje me kriteret e vendosura nga KPVV, janë konstatuar kritere jo në përputhje me shërbimin/investimin e kërkuar, nuk janë të argumentuara dhe çënojnë pjesëmarrjes e OE të interesuar, konkretisht:

1. Në pikën nr. 5. Shoqëria pjesëmarrëse duhet të paraqesë Fletë Analizë lëshuar nga ISHTI, për karburant, e cila duhet të jetë lëshuar brenda 60 ditëve nga data e hapjes së ofertave.

Për sa i përket kërkesës se OE duhet të paraqesi “Fletë Analizë/Raport Testimi” për artikullin Gazoil (Diezel), lëshuar brenda 60 ditëve nga data e hapjes së ofertave nga ISHT ose nga një organ/subjekt i çertifikuar/autorizuar/akredituar nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish për arsye se, fletë analiza ose raporti i testimit vlen për gjendjen në depozitë të sasisë së karburantit dhe jo për gjendjen e depozitës së 2 muajve si afat maksimal i kërkuar në këtë kërkesë për të cilën sasia e karburantit mund të jetë shitur.

Në lidhje me kriterin për paraqitjen e Fletë Analizë/Raport Testimi” për artikullin Gazoil (Diezel) vlen të theksohet se kjo kërkesë dhe ky dokumentacion duhet të paraqitet nga OE përgjatë fazës së zbatimit të kontratës, për të vërtetuar që mallrat e përdorur janë në përputhje/sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga AK.

Në kriteret e mësipërme nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE pjesëmarrës i cili duhet të jetë i pajisur me vërtetim të lëshuar nga ISHT-i (Inspektoriati Shtetëror Teknik), që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburant siaps standardeve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë. Ky kriter bazohet në nenin 36, dhe nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe nenin 44, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Me shkresën nr. 1/4 prot., datë 22.02.2022, nga KPVV është hartuar procesverbali për dërgimin e ftesës për ofertë pesë OE.

-Më datën 24.02.2022, në SPE është publikuar klasifikimi përfundimtar ku kanë ofertuar dy OE me ofertat përkatëse.

-Më datën 25.02.2022, nga OE “M. M.” ka paraqitur në SPE kërkesën për tërheqje nga procedura për arsye objektive. Nga KPVV është mbajtur procesverbali i datës 25.02.2022, për kalimin tek OE i radhës.

-Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 25.02.2022, është shpallur fitues OE “P. A.”, me marzh fitimi 19 lekë i cili është renditur i dyti në klasifikimin përfundimtar.

-Nga KPVV më datë 28.02.2022, është mbajtur raporti i vlerësimit, miratuar nga titullari i institucionit.

-Ndërmjet palëve është lidhur kontrata me nr. 226 prot., datë 28.02.2022, në vlerën 959,829.6 lekë me Tvsh me marzh fitimi 19%.

-Me procesverbalin nr. 1/6 prot., datë 04.03.2022, është marrë sasia e karburantit prej 4,663 litra gazoil në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga znj. O. B, znj. B. K, znj. D. T dhe znj. E. E Specialist pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. J. K Magazinier duke u bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 2, datë 04.03.2022. Nga OE i shpallur fitues janë lëshuar faturat tatimore me nr. 22/2022, datë 03.03.2022, dhe nr. 23/2022, datë 04.03.2022, në vlerën totale 959,878.55 lekë likuiduar me USH nr. 58, datë 31.03.2022, nr. 85, datë 26.04.2022, nr. 110, datë 26.05.2022, nr. 135, datë 21.06.2022, dhe nr. 162, datë 28.07.2022.

-Për sa trajtuar më sipër asnjë anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim nuk është specialist fushe. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 42.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE “P.A.” të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kriterëve të kualifikimit si më poshtë:

1. Në pikën nr. 5. Shoqëria pjesëmarrëse duhet të paraqesë Fletë Analizë lëshuar nga ISHTI, për karburant e cila duhet të jetë lëshuar brenda 60 ditëve nga data e hapjes së ofertave.

Raporti i Analizimit para zhdoganimit i lëshuar nga ISHTI i përket datës 18.03.2021, pra jashtë afatit të përcaktuar në kriteret për kualifikim.

2. Në pikën nr. 8. Operatorët Ekonomikë ofertuese duhet të disponojnë të paktën 1 (një) pikë stacion të shitjes së karburanteve brenda territorit të Bashkisë Korçë, duke i vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj) për stacionet.

Stacioni të jetë i pajisur me:

-Lejen e mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin.

-Në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, OE pjesëmarrës, për secilën pikë stacioni të shitjes së karburantit, **duhet të paraqesin autorizim të vlefshëm, të lëshuar nga Bashkia Korçë**, për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj ose karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Bashkëlidhur dokumentacionit të OE “P.A.” të shpallur fitues sipas fletës së inventarit më datë 28.02.2022, nuk disponohet autorizimi i vlefshëm i lëshuar nga Bashkia Korçë për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe shpalljen fitues të OE “P. A.”, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të Ftesës për Ofertë, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP-së, ku KPVV duhet ta anulonte procedurën dhe të zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizues, për një përdorim më efektiv të fondit për vlerën **959,829.6 lekë**.

2. Me Urdhrin nr. 13, datë 31.01.2022, të Prefektit të Qarkut Korçë z. N. J. është ngritur grupi i punës për konstatimin e defekteve të mjeteve të institucionit i përbërë nga z. Gj.T. kryetar i

komisionit dhe anëtarët z. J. K, z. Gj. N. Më datë 04.11.2022, grupi i punës i sipërpërmendur ka mbajtur procesverbalin mbi konstatimin e defekteve të automjetit Tip Mitshubishi Parejo me targë A., referuar kërkesës me nr. 25 prot., datë 03.11.2022, në Subjektin “R. K. P.” me Nipt M.... me fushe veprimtarie servis automjetesh.

Me Urdhrin nr. 23, datë 21.11.2022, të Prefektit të Qarkut Korçë z. Dh. S në cilësinë e Titullarit të AK, është urdhëruar KPVV i përbërë nga znj. L. B, kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. M. Z, znj. S. M, i cili ka filluar procedurën me objekt **“Blerje pjesë këmbimi dhe vendosje”**, me fond limit 40,000 lekë pa Tvsh.

-Më datë 21.11.2022, nga KPVV është mbajtur procesverbali i përlogaritjes së fondit limit, ku është aplikuar metoda “Testim tregu”.

-Më datë 24.11.2022, nga KPVV është hartuar procesverbali për dërgimin e ftesës për ofertë pesë OE.

-Më datë 30.11.2022, nga KPVV është mbajtur formulari për njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit për arsye se, ofertat e paraqitura nga OE janë më të larta nga fondi limit.

Procedura ka rifilluar me Urdhrin nr. 23/1, datë 30.11.2022, të Prefektit të Qarkut Korçë z. Dh. S, në cilësinë e Titullarit të AK, është urdhëruar KPVV i përbërë nga znj. L. B, kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. M. Z, znj. S. M, i cili ka filluar procedurën me objekt **“Blerje pjesë këmbimi dhe vendosje”**, me fond limit 40,000 lekë pa Tvsh.

-Nga KPVV nuk është publikuar në SPE procesverbali mbi argumentimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të pranimit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 11.

-Më datë 02.12.2022, në SPE është publikuar klasifikimi përfundimtar ku kanë ofertuar 13 operatorë ekonomikë me ofertat përkatëse, nga të cilët 5 OE janë kualifikuar ndërsa 8 OE janë s’kualifikuar për arsye se vlera e ofertuar prej tyre është më e lartë se fondi limit.

-Më datë 05.12.2022, nga KPVV është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës, për arsye se OE “L. S.” i renditur i pari në klasifikimin përfundimtar nuk është paraqitur brenda afatit kohor.

-Më datë 06.12.2022, nga KPVV është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës, për arsye se OE “T. K.” i renditur i dyti në klasifikimin përfundimtar nuk është paraqitur brenda afatit kohor.

-Më datë 06.12.2022, nga KPVV është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës, për arsye se OE “E. K.” i renditur i treti në klasifikimin përfundimtar nuk është paraqitur brenda afatit kohor.

-Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 06.02.2022, është shpallur fitues OE “M. Sh. & N. Sh.” me fond limit 39,500 lekë pa Tvsh i cili është renditur i katërti në klasifikimin përfundimtar.

-Ndërmjet palëve është lidhur kontrata me nr. 315 prot., datë 28.03.2022, në vlerën 72,000 lekë me Tvsh.

-OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore nr. 26/2022, datë 19.12.2022, në vlerën 47,400 lekë me Tvsh, likuiduar me USH nr. 277, datë 21.12.2022.

-Me procesverbalin e datës 19.12.2022, janë marrë në dorëzim punimet e kryera për automjetin Tip Mitshubishi Parejo me targë A. nga komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga z. Gj. T, kryetar i komisionit dhe anëtarët z. J. K, z. Gj. N, ku janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 19, datë 19.12.2022.

-Për sa trajtuar më sipër asnjë anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim nuk është specialist fushe. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 42.

3. Me Urdhrin nr. 4, datë 17.03.2022, të Prefektit të Qarkut Korçë z. Dh. S, në cilësinë e Titullarit të AK, është urdhëruar komisioni për procedurat e prokurimit me vlera të vogla i përbërë nga znj. L. B, kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. M. Z, znj. S. M, i cili ka filluar procedurën me objekt **“Blerje pjesë këmbimi dhe aksesore”**, me fond limit 66,666 lekë pa Tvsh.

-Më datë 16.03.2022, nga KPVV është mbajtur procesverbali i përlogaritjes së fondit limit, ku është aplikuar metoda “Testim tregu”.

-Më datë 17.03.2022, nga KPVV është hartuar procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

-Më datë 17.03.2022, nga KPVV është hartuar procesverbali për dërgimin e ftesës për ofertë pesë operatorëve ekonomikë.

-Kjo procedurë ka nisur referuar kërkesës me nr. 6 prot., datë 14.02.2022, të hartuar nga znj. E. E, me detyrë Specialist pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. J. K, me detyrë Magazinier dhe z. E. R Shofer.

-Nga KPVV më datë 23.03.2022, është mbajtur procesverbali për hapje të procedurës me vonesë në zbatim të VKM nr. 161, datë 18.03.2022, “Për përcaktimin e ditës së hënë, datë 21.03.2022, ditë pushimi”.

-Më datë 23.03.2022, në SPE është publikuar klasifikimi përfundimtar ku kanë ofertuar nëntë OE me ofertat përkatëse, nga të cilët 6 OE janë kualifikuar ndërsa 3 OE janë s’kualifikuar për arsye se vlera e ofertuar prej tyre është më e lartë se fondi limit.

-Më datë 24.03.2022, nga KPVV është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës, për arsye se OE “A. - A.” i renditur i pari në klasifikimin përfundimtar nuk është paraqitur brenda afatit kohor.

-Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 24.03.2022, është shpallur fitues OE “T. K.” me fond limit 60,000 lekë pa Tvsh i cili është renditur i dyti në klasifikimin përfundimtar.

-Nga KPVV është mbajtur raporti i vlerësimit me nr. 4/1 prot., datë 28.03.2022, miratuar nga titullari i institucionit.

-OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore nr. 23/2022, datë 05.04.2022, në vlerën 72,000 lekë me Tvsh, likuiduar me USH nr. 79, datë 13.04.2022.

-Me procesverbalin nr. 4/2 prot., datë 05.04.2022, janë marrë në dorëzim punimet e kryera për automjetin Tip Hyundai Tucson me targë A. dhe Mitsubishi me tragë A., nga komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga znj. O. B, kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. B. K, znj. D. T, ku janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 6, datë 05.04.2022.

-Për sa trajtuar më sipër asnjë anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim nuk është specialist fushe. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 42.

-Mallrat janë bërë hyrje në magazinë jashtë afateve (5 ditë me vonesë) të parashikuara në ftesën për ofertë pika 7 ku përcaktohet që: “Operatori ekonomik fitues duhet të marrë përsipër vendosjen e pjesëve të këmbimit dhe aksesoreve”.

b. Për periudhën nga data **01.01.2023, deri më 31.12.2023**, Prefektura e Qarkut Korçë ka realizuar në total për 13 objekte prokurimi 42 procedura prokurimi me fond limit 1,421,427 lekë pa Tvsh dhe me vlerë kontrate 1,468,042 lekë me Tvsh. Të dhënat mbi realizimin e procedurave të

prokurimit me vlera të vogla për vitin 2023 paraqiten në **Tabelën nr. 2, Aneksi nr. 1**, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Me Urdhrin nr. 7, datë 02.02.2023, të z. N. J. Prefekt i Prefekturës së Qarkut Korçë është ngritur Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla (në vijim KPVV) për vitin 2023 i përbërë nga z. Gj. N kryetar i komisionit dhe anëtarët z. Gj. T, z. L. M. Nga 42 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit 1,421,427 lekë pa Tvsh janë audituar 2 procedura me fond limit në vlerën 939,528 lekë pa Tvsh ose në masën 60% të fondit limit (në total janë audituar 3 procedura për arsye se 41 procedurat e tjera janë me fond limit në 100,000 lekë në formë shkresore), konkretisht si më poshtë:

1. Me Urdhrin nr. 21, datë 20.04.2023, të Prefektit të Qarkut Korçë z. N. J në cilësinë e Titullarit të AK, është urdhëruar komisioni për procedurat e prokurimit me vlera të vogla i përbërë nga znj. L. B kryetar i komisionit dhe anëtarët z. Gj. N, kryetar i komisionit dhe anëtarët z. Gj. T, z. L. M, i cili ka filluar procedurën me objekt “Furnizim me lëndë djegëse për automjetet, Diesel (Gazoil 10 ppm)**”, me fond limit 799,528 lekë pa Tvsh.**

-Kjo procedurë ka nisur referuar kërkesës me nr. 5 prot., datë 18.04.2023, të hartuar nga znj. A. Q specialiste pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe znj. V. M, Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

-Me shkresën nr. 371/1 prot., datë 02.05.2023, është mbajtur procesverbali për përlogaritjen e çmimit të naftës Gazoil me anë të metodës “Testim tregu”.

-Më datë 02.05.2023, nga KPVV është mbajtur procesverbali për përlogaritjen e fondit limit.

-Nga auditimi konstatohet se, nuk argumentohet sasia e kërkuar e karburantit prej 5,591 litra (Gazoil 10 ppm) konkretisht në dokumentin e mbajtur nga KPVV për përlogaritjen e fondit limit nuk përcaktohet numri i mjeteve që do të furnizohen me karburant, furnizimet e viteve të mëparshme dhe analiza e detajuar mbi konsumin e sasisë së karburantit për secilin mjet së bashku me plan shpërndarjen për mjetet e institucionit. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 76, pika 2.

-Me procesverbalin e datës 03.05.2023, KPVV ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

-Në lidhje me kriteret e vendosura nga KPVV, janë konstatuar kriterë jo në përputhje me shërbimin/investimin e kërkuar, nuk janë të argumentuara dhe çënojnë pjesëmarrjes e OE të interesuar, konkretisht:

1. Në pikën nr. 5. Shoqëria pjesëmarrëse duhet të paraqesë Fletë Analizë lëshuar nga ISHTI, për karburant, e cila duhet të jetë lëshuar brenda 60 ditëve nga data e hapjes së ofertave.

Për sa i përket kërkesës se OE duhet të paraqesi “Fletë Analizë/Raport Testimi” për artikullin Gazoil (Diezel), lëshuar brenda 60 ditëve nga data e hapjes së ofertave nga ISHT ose nga një organ/subjekt i çertifikuar/autorizuar/akredituar nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish për arsye se, fletë analiza ose raporti i testimi vlen për gjendjen në depozitë të sasisë së karburantit dhe jo për gjendjen e depozitës së 2 muajve si afat maksimal i kërkuar në këtë kërkesë për të cilën sasia e karburantit mund të jetë shitur.

Në lidhje me kriterin për paraqitjen e Fletë Analizë/Raport Testimi” për artikullin Gazoil (Diezel) vlen të theksohet se kjo kërkesë dhe ky dokumentacion duhet të paraqitet nga OE përgjatë fazës së zbatimit të kontratës, për të vërtetuar që mallrat e përdorur janë në përputhje/sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga AK.

Në kriteret e mësipërme nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE pjesëmarrës i cili duhet të jetë i pajisur me vërtetim të lëshuar nga ISHT-i (Inspektoriati Shtetëror Teknik), që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburant siaps standardeve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë. Ky kriter bazohet në nenin 36, dhe nenin 77, të Ligjit nr.

162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe nenin 44, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Me shkresën nr. 371/2 prot., datë 03.05.2023, nga KPVV është hartuar procesverbali për dërgimin e ftesës për ofertë pesë OE.

-Më datë 05.05.2023, në SPE është publikuar klasifikimi përfundimtar ku kanë ofertuar dy OE me ofertat përkatëse.

-Në SPE më datë 05.05.2023, është shpallur fitues OE “O.” Shpk me marzh fitimi 7% i cili është renditur i pari në klasifikimin përfundimtar.

-Ndërmjet palëve është lidhur kontrata e furnizimit me nr. 371/4 prot., datë 10.05.2023, në vlerën 799,528 lekë me Tvsh me marzh fitimi 7%.

-Me procesverbalin nr. 371/5 prot., datë 17.05.2023, është marrë në dorëzim sasia e karburantit prej 4,708 litra naftë, nga komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhrin nr. 9, datë 02.02.2023, të Prefektit të Qarkut Korçë z. N. J. i përbërë nga znj. F. R. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. A. S, znj. M. G, si dhe nga z. J. K mgaznier, znj. B. K, Specialist Arkiv-Protokolli dhe z. E. R, mbjates i kartave elektronike duke u bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 4, datë 17.05.2023.

-Nga OE i shpallur fitues janë lëshuar faturat tatimore me nr. 3310/2023, datë 17.05.2023, dhe nr. 3134/2023, datë 18.05.2023, në vlerën totale 799,465 lekë me Tvsh, likuiduar me USH nr. 117, datë 20.06.2023, dhe nr. 98, datë 30.05.2023.

-Për sa trajtuar më sipër asnjë prej anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim nuk është specialist fushe. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 42.

2. Më datë 21.09.2023, drejtuesi i mjeteve z. E. R ka bërë kërkesë drejtuar komisionit të konstatimit të defekteve, për konstatim të defekteve për mjetin Hyundai Tucson me targë A. dhe Mitsubishi Pajero me targë A.. Më datë 09.10.2023, në ambientet e subjektit “A. S. K.”, për verifikimin e kryer të automjeteve Tip Hundai Tucson dhe Mitsubishi Pajero është mbajtur procesverbali për konstatim defektesh. Më datë 11.10.2023, komisioni i konstatimi i defekteve i përbërë nga z. D. K kryetar i komisionit dhe anëtarët z. Z. B, z. P. P ka mbajtur procesverbalin për konstatimin e defekteve të automjeteve të Institucionit të Prefektit.

Me shkresën nr. 12 prot., datë 16.10.2023, znj. A. Q Specialiste pranë SFSHM ka kryer kërkesë drejtuar Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Nëpunësit Zbatues dhe Komisionit të Prokurimeve me Vlera të Vogla për nisjen e procedurës së prokurimit për riparimin e defekteve për mjetet e institucionit.

Me Urdhrin nr. 43, datë 17.10.2023, të Prefektit të Prefekturës së Qarkut Korçë z. N. J, në cilësinë e titullarit të AK, është urdhëruar komisioni për procedurat e prokurimit me vlera të vogla i përbërë nga z. Gj. N kryetar i komisionit dhe anëtarët z. Gj. T, z. L. M, i cili ka filluar procedurën e prokurimit me objekt **“Blerje pjesë këmbimi dhe shërbim vendosje për automjetet e Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë”**, me fond limit 140,000 lekë pa Tvsh.

Më datë 18.10.2023, nga KPVV është mbajtur procesverbali i përllogaritjes së fondit limit, ku është aplikuar metoda “Testim tregu”. Me shkresën nr. 898/1 prot., datë 18.10.2023, KPVV ka hartuar një relacion shpjegues në lidhje me hartimin e fondit limit. Më datë 18.10.2023, nga KPVV është hartuar procesverbali për dërgimin e ftesës për ofertë pesë operatorëve ekonomikë. Me shkresën nr. 898/2 prot., datë 19.10.2023, KPVV ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

-Më datë 23.07.2023, në SPE është publikuar klasifikimi përfundimtar ku kanë ofertuar 12 OE me ofertat përkatëse, nga të cilët 10 OE janë kualifikuar ndërsa 2 OE janë s'kualifikuar për arsye se vlera e ofertuar prej tyre është më e lartë se fondi limit.

-Më datë 23.10.2023, nga KPVV është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës, për arsye se OE "M. Sh. & N. Sh." i renditur i pari në klasifikimin përfundimtar është tërhequr për arsye personale.

-Më datë 24.10.2023, nga KPVV është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës, për arsye se OE "O. A." i renditur i dyti në klasifikimin përfundimtar është tërhequr për arsye objektive.

-Më datë 22.10.2023, nga KPVV është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës, për arsye se OE "C. T." i renditur i dyti në klasifikimin përfundimtar është tërhequr për arsye gabimi në kuotim.

-Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 25.10.2023, është shpallur fitues OE "L. S." me fond limit lekë 99,000 lekë pa Tvsh i cili është renditur i katërti në klasifikimin përfundimtar.

-Ndërmjet palëve është lidhur kontrata më datë 30.10.2023, për realizimin e shërbimeve për mjetet e institucionit në vlerën 118,800 lekë pa Tvsh.

-OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore nr. 53/2023, datë 23.11.2023, në vlerën 118,800 lekë me Tvsh, likuiduar me USH nr. 237, datë 12.12.2023.

-Me procesverbalin e datës 23.11.2023, janë marrë në dorëzim punimet e kryera për automjetin Tip Hyundai Tuscon me targë A. dhe Mitsubishi Pajero me targë A. nga komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga znj. F. R, znj. A. S dhe znj. M. Z, ku janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 16, datë 23.11.2023.

-Asnjë anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim nuk është specialist fushe. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 42.

-Duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në kontratën e datës 30.10.2023, në nenin 3, përcaktohet se: "Afati kohor për dorëzimin e mallit është brenda dy ditëve nga lidhja e kontratës", ndërkohë që referuar procesverbalit të sipërpërmendur mallrat janë bërë hyrje në magazinë 21 ditë me vonesë nga afati i parashikuar në kontratë.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J. Prefekt i Qarkut Korçë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. Dh. S. ish-Prefekt I Qarkut Korçë, znj. L. B, znj. S. M, znj. M. Z në cilësinë e KPVV për vitin 2022 dhe z. Gj. N, z. Gj. T, z. L. M, në cilësinë e KPVV për vitin 2023.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Prefektura e Qarkut Korçë është paraqitur observacioni me shkresën nr. 343/17 prot., datë 10.09.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 563/7 prot., datë 13.09.2024, nga z. N. J. Prefekt i Qarkut Korçë dhe KPVV për vitet 2022-2023 z. L. B, znj. S. M, znj. M. Z, z. Gj. N dhe z. L. M ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

I. Pretendimi i subjektit: Viti 2022: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit ku citohet se nuk argumentohet sasia e kërkuar e karburantit prej 5,591 litra, nuk përcaktohet numri i mjeteve që do të furnizohen, nuk theksohen furnizimet e mëparshme dhe analiza e detajuar mbi konsumin e sasisë së karburantit për secilin mjet, sëbashku me plan shpërndarjen, komisioni shpjegon se se:

Për argumentimin e sasisë së kërkuar të karburantit, Komisioni i Prokurimeve me Vlerë të Vogël është bazuar në kërkesën e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, ku citohet fondi limit prej 800,000 lekë pa Tvsh, fond i cili është përllogaritur nga sektori i financës bazuar në relacionin shpjegues të datës 22.01.2022, "Për hartimin e regjistrimit të parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2022" si dhe në raportin shpjegues "Për detajimin e buxhetit të miratuar për vitin 2022, sipas programeve buxhetore në nivel të detajuar nën artikull, sipas llogarive ekonomike shtatë-shifrore" (bashkëlidhur).

Ndërkohë, sasia e nevojshme për institucionin është përcaktuar bazuar në numrin e mjeteve të transportit në përdorim, gjendjen e tyre teknike, normën e harxhimit për 100 km dhe çmimet e botuara në buletin e prokurimeve publike të APP. Shpenzimet për karburant janë parashikuar në vlerën 960,000 lekë me Tvsh, fond i cili është prokuruar nga Komisioni i Prokurimeve me Vlerë të Vogël. Sa i përket sasisë në litra të karburantit (5,591 litra), është përlogaritur sipas buletinit të publikuar në APP, nr. 23, datë 21.02.2022, në bazë të fondit limit (800,000 lekë pa Tvsh përpjestuar me çmimin/litër të karburantit në 2022) (bashkëlidhur).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Problematika e ngritur nga grupi i auditimit ka të bëjë me sasinë, nuk argumentohet sasia e karburantit naftë të kërkuar për nevojat e institucionit. Analiza e sasisë së karburantit kryhet nga specialisti përkatës i fushës (ndërkohë që në KPVV nuk ka asnjë specialist fushë) për kuadrin e normativave të karburantit, gjendjen teknike të mjetit, shërbimet, amortizimit të mjetit, testimi i mjetit me anë të tre metodave sipas procesverbaleve përkatëse, planet e punës etj., sipas secilit mjet, ndërkohë që Ju i referoheni çmimit për litër të sasisë së karburantit pra fond limit/çmim për litër dhe keni nxjerrë sasinë e karburantit. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

2. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit nr. 4, për procedurën me objekt "Furnizim me lëndë djegëse për automjetet Diesel (Gazoil 10 ppm)" (Pika nr. 5 e Akt-Konstatimit) është konstatuar gjetje se Shoqëria pjesëmarrëse duhet të paraqesë Fletë Analizë nga ISHTI (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial) për karburant, e cila duhet të jetë lëshuar brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së ofertave". Ky kriter është vendosur duke u bazuar në Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, konkretisht në nenin 9, ku citohet se: "Rezerva e sigurisë do të jetë e barabartë me 60 ditë mesatare shitjeje. Struktura përgjegjëse për veprimtarinë e hidrokarbureve përgjigjet për kontrollin e sasive të rezervës së sigurisë në të gjitha subjektet". Përsa i përket përcaktimit të kriterëve teknike, sqarojmë se nga ana e komisionit, ato janë vendosur në përputhshmëri me natyrën objekt prokurimi, kjo në zbatim të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe nenit 40, pika 6, gërma "c", e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofrojnë mallra të cilat përmbushin standartet teknike dhe AK kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për të vërtetuar besueshmërinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës, që ai ka tregtuar karburante dhe nuk ka patur penalitete për shkelje cilësie, komisioni është bazuar në legjislacionin e mëposhtëm: Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore, VKM nr. 147, datë 21.03.2007, "Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel", Urdhërit të Ministrit nr. 6, datë 09.01.2015, "Për kontrollin e standarteve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse".

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket kërkesës së kriterit për paraqitjen e Fletë Analizë/Raport Testimi për artikullin Gazoil, ju bëjmë me dije se ky dokumentacion duhet të paraqitet nga OE përgjatë fazës së zbatimit të kontratës, me qëllim vërtetimin që mallrat e përdorura janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

3. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit nr. 4, (pika nr. 8), ku nënvizohet se Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 1 (një) pikë stacioni të shitjes së karburanteve brenda territorit të Bashkisë Korçë, duke e vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj) për stacionet, shpjegojmë se: Në kriteret e ftesës për ofertë, komisioni ka specifikuar që stacioni të jetë i pajisur me: Lejen e mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin, kjo në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj". Përsa i përket vënies së këtij kriteri sqarojmë se nga ana e komisionit janë vënë në përputhshmëri me natyrën objekt prokurimi, kjo në zbatim të nenit 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM

nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe me anë të këtyre kërkesave kërkohet që operatori ekonomik të dëshmojë se disponon aftësitë profesionale për furnizim me mallin objekt kontrate, në Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin dhe transportin e naftës dhe të nën produkteve të tjera” i ndryshuar si dhe VKM nr. 561 datë 29.07.2016, “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, që dëshmojnë se kanë aftësi furnizimi dhe që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike. Kërkesat e mësipërme bazohen duke marrë parasysh lëvizjet e nevojshme për nevoja të institucionit të Prefektit. Në nenin 40, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), në të cilin përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje përmbushjen e kërkesës së pikës nr. 8, grupi i auditimit nuk është shpehur për lejen e mjedisit, por për autorizimin dokumentacion të cilin e lëshon institucioni i njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse (në rastin konkret Bashkia Korçë), konkretisht ky dokumentacion nuk disponohet nga operatori ekonomik i shpallur fitues. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

4. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit nr. 4, për procedurën e marrjes në dorëzim të prokurimit me objekt “Blerje pjesë këmbimi dhe vendosje”, KLSH ka konstatuar se asnjë nga anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim nuk është specialist fushe. Për sa më sipër ju sqarojmë se marrja në dorëzim e punimeve të kryera për çdo procedurë “Furnizim vendosje pjesë këmbimi për mjetet e institucionit” është kryer nga një komision i veçantë, i cili ngrihet çdo fillim viti me urdhër të Prefektit të Qarkut “Komision i konstatimit të difekteve për automjetet dhe marrjes në dorëzim të punimeve të kryera”. Ky komision për çdo rast, konstaton dhe merr në dorëzim punimet që konstatohen/kryhen në mjetet e institucionit në bashkëpunim me një subjekt të licencuar (servis makinash). Për konstatimin e bërë nga KLSH-ja, proces verbali i mbajtur me subjektin e licencuar “M. Sh.” i datës 19.12.2022, ishte pjesë e dosjes të prokurimit (bashkëlidhur).

Oëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur nga Ju në observacion është i njëjti me atë të evidentuar nga grupi i auditimit në aktkonstatimin nr. 2, datë 26.07.2024, konkretisht procesverbali i datës 19.12.2022. Nga shqyrtimi i zbatimit të strukturës organizative është konstatuar se, asnjë prej anëtarëve nuk ka profilin/arsimin ku të klasifikohet si specialist fushe. Gjithashtu Ne nuk citojmë se shërbimet e mjetit nuk janë kryer nga servis i licencuar por që shërbimi i kryer është marrë në dorëzim nga punonjës të institucionit të cilët nuk janë specialist fushe. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

5. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket prokurimit me objekt “Blerje pjesë këmbimi” grupi i auditimit ka konstatuar se mallrat janë bërë hyrje në magazinë 5 ditë me vonesë, për të cilën shpjegojmë se: Kontrata e nënshkruar në datën 28.03.2022, me afat zbatimi 5 (pesë) ditë, i shtrinte efektet e saj deri në datën 04.04.2022. Ditën e nesërme, pas mbarimit të afatit, (datë 05.04.2022), është gjeneruar fatura elektronike nga subjekti dhe është hartuar fletë hyrja përkatëse. Pra, rezulton se nuk ka ditë vonese në zbatimin e kontratës. (bashkëlidhur).

Oëndrimi i grupit të auditimit: Në neni 3, të Kontratës me nr. 315 prot., datë 28.03.2022, përcaktohet që: “Afati kohor për dorëzimin e mallit është brenda 5 (pesë) ditëve nga lidhja e kontratës”. Referuar datave kalendarike pesë ditë nga lidhja e kontratës është data 01.04.2022, ndërsa mallrat janë bërë hyrje nr. 6, datë 05.04.2022, pra 4 ditë me vonesë. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

6. Pretendimi i subjektit: Viti 2023: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit nr. 4, ku citohet se nuk argumentohet sasia e kërkuar e karburantit prej 5,591 litra, nuk përcaktohet numri i mjeteve që do të furnizohen, nuk theksohen furnizimet e mëparshme dhe analiza e detajuar mbi

konsumin e sasisë së karburantit për secilin mjet, së bashku me plan shpërndarjen, komisioni sqaron se ky argumentim është bërë: Për argumentimin e sasisë së kërkuar të karburantit Komisioni i Prokurimeve me Vlerë të Vogël është bazuar në kërkesën e sektorit të financës, ku citohet fondi limit prej 800,000 lekë pa Tvsh, fond i cili është përllogaritur nga sektori i financës bazuar në raportin shpjegues të datës 28.02.2023, “Për detajimin e buxhetit të miratuar për vitin 2023, sipas programeve buxhetore në nivel të detajuar nën artikull, sipas llogarive ekonomike shtatë-shifrore”, si dhe “Regjistri i parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2023” (bashkëlidhur). Ndërkohë, sasia e nevojshme për institucionin është përcaktuar bazuar në numurin e mjeteve të transportit në përdorim, gjendjen e tyre teknike, normën e harxhimit për 100 km dhe çmimet e botuara në buletin e prokurimeve publike të APP. Shpenzimet për karburant janë parashikuar në vlerën 960,000 lekë me TVSH, fond i cili është prokuruar nga Komisioni i Prokurimeve me Vlerë të Vogël. Sa i përket sasisë në litra të karburantit (5,591 litra), është përllogaritur sipas “Studimit të tregut” faktuar me procesverbal me nr. 371/1 të datës 02.05.2023, në bazë të fondit limit (800,000 lekë pa TVSH përpjestuar me çmimin/litër të karburantit në 2023) (bashkëlidhur).

Oëndrimi i grupit të auditimit: Problematika e ngritur nga grupi i auditimit ka të bëjë me sasinë, nuk argumentohet sasia e karburantit naftë të kërkuar për nevojat e institucionit. Analiza e sasisë së karburantit kryhet nga specialisti përkatës i fushës (ndërkohë që në KPVV nuk ka asnjë specialist fushe) për kuadrumin e normativave të karburantit, gjendjen teknike të mjetit, shërbimet, amortizimit i mjetit, testimi i mjetit me anë të tre metodave sipas procesverbaleve përkatëse, planet e punës etj., sipas secilit mjet, ndërkohë që Ju i referoheni çmimit për litër të sasisë së karburantit pra fond limit/çmim për litër dhe keni nxjerrë sasinë e karburantit. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

7. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit nr. 4, për procedurën me objekt: “Furnizim me lëndë djegëse për automjetet Diesel (Gazoil 10ppm)” është konstatuar nga KLSH se “Në pikën nr. 5 Shoqëria pjesmarrës duhet të paraqesë Fletë Analizë nga ISHTI (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial) për karburant, e cila duhet të jetë lëshuar brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së ofertave”. Ky kriter është bazuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, konkretisht në nenit 9, citohet se: “Rezerva e sigurisë do të jetë e barabartë me 60 ditë mesatare shitjeje. Struktura përgjegjëse për veprimtarinë e hidrokarbureve përgjigjet për kontrollin e sasive të rezervës së sigurisë në të gjitha subjektet”. Përsa i përket vënies së kriterëve teknike sqarojmë se nga ana e komisionit, ato janë vënë në përputhshmëri me natyrën objekt prokurimi, kjo në zbatim të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 40, pika 6, gërma “c”, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofrojnë mallra të cilat përmbushin standartet teknike dhe AK kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Gjithashtu, për të vërtetuar besueshmërinë e operatorit ekonomik pjesmarrës, që ai ka tregtuar karburante dhe nuk ka patur penalitete për shkelje cilësie, komisioni është bazuar në legjisllacionin e mëposhtëm: Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore, VKM nr. 147, datë 21.03.2007, “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”, Urdhërit të Ministrit nr. 6, datë 09.01.2015, “Për kontrollin e standarteve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse”. Pra komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël e vlerëson se operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e kërkuar nga ISHTI. Operatori Ekonomik “O.” Shpk e ka përmbushur detyrimin e kërkuar nga AK duke depozituar 2 (dy) Raporte Testimi, të cilat i keni bashkëlidhur.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket kërkesës së kriterit për paraqitjen e Fletë Analizë/Raport Testimi për artikullin Gazoil, ju bëjmë me dije se ky dokumentacion duhet të paraqitet nga OE përgjatë fazës së zbatimit të kontratës, me qëllim vërtetimin që mallrat e përdorura janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

8. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit nr. 4, për procedurën e marrjes në dorëzim të prokurimit me objekt “Blerje pjesë këmbimi dhe vendosje”, KLSH ka konstatuar se asnjë nga anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim nuk është specialist fushe. Për sa

më sipër shpjegojmë se marrja në dorëzim e punimeve të kryera për çdo procedurë “Furnizim vendosje pjesë këmbimi për mjetet e institucionit” është kryer nga një komision i veçantë, i cili ngrihet çdo fillim viti me urdhër të Prefektit të Qarkut “Komision i konstatimit të difekteve për automjetet dhe marrjes në dorëzim të punimeve të kryera”. Ky komision për çdo rast, konstaton dhe merr në dorëzim punimet që konstatohen/kryhen në mjetet e institucionit në bashkëpunim me një subjekt të licencuar (servis makinash). Për konstatimin e bërë nga KLSH-ja, procesverbali i mbajtur me subjektin e licencuar “A. G.” i datës 23.11.2023, ishte pjesë e dosjes të prokurimit (bashkëlidhur).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur nga Ju në observacion është i njëjti me atë të evidentuar nga grupi i auditimit në aktkonstatimin nr. 2, datë 26.07.2024, konkretisht procesverbali i datës 23.11.2023. Nga shqyrtimi i zbatimit të strukturës organizative është konstatuar se, asnjë prej anëtarëve nuk ka profilin/arsimin ku të klasifikohet si specialist fushe. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

3. Mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Prefekti i Qarkut Korçë është përfaqësues i Këshillit të Ministrave në Qarkun e Korçës. Ai kujdeset që ato të plotësojnë të gjitha detyrimet që kanë për të garantuar sovranitetin, rendin kushtetues dhe shëndetin publik, bashkërendon veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor, si dhe të këtyre me organet e qeverisjes vendore në qark. Gjithashtu drejton veprimtarinë e strukturave administrative shtetërore, të cilat me aktet ligjore e nënligjore të veçanta janë caktuar në varësinë e tij të drejtpërdrejtë.

Në juridiksionin e Prefektit të Qarkut Korçë përfshihet Këshilli i Qarkut si dhe gjashtë njësi të vetëqeverisjes vendore përkatësisht Bashkitë: Korçë, Pogradec, Devoll, Kolonjë, Maliq dhe Pustec. Kompetenca kryesore e Prefektit në raport me njësitë e vetëqeverisjes vendore është verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ në zbatim të përcaktimeve të nenit 16, të Ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”.

Prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën e mëposhtme:

-Çdo organ i njësisë së vetëqeverisjes vendore është i detyruar të depozitojë pranë institucionit të Prefektit të Qarkut të gjitha aktet me karakter normativ, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së tyre. Marrja dijoni nga Prefekti për aktin e depozituar nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore vërtetohet me regjistrimin e tij në zyrën e protokollit të institucionit. Për çdo akt të regjistruar në zyrën e protokollit, Prefekti detyrohet të shprehet për ligjshmërinë e tij, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, sipas procedurave të mëposhtme:

-Në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, Prefektit të Qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin.

-Vendimi i marrë nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga Prefekti i Qarkut, depozitohet pranë institucionit të prefektit me të njëjtën procedurë dhe afat sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të nenit 16, të Ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”.

-Në rast se vërehen përsëri papajtueshmëri ligjore në aktin e rishqyrtuar, Prefekti i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës është organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke kërkuar deklarimin e pavlefshëm të këtij akti. Prefekti i Qarkut ka të drejtën e kthimit vetëm një herë të një akti.

-Në rastet kur vëren shkelje ligjore në akt dhe vlerëson se kthimi i aktit nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk do të jetë i frytshëm, prefektit i lind e drejta që, pa ndjekur procedurën e përcaktuar në shkronjën “b”, nënparagrafi “i”, të kësaj pike (të neni 16 të sipërpërmendur), të kërkojë pavlefshmërinë e aktit drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës ndodhet organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kur kërkon pavlefshmërinë e aktit në gjykatë, Prefekti i Qarkut njofton organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Për sa i përket veprimtarisë së ushtruar për vitet 2022-2023 nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, grupi i auditimi kërkoj databazën në lidhje me aktet ligjore, nënligjore si dhe urdhrat e udhëzimet e nxjerra nga Prefekti ku konstatohet se:

-Për vitet 2022-2023 nga Sektori Juridik pranë Prefektit të Qarkut Korçë nuk është hartuar një regjistër në formë shkresore në të cilin të administrohen aktet ligjore, nënligjore si dhe urdhrat e udhëzimet e nxjerra nga titullari i institucionit. Vetëm për shkresat për të cilat është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore mbi aktet normative të nxjerra nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në juridiksionin e Prefektit të Qarkut Korçë disponohet një databazë në programin Excel. Veprime këto në kundërshtim me Rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e punës së institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë të miratuar me Urdhrin e Prefektit të Qarkut Korçë nr. 119, datë 15.12.2020, neni 15, gërma “g”, ku përcaktohet që: *“Mban një bazë të të dhënave me aktet ligjore, nënligjore, si dhe urdhrat e udhëzimet që nxjerr Prefekti i Qarkut”*.

Për periudhën nga data **01.01.2022, deri më 31.12.2023**, Prefekti i Qarkut Korçë është shprehur mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve të organeve të vetëqeverisjes vendore (Bashkitë Korçë, Pogradec, Devoll, Kolonjë, Maliq dhe Pustec) për **818 raste** (e ndarë në 486 raste për vitin 2022 dhe 332 raste për vitin 2023).

a. Evidenca e akteve për **vitin 2022** paraqitet në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë:

Viti 2022														
Nr.	Njësi të Qeverisjes Vendore	I Verifikimi i ligjshmërisë së akteve										II Verifikimi në vend		
		Puna me aktet										Akte gjithsej		
		Akte gjithësej të hyra tek Prefekti		Të bazuara në ligj		Të pa bazuara në ligj		Të rishqyrtuara në O.Q.V-të		Dërguar në gjykatë				
		Mujore	Prog.	Mujore	Prog.	Mujore	Prog.	Mujore	Prog.	Mujore	Prog.	Mujore	Prog.	Dërguar në gjykatë
1	Këshilli i Qarkut	5	21	5	21	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	Korçë	6	96	6	95	0	1	0	1	0	0	0	0	0
3	Maliq	2	88	2	79	0	9	0	4	0	0	0	0	0
4	Pustec	2	57	2	55	0	2	0	0	0	0	0	0	0
5	Pogradec	6	74	6	68	0	4	0	0	0	0	0	0	0
6	Kolonjë	4	78	3	68	1	10	0	3	0	0	0	0	0
7	Devoll	5	72	4	66	1	6	0	1	0	0	0	0	0
Totali		30	486	28	452	2	32	0	9	0	0	0	0	0

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Sektori Juridik.

Shënim: Diferenca prej 7 akteve në tabelën më sipër i përket akteve të depozituara në fund të muajit dhjetor të vitit 2022 dhe të shqyrtuara në muajin janar të vitit 2023.

Për vitin 2022 janë depozituar pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë nga njësitë e qeverisjes vendore në total **486 akte** nga të cilat për 452 akte është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore, 32 akte të pa bazuara ligj, 9 akte të rishqyrtuara nga organet e vetëqeverisjes vendore dhe nuk ka asnjë akt të dërguar në gjykatë.

Numri i akteve të regjistruara në institucionin e Prefektit i përkasin Bashkisë Korçë me 96 akte, Bashkia Maliq me 88 akte, Bashkia Kolonjë me 78 akte, Bashkia Pogradec me 74 akte, Bashkia Devoll me 72 akte, Bashkia Pustec me 57 akte dhe Këshilli i Qarkut Korçë me 21 akte.

b. Evidenca e akteve për vitin 2023 paraqitet në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë:

Viti 2023														
Nr.	Njësi të Qeverisjes Vendore	I										II		
		Verifikimi i ligjshmërisë së akteve										Verifikimi në vend		
		Puna me aktet										Akte gjithsej		
		Akte gjithësej të hyra tek Prefekti		Të bazuara në ligj		Të pa bazuara në ligj		Të rishqyrtuara në O.Q.V-të		Dërguar në gjykatë				Dërguar në gjykatë
Mujore	Prog.	Mujore	Prog.	Mujore	Prog.	Mujore	Prog.	Mujore	Prog.	Mujore	Prog.	Mujore	Prog.	
1	Këshilli i Qarkut	0	9	0	9	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	Korçë	5	63	5	57	0	6	0	3	0	2	0	0	0
3	Maliq	7	56	7	54	0	5	0	2	0	0	0	0	0
4	Pustec	5	29	5	29	0	0	0	0	0	0	0	0	0
5	Pogradec	6	53	5	51	1	2	0	0	0	0	0	0	0
6	Kolonjë	22	76	22	74	0	3	1	1	0	0	0	0	0
7	Devoll	14	46	14	46	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Totali	59	332	58	316	1	16	1	6	2	0	0	0	0

Burimi i të dhënave: Prefektura e Qarkut Korçë/Spektori Juridik.

Shënim: Diferenca prej 7 akteve në tabelën më sipër i përket akteve të depozituara në fund të muajit dhjetor të vitit 2022 dhe të shqyrtuara në muajin janar të vitit 2024.

Për vitin 2023 janë depozituar pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë nga njësitë e qeverisjes vendore në total **332 akte** nga të cilat për 316 akte është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore, 16 akte të pa bazuara ligj, 6 akte të rishqyrtuara nga organet e vetëqeverisjes vendore dhe 2 akte të dërguara në gjykatë.

Kryesisht vendimet me karakter normativ të Këshilit të Qarkut dhe KB të sipërpërmendur, që janë me intervale më të shpeshta kanë kryesisht objekt:

- Miratimin e buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- Numrin e punonjësve sipas strukturës organike;
- Nivelin e pagave për punonjësit e njësive vendore;
- Miratimin, ndryshimin dhe përdorimin e fondeve të PBA-ve;
- Dhënien e ndihmës ekonomike;
- Trajtimin e rasteve të emergjencave;
- Dhënien me qira të aseteve të njësive të vetëqeverisjes vendore etj.

Nga shqyrtimi i evidencave të mësipërme për vitet 2022-2023 konstatohet se, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore janë depozituar pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë jo vetëm akte me karakter normativ por edhe akte me karakter individual ose administrativ kolektiv. Ky veprim ka ardhur si pasojë e keq interpretimit nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore të termit “Akt normativ” të parashikuar në Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 3, pika 2, ku përcaktohet që: “Akt normativ nënligjor” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij”.

Gjithashtu, sipas nenit 2, pika 3, të Ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, “akt nënligjor normativ” është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron në zbatimin e tij.

Referuar bazës ligjore të cituar më sipër akti normativ përcakton rregulla për një situatë konkrete ose abstrakte dhe u drejtohet një numri të përcaktuar subjektsh. Në mënyrë të detajuar evidetohet kuptimi mbi terminologjinë e aktit administrativ individual dhe kolektiv:

- **Akti Administrativ Individual**

Akt Administrativ Individual bazuar në Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 3, pika 1, gërma “a”, ku citohet se: “*Është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete*”. Ky lloj akti ka pesë kritere përcaktuese:

1. Organin publik;
2. Ushtrimin e funksioneve publike;
3. Shprehjen e vullnetit;
4. Kundrejt një apo më shumë subjekte të përcaktuara individualisht të së drejtës;
5. Krijimin, ndryshimin ose shuarjen e marrëdhënieve juridike konkrete;

Në vijim po evidentohen disa raste të akteve administrative individuale që Bashkitë kanë dërguar për konfirmim pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë:

- a. Dhënie titujsh nderi;
- b. Dhënie dhe heqja e mandatit të Këshilltarëve;
- c. Dhënie bursash;
- d. Dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar;
- e. Dhënie e ndihmës për PAK (persona me aftësi të kufizuara);
- f. Dhënie e ndihmave për shkak të emergjencave personave të përcaktuar;
- g. Pranimi në shtëpinë e të moshuarve;
- h. Përfundimi i procedurave për legalizim banesash;
- i. Miratimi i komisioneve apo ndryshimet e tyre;
- j. Zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarit të Këshillit;
- k. Zgjedhja e Sekretarit të Këshillit;
- l. Dhënie e ndihmës financiare personave në nevojë;
- m. Propozime për dhënie statusi dëshmori;
- n. Miratim shpërblimesh anëtarëve të Këshillit bashkiak;
- o. Miratimin e pagesës me këste për subjekte të përcaktuara që kanë detyrime financiare bashkive;
- p. Dorëheqje të sekretarëve të Këshillave;
- q. Miratim shpronësimesh;
- r. Vendime për lidhje kontratash të ndryshme;
- s. Dhënie ndihme financiare personave në nevojë të përcaktuar individualisht.

Aktet e mësipërme duke i marrë në analizë përmbushin kriteret e aktit administrativ individual, ku si për rrjedhojë verifikimi ligjor i këtyre akteve nuk është në kompetencat e Institucionit të Prefektit të Qarkut.

▪ **Akti Administrativ Kolektiv**

Akti administrativ kolektiv, bazuar në Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 3, pika 1, gërma “b” ku citohet se: “*Është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete*”.

Akti administrativ kolektiv i drejtohet një grupi personash dhe dallon nga akti administrativ individual për shkak të papërcaktueshmërisë së personave që i përkasin këtij grupimi. Në lidhje me kriteret e tjera është si akti administrativ individual.

Në vijim po evidentohen disa raste të akteve administrative kolektive që Bashkitë kanë dërguar për konfirmim pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë:

- a. Futja e një zone monument kulture;
- b. Rehabilitimi i një apo disa rrugëve të përcaktuara;
- c. Ndërtimi i një parku agroturistik të përcaktuar;
- d. Zhvillimi i një blloku urban;
- e. Rikonstrukcion shkollash, çerdhesh, ambulancash ose qëndrash shëndetësore;
- f. Ndërtimi i lulishteve, fushave të futbollit, hapsirave të blerta;
- g. Ngritje e qendrave rinore;
- h. Miratimi i një investimi në një zonë të caktuar.

Aktet e mësipërme duke i marrë në analizë përmbushin kriteret e aktit administrativ kolektiv, ku si për rrjedhojë verifikimi ligjor i këtyre akteve nuk është në kompetencat e Institucionit të Prefektit të Qarkut.

Si konkluzion, Prefekti i Qarkut Korçë ka vepruar në kundërshtim të Ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 16, pika 2, ku përcaktohet se: “*Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.....*”.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe z. Dh. S., ish-Prefekt i Qarkut Korçë.

Akte jo normative jashtë kompetencës për shqyrim:

-Për **vitin 2022** në total janë **67** vendime të dërguara nga NjVV për konfirmimin e bazueshmërisë ligjore, drejtuar institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë të cilat janë konstatuar nga Prefekti si akte me karakter jo normativ por akte me karakter administrativ, individual ose kolektiv konkretisht, 4 vendime Këshilli i Qarkut, 14 vendime Bashkia Korçë, 5 vendime Bashkia Maliq, 36 vendime Bashkia Kolonjë dhe 8 vendime Bashkia Pogradec. Në mënyrë të detajuar lista e akteve me karakter jo normativ paraqitet në **Tabelën nr. 1, në Aneksin nr. 2**, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Për **vitin 2023** në total janë **72** vendime të dërguara nga NjVV për konfirmimin e bazueshmërisë ligjore, drejtuar institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë të cilat janë konstatuar nga Prefekti si akte me karakter jo normativ por akte me karakter administrativ, individual ose kolektiv konkretisht, 8 vendime Këshilli i Qarkut, 26 vendime Bashkia Korçë, 7 vendime Bashkia Maliq, 25 vendime Bashkia Kolonjë, 1 vendim Bashkia Pustec dhe 5 vendime Bashkia Pogradec. Në mënyrë të detajuar lista e akteve me karakter jo normativ paraqitet në **Tabelën nr. 2, në Aneksin nr. 2**, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Shqyrtimi i dokumentacionit të akteve

Për vitet 2022-2023, Sektori Juridik pasi ka marrë aktet e depozituara pranë institucionit të Prefektit, ka verifikuar në përgjithësi elementët formal të aktit administrativ:

Dokumentacioni shoqërues që duhet të përmbajë akti (projekt vendimi, relacioni shpjegues dhe në rastet kur kërkohet nga ligji këshillimi publik), në përputhje me nenin 99, të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”. Nga auditimi me zgjedhje i vendimeve të nxjerra dhe shqyrtimit të dokumentacionit shoqërues të praktikës konstatohet se, mungojnë procesverbalet e mbledhjeve në të cilat duhet të shënohet qartë emri mbiemri i këshilltarëve. Gjithashtu shkresat e nxjerra nga Prefekti i Qarkut Korçë drejtuar NjVV i adresohen Këshillave Bashkiak por jo Kryetarit të Bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut të miratuar me Urdhrin nr. 175, datë 09.07.2020, e Ministrisë të Brendshme, Aneksi nr. 1, “Rregulla për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu 2, gërma “b”, pika 1, ku përcaktohet që: “*Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentat e mëposhtëm:*

1. *Procesverbali i mbledhjes së këshillit*”. Si dhe me Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 18, përcaktohet që: “Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen. Procesverbalet e mbledhjeve të forumit të organit shtetëror shtypen veças për çdo çështje dhe nënshkruhen nga mbajtësi dhe titullari ose zëvendësi i tij (përjashtim bëjnë procesverbalet e mbledhjes së këshillit të bashkisë, të qarkut e të komunës, që firmosen nga kryetari, sekretari ose i ngarkuari me drejtimin e mbledhjes dhe së paku nga 3 këshilltarë). Kur mbledhja është e përbashkët me përfaqësues të dy a më shumë subjekteve, procesverbali nënshkruhet nga mbajtësi dhe nga titullari ose zëvendësit e secilit subjekt”.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë, z. Dh. S., ish-Prefekt i Qarkut Korçë dhe z. D. K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik.

Shqyrtimi i dokumentacionit të aktit

Për vitin ushtrimor 2023, sektori juridik pasi ka marrë aktet ka verifikuar në përgjithësi elementët formal të aktit administrativ:

Dokumentacioni shoqërues që duhet të përmbajë akti (projekt vendimi, relacioni shpjegues dhe në rastet kur kërkohet nga ligji këshillimi publik), në përputhje me nenin 99 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”. Megjithatë nga auditimi me zgjedhje i vendimeve të nxjerra dhe shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues mungojnë procesverbalet e mbledhjeve në të cilat duhet të shënohet qartë emri mbiemri i këshilltarëve.

Në shkresat e nxjerra nga Prefekti i Qarkut Korçë drejtuar NJVQV konstatohet se ato i adresohen Këshillave Bashkiak, por jo Kryetarit të Bashkisë.

Veprime këto në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut të miratuar me urdhrin nr. 175, datë 09.07.2020, e Ministrisë së Brendshme, Norma Tekniko-Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë si dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Afatet ligjore:

Nga auditimi me zgjedhje i akteve të dala nga Prefekti i Qarkut Korçë për vitet 2022-2023 konstatohet se, verifikimet mbi bazueshmërinë ligjore të tyre janë kryer brenda afateve ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 16, pika 2, gërmat “a-b”.

Verifikimi në vend i akteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore:

Për vitin 2022, me shkresën nr. 179 prot., datë 17.02.2023, të z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë është ngritur grupi i punës për verifikimin në vend të akteve në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Grupi i punës i sipërpërmendur ka marrë takim me sekretarët e këshillave për çdo NJVQV dhe nëpunësit e protokolleve përkatëse. Në lidhje me procedurën konstatohet se janë dërguar njoftimet planit të kontrollit për verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve normative për vitin 2022. Gjithashtu ka mbajtur akt-kontrollin tek çdo NJVQV. Në përfundim ky grup ka nisur drejt çdo bashkie shkresën për njohje me akt-kontrollin e verifikimit periodik. Korespondenca e mbajtur në formë shkresore evidentohet në mënyrë analitike në tabelën si më poshtë:

Nr.	NJVV	Periudha e Verifikimit të Akteve	Shkresa e Prefektit të Qarkut “Njoftim i Programit për Verifikim në Vend” Nr. Prot./ Data e shkresës së Prefektit	Akt- Kontrolli i mbajtur nga përfaqësuesit e Institucionit të Prefektit dhe NJ.V.V-së Nr. Prot./Data e Akt-Kontrollit	Shkresa “Rekomandime mbi Akt- Kontrollin e mbajtur nga përfaqësuesit e Institucionit të Prefektit dhe NJ.V.V-së Nr.prot./Data e shkresës së Prefektit
1	Këshilli i Qarkut Korçë	01.01.-31.12.2022	Nr. 187 prot., datë 20.02.2023	Nr. 187/1 prot., datë 21.02.2023	Nr. 187/2 prot., datë 23.02.2023

2	Bashkia Korçë	01.01.-31.12.2022	Nr. 208 prot., datë 24.02.2023	Nr. 208/1 prot., datë 27.02.2023	Nr. 208/2 prot., datë 28.02.2023
3	Bashkia Pustec	01.01.-31.12.2022	Nr. 916 prot., datë 25.10.2023	Nr. 916/1 prot., datë 26.10.2023	Nr. 916/2 prot., datë 26.12.2023
4	Bashkia Pogradec	01.01.-31.12.2022	Nr. 456 prot., datë 23.05.2023	Nr. 456/1 prot., datë 24.05.2023	Nr. 456/2 prot., datë 26.05.2023
5	Bashkia Devoll	01.01.-31.12.2022	Nr. 822 prot., datë 26.09.2023	Nr. 822/3 prot., datë 12.12.2023	Nr. 822/2 prot., datë 12.12.2023
6	Bashkia Kolonjë	01.01.-31.12.2022	Nr. 1027 prot., datë 01.12.2023	Nr. 1027/1 prot., datë 26.12.2023	Nr. 1027/2 prot., datë 26.12.2023
7	Bashkia Maliq	01.01.-31.12.2022	Nr. 804 prot., datë 21.09.2023	Nr. 804/1 prot., datë 21.09.2023	Nr. 804/3 prot., datë 11.12.2023

Nga auditimi i praktikës së sipërpërmendur konstatohet se, për vitin 2022 verifikimi i ligjshmërisë nga grupi i punës është kryer një herë në vit. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 17, pika 1, ku përcaktohet që: *“Prefekti i Qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, kur nuk përcaktohet ndryshe në akte të tjera ligjore, jo më pak se një herë në 3 muaj”*.

Për vitin 2023, me shkresën nr. 187 prot., datë 20.02.2023, të z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë është ngritur grupi i punës për verifikimin në vend të akteve në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Grupi i punës i sipërpërmendur ka marrë takim me sekretarët e këshillave për çdo NJVQV dhe nëpunësit e protokolleve përkatëse. Në lidhje me procedurën konstatohet se janë dërguar njoftimet planit të kontrollit për verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve normative për vitin 2023. Gjithashtu ka mbajtur akt-kontrollin tek çdo NJVQV. Në përfundim ky grup ka nisur drejt çdo bashkie shkresën për njohje me akt-kontrollin e verifikimit periodik. Korespondenca e mbajtur në formë shkresore evidentohet në mënyrë analitike në tabelën si më poshtë:

Nr.	NJVV	Periudha e Verifikimit të Akteve	Shkresa e Prefektit të Qarkut “Njoftim i Programit për Verifikim në Vend” Nr. Prot./Data e shkresës së Prefektit	Akt- Kontrolli i mbajtur nga përfaqësuesit e Institucionit të Prefektit dhe NJ.V.V-së Nr. Prot./Data e Akt-Kontrollit	Shkresa “Rekomandime mbi Akt- Kontrollin e mbajtur nga përfaqësuesit e Institucionit të Prefektit dhe NJ.V.V-së Nr.prot./Data e shkresës së Prefektit
1	Këshilli i Qarkut Korçë	01.01.-31.12.2023	Nr. 339 prot., datë 04.04.2024	Nr. 339/1 prot., datë 12.04.2024	Nr. 339/3 prot., datë 23.04.2024
2	Bashkia Korçë	01.01.-31.12.2023	Nr. 398 prot., datë 26.04.2024	Nr. 398/1 prot., datë 14.05.2024	Nr. 398/2 prot., datë 29.05.2024
3	Bashkia Pustec	01.01.-30.06.2023	Nr. 916 prot., datë 25.10.2023	Nr. 916/1 prot., datë 26.10.2023	Nr.916/2 prot., datë 26.12.2023
4	Bashkia Pustec	01.07.-31.12.2023	Nr. 479 prot., datë 21.05.2024	Nr. 479/1 prot., datë 27.05.2024	Nr. 479/2 prot., datë 29.05.2024
5	Bashkia Pogradec	01.01.-31.12.2023	Nr. 340 prot., datë 08.04.2024	Nr. 340/1 prot., datë 08.04.2024	Nr. 391/1 prot., datë 25.04.2024
6	Bashkia Devoll	01.01.-30.06.2023	Nr. 822 prot., datë 26.09.2023	Nr. 822/4 prot., datë 12.12.2023	Nr. 822/1 prot., datë 12.12.2023
7	Bashkia Devoll	01.07.-31.12.2023	Nr. 397 prot., datë 02.05.2024	Nr. 397/1 prot., datë 02.05.2024	Nr. 397/3 prot., datë 24.05.2024
8	Bashkia Kolonjë	01.01.-30.06.2023	Nr. 1027 prot., datë 01.12.2023	Nr. 1027/3 prot., datë 26.12.2023	Nr. 1027/4 prot., datë 26.12.2023
9	Bashkia Kolonjë	01.07.-31.12.2023	Nr. 478 prot., datë 21.05.2024	Nr. 478/1 prot., datë 28.05.2024	Nr. 478/3 prot., datë 05.06.2024
10	Bashkia Maliq	01.01.-30.06.2023	Nr. 804 prot., datë 21.09.2023	Nr. 804/2 prot., datë 21.09.2023	Nr. 804/3 prot., datë 11.12.2023
11	Bashkia Maliq	01.07.-31.12.2023	Nr. 399 prot., datë 26.04.2024	Nr. 399/1 prot., datë 21.05.2024	Nr. 399/2 prot., datë 22.05.2024

Nga auditimi i praktikës së sipërpërmendur konstatohet se, për vitin 2022 verifikimi i ligjshmërisë nga grupi i punës është kryer një herë në 6 muaj. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 17, pika 1, ku përcaktohet që: *“Prefekti i Qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, kur nuk përcaktohet ndryshe në akte të tjera ligjore, jo më pak se një herë në 3 muaj”*.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe z. Dh. S., ish-Prefekt i Qarkut Korçë.

Organi Këshillues pranë Prefektit të Qarkut:

Nga auditimi konstatohet se, **për vitet 2022-2023**, nga Prefekti i Qarkut Korçë nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e Organit Këshillues. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 23, pikat 1-3, ku përcaktohet që: *“1. Pranë Prefektit të qarkut funksionon organi këshillues i tij. Përbërja e këtij organi caktohet me urdhër të prefektit të qarkut. 2. Në organin këshillues marrin pjesë kryetari i këshillit të qarkut, kryetarët e bashkive, drejtori i policisë vendore, drejtuesit e njësisë së Forcave të Armatosura për qarkun, drejtuesit e shërbimit shëndetësor, drejtuesit e drejtorisë arsimore rajonale, drejtuesit e*

drejtorive rajonale të tatimeve dhe doganave, drejtues të tjerë të degëve territoriale që veprojnë në qark, të caktuar nga prefekti, si dhe përfaqësues nga shoqëria civile. 3. Organi këshillues mbledhet një herë në muaj për probleme të përgjegjësive të prefektit të qarkut, ku, për raste të veçanta, mund të thirren edhe specialistë të fushave përkatëse”.

Vendime të miratuara nga Prefekti i Qarkut Korçë për periudhën para zgjedhore për vitin 2023:

Për vitin 2023 në periudhën 4 mujore para zgjedhore nga KB të Bashkive, Korçë, Pogradec, Kolonjë, Devoll, Pustec, Maliq dhe Këshilli i Qarkut janë marrë 88 vendime nga muaji Janar deri para datës 14 Maj 2023, datë e cila përkon me zgjedhjet lokale në Republikën e Shqipërisë. Prefekti i Qarkut Korçë është shprehur mbi bazueshmërinë ligjore të aktit për 57 vendime gjatë kësaj periudhe për të cilat nuk janë konstatuar parregullsi ndërsa 31 vendime janë kthyer për arsye se kanë qenë akte me krakter individual ose kanë qenë vendime të cilat kufizohen si të ndaluara në *Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjellsjes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, Kreu II “Kategoritë e veprimtarive publike të ndaluara”, Neni 3 “Veprimtari të ndaluara”, pika 1.1, gërma “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, pika 1.2, pika 1.3, gërma “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, pika 2, pika 3, pika 4, pika 5, pika 6.*

Akte të rishqyrtuara:

a. Për vitin 2022 në total janë 9 akte të dërguar për rishqyrtim nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë drejt njësisë të vetëqeverisjes vendore konkretisht:

➤ Bashkia Korçë

1. KB Korçë ka nxjerrë Vendimin nr. 147, datë 22.12.2021, me objekt “Për miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Korçë”. Ky akt është konsideruar në kundërshtim me ligjin nga e Prefektit të Qarkut Korçë. Sipas konstatimit të Prefektit VKB nr. 147, datë 22.12.2021, është kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në nenin 28, neni 65, të Ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen civile”, pasi nuk rezulton që Bashkia Korçë të ketë parashikuar fondin minimal prej 4% të totalit të buxhetit vjetor, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara nga buxheti i shtetit.

Referuar nenit 28, pika 1 dhe pika 2, gërma “a”, të Ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019, citohet se: “1. Prefekti i qarkut ka rol parësor në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në nivel qarku. 2. Përveç detyrave të përcaktuara në ligjin për prefektin e qarkut, prefekti i qarkut ka dhe këto detyra: a. Të kthejë buxhetin e vitit pasardhës të bashkive, brenda territorit administrativ të tij, në rast se nuk janë planifikuar fondet buxhetore për marrjen e masave për zvogëlimin e rriskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas parashikimeve të nenit 65 të ligjit”.

Rishqyrtimi i aktit

Me VKB Korçë nr. 6, datë 27.01.2022, “Për rishqyrtimin e VKB-së Korçë nr. 147, datë 22.12.2021, me objekt “Për miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Korçë”, është vendosur lënia në fuqi e këtij vendimi.

Pasi është bërë shpërndarja e fondeve për Mbrojtjen Civile në masë 4% Prefekti i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB Korçë nr. 6, datë 27.01.2022, me shkresën nr. 95/2 prot., datë 07.02.2022.

➤ Bashkia Maliq

2. KB Maliq ka nxjerrë Vendimin nr. 28, datë 25.02.2022, me objekt “Për miratimin e listës të tokave të pandara bujqësore në fshatin Zboq, Njësia Administrative Libonik, me qëllim dhënien

me qira të tyre”. Prefekti i Qarkut Korçë ka kërkuar nga KB Maliq përditësimin e listës së tokave bujqësore të pandara që do të jepen me qira (*referuar lidhjes nr. 1, bashkëlidhur vendimit*), duke e sjellë atë në përputhje me listën e tokave bujqësore të konfirmuar nga DAMT Qarku Korçë. Gjithashtu është kërkuar që tokat, objekt i dhënies me qira, janë në pronësi apo përdorim të Bashkisë Maliq, si dhe detyrimin e bashkisë për inventarizimin dhe regjistrimin e tokave që i kanë kaluar në përdorim/pronësi pranë ASHK-së Drejtoria Vendore Korçë.

Rishqyrtimi i aktit

Me VKB Maliq nr. 42, datë 29.04.2022, me objekt “Për rishqyrtimin e Vendimit nr. 28, datë 25.02.2022, “Për miratimin e listës të tokave të pandara bujqësore në fshatin Zboq, Njësia Administrative Libonik, me qëllim dhënien me qira të tyre” ku u vendos të bëhen ndryshimet e kërkuara nga Prefekti.

Me shkresën nr. 640/2 prot., datë 11.05.2022, Prefekti i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB nr. 42, datë 29.04.2022.

➤ Bashkia Kolonjë

3. KB Kolonjë ka nxjerrë Vendimin nr. 21, datë 28.02.2022, me objekt “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2022”. Nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë ky akt është konstatuar në mospërputhje me aktin e miratuar me Vendimin nr. 1, datë 11.01.2022, pika 2 e tij, pasi vlera për rehabilitimin e sheshit hyrës të fshatit Rehovë rezultoi më e vogël se fondi i kërkuar për mbulimin e shpenzimeve nga bashkia.

Rishqyrtimi i aktit

Me VKB Kolonjë nr. 27, datë 29.03.2022, “Për rishqyrtimin e VKB nr. 21, datë 28.02.2022, “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2022” ku u vendos për ndryshimin e buxhetit.

Institucioni i Prefektit është shprehur me shkresën nr. 330/2 prot., 12.04.2022, për ndjekjen e procedurave ligjore pasi është konstatuar se objekti i Vendimit nr. 27, datë 29.03.2022, është i njëjtë me objektin e Vendimit nr. 21, datë 28.02.2022, të cilat nuk janë konfirmuar për bazueshmërinë e tyre ligjore.

Nga auditimi i dosjes së mësipërme konstatohet se edhe pse Prefekti ka konfirmuar pabazueshmërinë ligjore si për Vendimin nr. 21, datë 28.02.2022, me objekt “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2022” po ashtu edhe për Vendimin e rishqyrtuar nr. 27, datë 29.03.2022, “Për rishqyrtimin e VKB nr. 21, datë 28.02.2022, “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2022”, gjithsesi nuk ka ndjekur procedura të mëtejshme ligjore që në këtë rast është ti dërgohet gjykatës kompetente.

Veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 16, pika 2, gërma “iii”, ku theksohet se: “Në rast se vërehen përsëri papajtueshmëri ligjore në aktin e rishqyrtuar, prefekti i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës është organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke kërkuar deklarinë e pavlefshëm të këtij akti”.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë.

4. KB Kolonjë ka nxjerrë Vendimin nr. 24, datë 28.02.2022, me objekt “Për miratimin e përballimit të shpenzimeve të emergjencave civile të shkaktuara nga reshjet e dëborës të datës 29.01.2022, dhe 01.02.2022, në territorin e Bashkisë Kolonjë”. Nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë është konstatuar se VKB nuk përputhet me përcaktimet e nenit 54, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe neni 42, pika 2, neni 44, i Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, pasi

pas miratimit të buxhetit vendor në nivel programi, rishpërndarja e fondeve brenda të njëjtit program bëhet me urdhër të titullarit të bashkisë.

Rishqyrtimi i aktit

VKB Kolonjë nr. 26, datë 29.03.2022, “Për rishqyrtimin e VKB nr. 24, datë 28.02.2022, “Për miratimin e përballimit të shpenzimeve të emergjencave civile të shkaktuara nga reshjet e dëborës të datës 29.01.2022, dhe 01.02.2022, në territorin e Bashkisë Kolonjë”.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë është shprehur me shkresën nr. 330/2 prot., datë 12.04.2022, për ndjekjen e procedurave ligjore pasi është konstatuar se objekti i Vendimit nr. 26, datë 29.03.2022, është i njëjtë me objektin e Vendimit nr. 24, datë 28.02.2022, të cilat nuk janë konfirmuar për bazueshmërinë e tyre ligjore.

Nga auditimi i dosjes së mësipërme konstatohet se edhe pse Prefekti i Qarkut Korçë ka konfirmuar pabazueshmërinë ligjore si për Vendimin nr. 24, datë 28.02.2022, “Për miratimin e përballimit të shpenzimeve të emergjencave civile të shkaktuara nga reshjet e dëborës të datës 29.01.2022, dhe 01.02.2022, në territorin e Bashkisë Kolonjë” po ashtu edhe për Vendimin e rishqyrtuar nr. 26, datë 29.03.2022, “Për rishqyrtimin e VKB nr. 21, datë 28.02.2022, “Për rishqyrtimin e VKB nr. 24, datë 28.02.2022, “Për miratimin e përballimit të shpenzimeve të emergjencave civile të shkaktuara nga reshjet e dëborës të datës 29.01.2022, dhe 01.02.2022, në territorin e Bashkisë Kolonjë”, gjithsesi nuk ka ndjekur procedura të mëtejshme ligjore që në këtë rast është ti dërgohet gjykatës kompetente.

Veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 16, pika 2, gërma “iii”, ku theksohet se: *“Në rast se vërehen përsëri papajtueshmëri ligjore në aktin e rishqyrtuar, prefekti i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës është organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke kërkuar deklarin e pavlefshëm të këtij akti”.*

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë.

5. KB Kolonjë ka nxjerrë Vendimin nr. 26, datë 29.03.2022, “Për rishqyrtimin e VKB nr. 24, datë 28.02.2022, “Për miratimin e përballimit të shpenzimeve të emergjencave civile të shkaktuara nga reshjet e dëborës të datës 29.01.2022, dhe 01.02.2022, në territorin e Bashkisë Kolonjë”. Nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë është konstatuar se VKB nuk përputhet me përcaktimet e nenit 54, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe neni 42, pika 2, neni 44, i Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, pasi pas miratimit të buxhetit vendor në nivel programi, rishpërndarja e fondeve brenda të njëjtit program bëhet me urdhër të titullarit të bashkisë.

Rishqyrtimi i aktit

VKB Kolonjë nr. 46, datë 17.05.2022, “Për rishqyrtim dhe miratim për ndryshimin në buxhetin e Bashkisë Kolonjë për vitin 2022, për mbulimin e shpenzimeve të shkaktuara nga emergjencat dimërore, ardhur si pasojë e reshjeve të borës, të rëna në datat 29.01.2022, dhe 01.02.2022, në territorin e bashkisë Kolonjë”.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë është shprehur duke konfirmuar bazueshmërinë ligjore me shkresë nr. 518/2, datë 30.05.2022, pasi Këshilli i Bashkisë Kolonjë ka miratuar ndryshimin e strukturës buxhetore (pakësim, shtesa në programe të ndryshme) si dhe ka anuluar VKB nr. 26, datë 29.03.2022.

➤ Bashkia Devoll

6. KB Devoll ka nxjerrë Vendimin nr. 93, datë 20.12.2021, me objekt “Për nivelin e pagave të bashkisë Devoll për vitin 2022”. Nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë është konstatuar se baza

ligjore e vendosur për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit arsimorë, është bërë me VKM nr. 177, datë 08.03.2017, dhe jo me VKM nr. 175, datë 08.03.2017, e cila trajton punonjësit arsimorë.

Rishqyrtimi i aktit

VKB Devoll nr. 17, datë 28.02.2022, “Për një ndryshim në VKB nr. 93, datë 20.12.2021, “Për nivelin e pagave të bashkisë Devoll për vitin 2022”.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë është shprehur duke konfirmuar ligjshmërinë me shkresë nr. 241/3 prot., datë 15.03.2022. Bashkia ka përcaktuar nivelin e pagave për punonjësit në Agjencinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve brenda kufirit të pagave, që i përket NjVV-së Bashkia Devoll.

7. KB Devoll ka nxjerrë Vendimin nr. 32, datë 28.02.2022, me objekt “Për miratimin e raportit tekniko-ekonomik për dhënie me qira të fondit pyjor të sipërfaqes në pronësi të Bashkisë Devoll, subjektit “A. A.” Shpk, për veprën e marrjes së ujit “H. Q.”. Nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë është konstatuar se Vendimi nr. 32, datë 28.02.2022, është marrë në tejkalim të kompetencave të këshillit të bashkisë, pasi ka miratuar studimin tekniko-ekonomik, i cili sipas përcaktimeve të pikës 8, pikës 26 dhe 28, shtojca 1 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016, të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullor”, është në kompetencë të titullarit të bashkisë, pas paraqitjes së studimit e kërkesës nga struktura përgjegjëse për pyjet e kullotat në bashki.

Rishqyrtimi i aktit

VKB Devoll nr. 44, datë 30.05.2024, me objekt “Për dhënien e pëlqimit për dhënie me qira të fondit pyjor të sipërfaqes subjektit “A. A.” Shpk (H. Q.), për veprën e marrjes së ujit “H. Q.”.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë është shprehur me shkresën nr. 569/2 prot., datë 13.06.2022, pasi Bashkia Devoll ka marrë në konsideratë vlerësimin ligjor e argumentat e dhëna nga institucioni, duke miratuar vetëm pëlqimin e këshillit të bashkisë për dhënien me qira të fondit pyjor, pas miratimit të studimit tekniko-ekonomik nga kryetari i bashkisë.

➤ Bashkia Pogradec

8. KB Pogradec ka nxjerrë Vendimin nr. 94, datë 18.11.2021, me objekt “Për një ndryshim në Vendimin nr. 15, datë 01.03.2017, “Për miratimin e orareve dhe stacioneve për linjat rreth qytetëse”. Nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë është konstatuar se bashkia nuk ka kryer dëgjesa publike sipas përcaktimeve të nenit 18 dhe 54 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe nuk rezultoi të kishte bërë një analizë të përcaktimeve që kërkon neni 19, paragrafi V, i Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore” i ndryshuar, përkatësisht hartimi i rrjetit të linjave rrethqytetëse dhe ndërqytetëse bazohet mbi të dhënat demografike e gjeografike, gjendjen social-ekonomike, kërkesat për lëvizjen e popullatës, rrjetin rrugor dhe gjendjen e infrastrukturës rrugore.

Rishqyrtimi i aktit

VKB Pogradec nr. 7, datë 20.01.2022, me objekt “Për lënien në fuqi të Vendimit nr. 94, datë 18.11.2021, “Për një ndryshim në Vendimin nr. 15, datë 01.03.2017, “Për miratimin e orareve dhe stacioneve për linjat rreth qytetëse”.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë është shprehur duke konfirmuar ligjshmërinë e vendimit nr. 94, datë 18.11.2021 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 15, datë 01.03.2017, “Për miratimin e orareve dhe stacioneve për linjat rreth qytetëse” me shkresë nr. 83/2 prot., datë 03.02.2022. Bashkia ka arsyetuar se efekti i vendimit është përmirësimi i shërbimit të transportit të udhëtarëve në linjat e rregullta rrethqytetëse dhe nuk ka ligj që të parashikojë dëgjesat publike.

Nga auditimi i vendimit të mësipërm konstatohet se Prefekti e ka kthyer vendimin për rishikim herën e parë. Bashkia Pogradec mbështetur në ligjin nr. 139/2015, datë 27.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” shprehet se nuk ka bazë ligjore për termin “dëgjuesë publike”.

Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 27.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 18 pika 1 ku përcaktohet se: *“Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet 54, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, dhe 77, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, të këtij ligji”* (përkatësisht ky vendim gjen vend te pika “k” e cila shprehet miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik)”.

Duke qenë se Vendimi i mësipërm nr. 15, datë 01.03.2017, “Për miratimin e orareve dhe stacioneve për linjat rreth qytetëse” është një vendim që prek interesin publik ky këshillim është i detyruar të zbatohet.

Si për rrjedhojë, Prefekti i Qarkut Korçë nuk duhej të kishte konfirmuar ligjshmërinë e këtij vendimi dhe të kishte proceduar bazuar në Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma “iii” ku theksohet se: *“në rast se vërehen përsëri papajtueshmëri ligjore në aktin e rishqyrtuar, prefekti i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës është organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke kërkuar deklarin e pavlefshëm të këtij akti”*.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë.

➤ **Bashkia Pustec**

9. KB Pogradec ka nxjerrë Vendimin nr. 18, datë 29.04.2022, “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të automjeteve të bashkisë Pustec”. Prefekti i Qarkut Korçë ka dalë në konkluzion se është marrë vendim për nxjerrjen jashtë përdorimit të mjeteve dhe dërgimin e tyre pranë Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit. Ky proces duhet t’i nënshtrohet përcaktimeve të Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008, “Për ankandin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 1242, datë 16.12.2009, “Për rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës, që nxiret në ankand, si dhe për mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor”.

Rishqyrtimi i aktit

Vendim nr. 24, datë 26.05.2022, “Për një korrigjim në Vendimin nr. 18, datë 29.04.2022, “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të automjeteve të bashkisë Pustec”.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë është shprehur duke konfirmuar ligjshmërinë e Vendimit me shkresë nr. 560/1 prot., datë 03.06.2022, pasi Bashkia Pustec ka marrë në konsideratë vlerësimin ligjor e argumentat e dhena nga institucioni.

b. Për vitin 2023 në total janë 6 akte të dërguar për rishqyrtim nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë drejt njësive të vetëqeverisjes vendore konkretisht:

➤ **Bashkia Korçë**

1. Me Vendim nr. 179, datë 28.12.2022, KB Korçë ka vendosur “Për dhënien e ndihmës financiare për z. A. D për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e tij”. Pas kërkesës së Prefektit të Qarkut Korçë për rishqyrtimin e aktit, KB Korçë me Vendim nr. 12, datë 25.01.2023, ka vendosur “Për miratimin e lënies në fuqi të VKB nr. 179, datë 28.12.2022, “Për dhënien e ndihmës financiare për z. A. D për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e tij”.

Arsyet ligjore të argumentuara nga Prefekti mbi të cilat është kërkuar rishqyrtimi i Aktit janë se, Akti i miratuar vjen në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në VKM nr. 329, datë 16.05.2012,

“Për kriteret e procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” pasi në Kreun III, pika 3, gërma “ç” të kësaj VKM, masa e përcaktuar është më e lartë se shuma e mbledhur nga preventivat e nxjerra nga komisioni i ekspertëve në Këshillin e Qarkut. Masa e ndihmës financiare për dëmtime individuale ose në grupe të vogla të banesave jepet nga Ministria e Mbrojtjes ose NJVV-të nëpërmjet fondit të miratuar në buxhetin e vitit në programin “Emergjenca Civile”. Referuar gërmës “ç”, të VKM të sipërpëmedur, kjo masë llogaritet në të njëjtën mënyrë sic përcaktohet në shkronjat “b” dhe “c” të kësaj pike dhe do të jetë 50% e vlerës të llogaritur.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë është shprehur me shkresë nr. 104/1 prot., datë 03.02.2023, nëpërmjet të cilës ka njoftuar Bashkinë Korçë se mbajnë të njëjtin qëndrim, pasi Vendimi nr. 179, datë 28.12.2022, është lënë në fuqi me Vendimin nr. 12, datë 25.01.2023, pa ndryshime. Për këtë institucioni ka kërkuar pavlefshmërinë e akteve në Gjykatën Administrative. Aktualisht kjo çështje është në pritje të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

2. Me Vendim nr. 14, datë 25.01.2023, KB Korçë ka vendosur “Për një shtesë mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve të administratës së Bashkisë Korçë”. Pas kërkesës së Prefektit të Qarkut Korçë për rishqyrtimin e aktit, KB me Vendim nr. 25, datë 09.02.2023, “Për rishqyrtimin e VKB nr. 14, datë 25.01.2023, “Për një shtesë mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve të administratës së Bashkisë Korçë” është lënë në fuqi pa ndryshime. Arsyet ligjore të argumentuara nga Prefekti mbi të cilat është kërkuar rishqyrtimi i Aktit janë se, në aktin nr. 14/2023, të miratuar nga KB Korçë dhe sipas referimit ligjor të përdorur në relacionin bashkëlidhur, nuk argumentohet nevoja për hapjen e pozicioneve shtesë së Bashkisë Korçë për vitin 2023. Institucioni i Prefektit ka kërkuar që gjatë rishqyrtimit të aktit të argumentohet domosdoshmëria e rritjes të numrit të punonjësve dhe cila është ajo pjesë e strukturës që ka nevojë për shtesë punonjësish, pa kaluar ende një muaj nga vendimi i KB Korçë “Për miratimin e buxhetit dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve për vitin 2023”. Është kërkuar dhënia e sqarimeve mbi Programin Intership dhe pse ky program nuk ishte përfshirë në buxhetin e vitit 2023. Gjithashtu janë kërkuar sqarime rreth nevojës për aplikimin e këtij programi, shtrirjen e tij në kohë dhe rregullimin ligjor të punësimit për 10 punonjësit që kërkohen të shtohen.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë është shprehur me shkresë nr. 154/1 prot., datë 10.02.2023, nëpërmjet të cilës ka njoftuar Bashkinë Korçë se mban të njëjtin qëndrim, pasi Vendimi nr. 14, datë 25.01.2023, është lënë në fuqi me Vendimin nr. 25, datë 09.02.2023, Për këtë institucioni ka kërkuar pavlefshmërinë e akteve në Gjykatën Administrative. Aktualisht kjo çështje është në pritje të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

3. Me Vendimin nr. 110, datë 15.08.2023, KB Korçë ka vendosur “Për miratimin e hartëzimit të pjesshëm të zhurmës”. Pas kërkesës së Prefektit të Qarkut Korçë për rishqyrtimin e aktit, KB me Vendim nr. 132, datë 28.09.2023, “Për rishqyrtimin dhe ndryshimin e VKB nr. 110, datë 15.08.2023, “Për miratimin e hartëzimit të pjesshëm të zhurmës”, ka ndryshuar vendimin duke hequr 2 nga zonat e përcaktuara në hartëzimin e pjesshëm të zhurmave si dhe ka plotësuar vendimin e hartat përkatëse.

Arsyet ligjore të argumentuara nga Prefekti mbi të cilat është kërkuar rishqyrtimi i aktit janë se, në aktin nr. 110, datë 15.08.2023, të KB Korçë, Bashkia ka miratuar hartëzimin e pjesshëm të zhurmave për 4 zona të Qytetit të Korçës dhe përcaktimin e orareve për lejimin e muzikës në këto zona. Institucioni i Prefektit ka argumentuar se ky akt nuk i përgjigjet kërkesave të Ligjit nr. 50/2023, datë 22.06.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i ndryshuar, për arsye se neni 8/b, përcakton

se bashkia është përgjegjëse për marrjen e masave për mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit nga veprimtaritë ekonomike që lëshojnë zhurmë, ndër të tjera, duke bërë “hartëzimin e zhurmës” si pjesë e një procesi të rregulluar nga nenet 13, 20 dhe 21 të ligjit, dhe jo “hartëzim të pjessëshëm të zhurmës”, sikurse rezulton në VKB nr. 110, datë 15.08.2023. Gjithashtu bashkëlidhur aktit të miratuar dhe relacionit të paraqitur nuk është paraqitur harta për përcaktimin e nivelit kufi të zhurmave për 4 zonat e lejuara. Ndërsa fasha orare për lejimin e aktiviteteve për 2 nga zonat e përcaktuara në vendim, është në kundërshtim me pikën 2, të nenit 8/1, të Ligjit nr. 50/2023, datë 22.06.2023.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë është shprehur me shkresë nr. 831/2 prot., datë 06.10.2023. Bashkia Korçë, ka ndryshuar vendimin duke hequr 2 nga zonat e përcaktuara në hartëzimin e pjesshëm të zhurmave si dhe ka plotësuar vendimin me hartat përkatëse. Pas daljes të ligjit 50/2023, kompetenca për kontrollin e orarit të lejimit të muzikës i është hequr NJVV-ve duke i kaluar Drejtorisë Vendore të Policisë të Qarkut.

Bashkia Kolonjë

4. Me Vendimin nr. 25, datë 27.02.2023, të KB Kolonjë me objekt “Për mbulimin e shpenzimeve për përballimin e fatkeqësisë natyrore, lidhur me kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale të shkaktuara nga rreshjet e dëborës, erave të forta, temperaturave ekstreme të datës 03.02.2023, në territorin e Bashkisë Kolonjë”, është miratuar shpërndarja e fondeve buxhetore duke pakësuar vlerën 1,499,971 lekë nga Fondi Rezervë dhe shtuar për shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve.

Me shkresën nr. 235/2 prot., datë 15.03.2023, të z. N. J. Prefekt i Qarkut Korçë me objekt “Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit”, drejtuar KB Kolonjë, nuk ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 25, datë 27.02.2023, për arsye se ka parregullsi në përlllogaritjen e preventivit mbi orët e punës së mjetit të marrë në përdorim të përkohshëm sipas akt-marrëveshjes me nr. 5699 prot., datë 17.01.2023.

Nga auditimi i dokumentacionit të lidhur praktikës së administruar në Prefekturën e Qarkut Korçë me nr. 235 prot., datë 06.03.2023, konstatohet se:

Për përballimin e kësaj situate ndërmjet Bashkisë Kolonjë përfaqësuar nga z. E. I. Kryetar i Bashkisë Kolonjë dhe OE “D. K.” për marrjen në përdorim të përkohshëm i mjetit Fadromë tip Fiat me targë T. është lidhur Akt-Marrëveshja nr. 5699 prot., datë 17.01.2023. Pagesa për këtë shërbim do të kryhet sipas orëve të punës në zbatim të VKM nr. 654, datë 18.02.2002, “Për përcaktimin e tarifave për përdorim të përkohshëm nga organet shtetërore, në situata emergjente, të mjeti privat”, tabela nr. 3, mjete gjermimi, nr. 14, me 3,607 lekë për orë/pune.

Akt-Marrëveshja nr. 5699 prot., datë 17.01.2023, cilëson se Bashkia Kolonjë merr në përdorim të përkohshëm një mjet fadromë të tipit Fiat i cili do të punojë për interesa të bashkisë. Referuar afatit prej datës 04.02.2023, deri më datë 19.02.2023, të pasqyruara në preventiv si dhe në situacion konstatohet se për 15 ditë ky mjet ka punuar në total 498 orë punë. Ndërkohë që duke i llogaritur konstatohet se 15 ditë x 24 orë = 360 orë/punë, kjo maksimalisht nëse do të punohej 24/24 orë. Nga sa më lart konstatohet një pamundësi reale e rakordimit të sasisë së orëve të punës të përcaktuara në preventiv dhe në situacion nga ku rezulton se 498 orë/punë (fakt) - 360 orë/punë (reale) = në total 138 orë/punë tepricë. Nga OE “D. K.” ka dalë fatura elektronike e fiskalizuar me nr. 1/2023, datë 24.02.2023, me vlerë totale 1,499,970.95 lekë me Tvsh, që i përket 498 orë pune dhe jo 360 orë pune. Në lidhje me këtë situatë Prefekti i Qarkut Korçë nuk ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të aktit duke e kthyer për rishqyrtim, por Bashkia Kolonjë ka vazhduar me përmbushjen e Akt-Marrëveshjes.

Për sa trajtuar më sipër edhe pse Prefekti i Qarkut Korçë ka konstatuar mospërputhje të dokumentacionit si dhe pasaktësi në llogaritje si për Vendimin nr. 25, datë 27.02.2023, “Për

mbulimin e shpenzimeve për përballimin e fatkeqësisë natyrore, lidhur me kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale të shkaktuara nga rreshjet e dëborës, erave të forta, temperaturave ekstreme të datës 03.02.2023 në territorin e Bashkisë Kolonjë” po ashtu edhe për Vendimin e rishqyrtuar nr. 73, datë 30.06.2023, “Për mbulimin e shpenzimeve për përballimin e fatkeqësisë natyrore, lidhur me kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale të shkaktuara nga rreshjet e dëborës, erave të forta, temperaturave ekstreme të datës 03.02.2023, në territorin e Bashkisë Kolonjë”, gjithsesi nuk ka ndjekur procedura të mëtejshme ligjore që në këtë rast është ti drejtohet gjykatës kompetente. Veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 16, pika 2, gërma “iii” ku përcaktohet që: *“Në rast se vërehen përsëri papajtueshmëri ligjore në aktin e rishqyrtuar, prefekti i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës është organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke kërkuar deklarinë e pavlefshëm të këtij akti”*.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. N. J., në cilësinë e Prefektit të Qarkut Korçë.

➤ **Bashkia Maliq**

5. Me Vendimin nr. 34, datë 29.03.2023, KB Maliq ka vendosur “Mbi miratimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq dhe Këshillit të Qarkut Korçë me qëllim mbrojtjen dhe përfshirjen sociale për të moshuarit”. Pas kërkesës së Prefektit të Qarkut Korçë për rishqyrtimin e aktit, KB me Vendim nr. 73, datë 30.06.2023, “Mbi miratimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq dhe Këshillit të Qarkut Korçë me qëllim mbrojtjen dhe përfshirjen sociale për të moshuarit”.

Arsyet ligjore të argumentuara nga Prefekti mbi të cilat është kërkuar rishqyrtimi i aktit janë se, akti është miratuar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 91/4 të Kodit Zgjedhor, Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ dhe Udhëzuesit nr. 11, datë 10.02.2023, të Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil “Për masat që duhet të ndërmarrin institucionet shtetërore e vendore gjatë periudhës zgjedhore”. Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë është shprehur me shkresë nr. 590/1 prot., datë 12.07.2023, pasi Bashkia Maliq ka rishqyrtuar e miratuar aktin pas përfundimit të periudhës zgjedhore për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023.

6. Me Vendimin nr. 36, datë 29.03.2023, KB Maliq ka vendosur “Për disa ndryshime në VKB nr. 105, datë 19.12.2022, “Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës të bashkisë dhe strukturave të tjera për vitin 2023”. Pas kërkesës së Prefektit të Qarkut Korçë për rishqyrtimin e aktit, KB me Vendim nr. 99, datë 18.09.2023, “Për ndryshimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë Maliq e strukturave të tjera për vitin 2023”, ka rishqyrtuar e miratuar aktin.

Arsyet ligjore të argumentuara nga Prefekti mbi të cilat është kërkuar rishqyrtimi i aktit janë se, akti është miratuar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 91/4, të Kodit Zgjedhor, Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ dhe Udhëzuesit nr. 11, datë 10.02.2023, të Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil “Për masat që duhet të ndërmarrin institucionet shtetërore e vendore gjatë periudhës zgjedhore”. Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë është shprehur me shkresë nr. 802/1 prot., datë 02.10.2023, pasi Bashkia Maliq ka rishqyrtuar e miratuar aktin pas përfundimit të periudhës zgjedhore për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 dhe konstituimit të këshillit të ri.

Për periudhën nga data **01.01.2022, deri më 31.12.2023**, Prefektura e Qarkut Korçë është shprehur mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve të organeve të vetëqeverisjes vendore (Bashkitë Korçë, Pogradec, Devoll, Kolonjë, Maliq dhe Pustec) për **818 raste** (e ndarë në 486 raste për vitin 2022 dhe 332 raste për vitin 2023).

Me zgjedhje në total janë audituar **235 raste** në masën **28.7%** (e ndarë në **103** raste për vitin 2022 dhe **132** raste për vitin 2023) konkretisht:

-Për vitin 2022, 69 raste Bashkia Korçë, 2 raste Bashkia Pogradec, 21 raste Bashkia Kolonjë, 11 raste Bashkia Pustec;

-Për vitin 2023, 27 raste Bashkia Korçë, 27 raste Bashkia Pogradec, 44 raste Bashkia Kolonjë, 14 raste Bashkia Maliq, 4 raste Bashkia Pustec, 19 raste Bashkia Devoll.

Nga auditimi me zgjedhje mbi bazueshmërinë ligjore të dhënë nga Prefekti i Qarkut Korçë të akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore për vitin 2022, konstatohet që:

➤ **Bashkia Korçë**

1. Me Vendimin nr. 105, datë 30.06.2022, të KB Bashkiak Korçë me objekt “Për një ndryshim në Vendimin nr. 137, datë 25.11.2021, për “Nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2022”, është kryer një ndryshim në paketën fiskale konkretisht: “Në rast zëvendësimi të liçencës bazë 5 (pesë vjeçare) që ka si qëllim, ndryshimin e elementëve të përdoruesit të stacionit të pajisur me liçencën bazë, tarifa është 20,000 lekë për çdo rast zëvendësimi, për diferencën e periudhës kohore të papërfunduar”.

Me shkresën nr. 657/1 prot., datë 07.07.2022, z. N. J. Prefekt i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 105, datë 30.06.2022. Dokumentacioni shoqërues mbi të cilën është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore është dërguar nga Bashkia Korçë me shkresën me nr. 5995 prot., datë 05.07.2022, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 657 prot., datë 05.07.2022. Në relacionin pa datë dhe pa numër protokolli të hartuar nga znj. A. D, z. L. P, z. S. P dhe miratuar nga z. S. F., Kryetar i Bashkisë Korçë citohet se:

Referuar krizës ekonomike ku më e prekshme është sektori i energjisë por jo vetëm, ku rezulton me mos stabilizimin e çmimeve të hidrokarbureve ku ka sjellë dhe daljen nga tregu i tregtimit me pakicë të hidrokarbureve në konsumatorët fundorë të subjekteve që zhvillonin aktivitet në territorin e Bashkisë Korçë. Në disa raste të konstatuara në stacionet e tregëtimit me pakicë të hidrokarbureve të cilat kanë dalë nga tregu dhe këto janë zëvendësuar me subjekte të tjera duhen të pajisen me zëvendësimin e elementëve të liçencës bazë me afat 5 (pesë vjeçar) të tregëtimit me pakicë të hidrokarbureve në konsumatorët fundorë. Tarifa për këtë dublikat liçense në VKB nr. 137, datë 25.11.2021, në Kapitullin nr. III, Faqe nr. 20, paragrafi shënim është 20% e vlerës së plotë 1,000,000 lekë e cila është në vlerën 200,000 lekë vlerë kjo e cila po ta shikosh me logjikën ekonomike rëndonte situatën e operatorëve ekonomikë pasi duhet të paguhej e njëjta vlerë si në rastin kur zëvendësimi mund të bëhej në vitin e parë apo të dytë të liçencës ashtu dhe në vitin apo muajt e fundit të vlefshmërisë së saj.

Për këtë arsye propozojmë ndryshimin e kësaj tarife në rastin e zëvendësimit të liçencës. Në rast të zëvendësimit të liçencës. Në rast zëvendësimi të liçencës bazë 5 (pesë vjeçare) që ka si qëllim, ndryshimin e elementëve të përdoruesit të stacionit të pajisur me liçencën bazë, tarifa është 20,000 lekë për çdo rast zëvendësimi, për diferencën e periudhës kohore të papërfunduar.

Ndryshimi i elementëve të përdoruesit të stacionit përfshin rastet si më poshtë:

- Ndryshimin e emrit të subjektit Shpk.
- Ndryshimin e numrit unik të identifikimit të subjektit regjistruar në QKB.

Nga auditimi i paketës fiskale të miratuar me Vendimin nr. 137, datë 25.11.2021, të Këshillit Bashkiak Korçë me objekt “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2022”,

Kapitulli III “Liçenca, dhënie e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nën produkteve të saj”, në faqen 20, citohet se: Bazuar në Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar me Ligjin nr. 9218, datë 08.04.2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 129, datë 18.03.1999, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar me Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 170, datë 25.04.2022 & nr. 563, datë 27.08.2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime për tregtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre”, nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, Bashkia Korçë jep liçencë për personat juridikë të cilët ushtrojnë veprimtaritë e tyre për tregtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë Korçë. Autorizimet jepen nga Bashkia Korçë për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet me të drejtë përsëritje dhe pagesa për dhënie autorizimi për dy kategoritë e mësipërme është si më poshtë:

-Pagesë për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjete dhe Vajra lubrifikantë në vlerën 1,000,000 lekë;

-Pagesë për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorimin e konsumatorëve fundorë në vlerën 1,000,000 lekë; Për dublikatë për të njëjtën stacion dhe afat vlefshmërie apo rastet e ndryshimeve në liçencë që kanë të bëjnë me elementët e përdoruesit të stacionit paguhet 20% e vlerës së plotë.

Nga auditimi i praktikës të sipërpërmendur konstatohet se, nga Prefekti i Qarkut Korçë është **dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore të VKB-në nr. 105, datë 30.06.2022, i pa bazuar në ligj**, konkretisht:

-Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, gërma “b”, neni 35, pika 5, gërma “ç”, neni 54, gërma “f”, ku përcaktohet që:

Neni 9. Të drejtat dhe përgjegjësitë.

b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

Neni 35. Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore.

5. Bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore për:

ç) çdo tarifë të përkohëshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara me ligj;

Neni 54. Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak.

Këshilli Bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

f) vendos për taksa e tarifa vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacioni tjetër në fuqi;

-Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 35, pikat 1-2, përcaktohet që:

1. Çdo pagesë tjetër në buxhetin e bashkisë, të komunës ose të qarkut klasifikohet si tarifë kur:

a) përkon me përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”;

b) nuk është taksë bashkiake ose komunale, si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligji.

2. Tarifatat vendosen dhe administrohen në përputhje me Ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifatat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcaktojnë nëse tarifatat do të mbledhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent.

Në rastin e agjentit, këshilli vendos rregullat bazë kufizuese në raport me agjentin, ndërsa kryetari i bashkisë ose i komunës bën përzgjedhjen e agjentit, si dhe lidh kontratë me të.

-Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 5, gërma “d”, ku përcaktohet që:

Në menaxhimin e financave vendore, njësitë e vetëqeverisjes vendore ndjekin parimet e përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe në këto parime:

d) Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk mund të ulin nivelin e taksave apo të tarifave vendore në buxhetin e vitit të fundit të mandatit të tyre, me përjashtim të rasteve kur ekziston një plan i detajuar ndër vite, i cili është miratuar nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

-VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, pika 10, ku përcaktohet që:

10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 1,000,000 (një milion) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 200,000 (dyqind mijë) lekë, për bashkitë e tjera.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të sipërpërmendura, Bashkia Korçë ka kryer një ndryshim në paketën fiskale të miratuar me VKB nr. 105, datë 30.06.2022, duke aplikuar një tarifë nga 200,000 lekë në 20,000 lekë në rastet e zëvendësimit të licencës bazë 5 (pesë vjeçare) për diferencën e periudhës kohore të papërfunduar”, të pa bazuar në ligj. Për më tepër që ulja e nivelit të taksave dhe tarifave vendore është nuk mund të kryhet në vitin e fundit të mandatit të Kryetarit të Bashkisë të parashikuar në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 5, gërma “d”.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2 gërma “i”, ku përcaktohet që:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

Për sa trajtuar më sipër në mungesë të dokumentacionit të sipërpërmendur, Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë **duhej ta kthente për rishqyrtim** VKB-në nr. 105, datë 30.06.2022, pranë Këshillit Bashkiak Korçë.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. A. S, znj. S. M, z. Gj. T, z. D. K, znj. L. B, znj. O. B, znj. M. G.

2. Me Vendimin nr. 111, datë 30.06.2022, të KB Bashkiak Korçë me objekt “Miratimin hapje dritare në pronë shtet”, është miratuar hapje dritare në pronën shtet si më poshtë:

-Hapjen e dritës sipas kërkesës së qytetarit z. P. M si pronar i pasurisë nr. 1., zona kadastrale 8., për hapjen e dritës në jug-lindje të pronës së tij, në drejtim të pasurisë shtet, e sistemuar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike si lulishte midis pallateve banimi tek lagja 13, Rruga Vaskë Penavinji.

Dokumentacioni shoqërues për dhënien e bazueshmërisë ligjore është dërguar nga Bashkia Korçë me shkresën me nr. 5995 prot., datë 05.07.2022, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 657 prot., datë 05.07.2022.

Nga auditimi i praktikës të sipërpërmendur konstatohet se, VKB-ja nr. 111, datë 30.06.2022, është i pa bazuar ligjërisht, konkretisht:

-VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, neni 4/1, ku përcaktohet që:

Neni 4/1. Shërbimet e ofruara nga sistemi elektronik i lejeve:

1. Çdo subjekt, i cili kërkon të pajiset me leje apo të paraqesë deklaratë paraprake për kryerje punimesh, është i detyruar të dorëzojë aplikimin për leje apo deklaratën dhe dokumentacionin shoqërues nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

Referuar nenit 4/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, marrim informacion se: “Çdo subjekt, i cili kërkon të pajiset me leje apo të paraqesë deklaratë paraprake për kryerje punimesh, është i

detyruar të dorëzojë kërkesën aplikimin për leje apo deklaratën dhe dokumentacionin shoqërues nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve”.

Këshilli Bashkiak nuk është organi kompetent për miratimin e deklaratave paraprahe të punimeve apo lejeve të ndërtimit. Organi kompetent për miratimin e këtyre lejeve është Kryetari i Bashkisë, referuar nenit 12 dhe 13 të Ligjit nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Arsyeja e shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve është marrja e sigurisë së lartë se ndërhyrjet e kërkuara respektojnë të gjithë kriteret urbanistik, ndërtimor, të sigurisë, higjenës, etj. Nëpërmjet këtij sistemi, aplikanti ka detyrimin e marrjes së mendimit nga autoritetet e tjera të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Miratimi i lejeve të ndërtimit nga Këshilli Bashkiak nuk jep siguri se janë shqyrtuar dhe vlerësuar kriteret të ndryshme, duke veçuar ato të sigurisë, si dhe nuk është kërkuar dhe marrë mendimi nga autoritetet e tjera të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se, VKB-ja me nr. 111, datë 30.06.2022, është dërguar pranë Prefekturës së Qarkut Korçë me shkresën nr. 5995 prot., datë 05.07.2022, administruar me praktikën nr. 657/1 prot., datë 07.07.2022, **nuk është konfirmuar apo refuzuar nga Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë**, veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2, ku përcaktohet që:

2. Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën e mëposhtme:

a) çdo organ i njësisë së vetëqeverisjes vendore është i detyruar të depozitohet te prefekti i qarkut të gjitha aktet me karakter normativ, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së tyre. Marrja bëhet nga prefekti i qarkut për aktin e depozituar nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore vërtetohet me regjistrimin e tij në zyrën e protokollit të prefektit;

b) për çdo akt të regjistruar në zyrën e protokollit, prefekti i qarkut detyrohet të shprehet për ligjshmërinë e tij, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, sipas procedurave të mëposhtme:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t'ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

ii) vendimi i marrë nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga prefekti i qarkut, depozitohet pranë prefektit të qarkut me të njëjtën procedurë dhe afat sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të kësaj pike;

iii) në rast se vërehen përsëri papajtueshmëri ligjore në aktin e rishqyrtuar, prefekti i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës është organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke kërkuar deklarinimin e pavlefshëm të këtij akti. Prefekti i qarkut ka të drejtën e kthimit vetëm një herë të një akti;

iv) në rastet kur vëren shkelje ligjore në akt dhe vlerëson se kthimi i aktit nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk do të jetë i frytshëm, prefektit i lind e drejta që, pa ndjekur procedurën e përcaktuar në shkronjën “b”, nënparagrafi “i”, të kësaj pike, të kërkojë pavlefshmërinë e aktit drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës ndodhet organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kur kërkon pavlefshmërinë e aktit në gjykatë, prefekti i qarkut njofton organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë.

3. Me Vendimin nr. 120, datë 29.07.2022, të KB Korçë me objekt “Ndryshimin e kuotës ushqimore të fëmijëve të çerdheve dhe kopshteve me ushqim në qytetin e Korçës”, është miratimi i ndryshimit të kuotës ushqimore nga 125 lekë në ditë dhe kuotë mujore prej 2,750 lekë në 3,300 lekë.

Me shkresën nr. 727/2 prot., datë 04.08.2022, z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 120, datë 29.07.2022. Dokumentacioni shoqërues mbi të cilën është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore është dërguar nga Bashkia Korçë me shkresën me nr. 6669 prot., datë 01.08.2022, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 727 prot., datë 01.08.2022. Në relacionin pa datë dhe pa numër protokollit të hartuar nga znj. R. P, znj. A. D, z. Y. M dhe miratuar nga z. S. F. Kryetar i Bashkisë Korçë citohet se:

Nga përllogaritja duke u bazuar tek gramaturat e ushqimit për një fëmijë të përcaktuar në menunë javore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe tek çmimet e Institutit të Statistikave për vitin 2022 rezultoi kuota 150 lekë për fëmijë, kuota mujore 3,300 lekë. Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes e cila siguron ushqimin e fëmijëve në çerdhet dhe kopshtet me ushqim të qytetit të Korçës i kërkon Këshillit Bashkiak të qytetit të miratojë ndryshimin e kuotës ushqimore ditore nga 125 lekë në 150 lekë. Si rrjedhojë të kuotës mujore nga 2,750 lekë në 3,300 lekë. Bëjmë me dije se kuota ushqimore paguhet nga vetë prindërit e fëmijëve. Ndryshimi i kuotës vjen si rezultat i rritjes së çmimeve të mallrave ushqimore që përdoren tek menutë javore të fëmijëve nga 0 deri në 6 vjeç të krahasuara me çmimet e mallrave ushqimore sipas kontratës ekzistuese 2021-2022.

Nga auditimi i praktikës të sipërpërmendur konstatohet se, nga Prefekti i Qarkut Korçë **është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore të VKB-në nr. 120, datë 29.07.2022, i pa bazuar në ligj**, konkretisht:

-Urdhri nr. 457, datë 13.06.2018, “Për një ndryshim të Urdhrit nr. 76/1, datë 24.01.2018, “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, pikat 1-3, ku përcaktohet që:

1. Ndryshimin e përmbajtjes së Shtojcës 3, të Pikës 7 “Menu 5-ditore, për fëmijët 1-3 vjeç në çerdhe”, sipas shtojcës 3 “Menu 5 ditore për fëmijët 1-3 vjeç (Dimër verë)”, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ndryshimin e përmbajtjes së Shtojcës 4, të pikës 8 “Menu 5-ditore, për fëmijët 3-6 vjeç në kopshte, sipas shtojcës 4 “Menu 5 ditore për fëmijët 3-6 vjeç (Dimër verë)”, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Ndryshimin e pikës 10, me këtë përmbajtje, “Për miratimin e disa ndryshimeve të menuve 5-ditore, të fëmijëve 1-3 vjeç dhe 3-6 vjeç në çerdhe dhe kopshte, të njoftohen strukturat përkatëse të Shëndetit Publik në të gjithë vendin, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë, Bashkitë në të gjithë vendin, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Inspektorati Qendror dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”.

Duke u bazuar në vendimin e sipërpërmendur Bashkia Korçë, ndryshimin e kuotës ushqimore e ka aplikuar për fëmijët të çerdheve dhe kopshteve për grup moshën nga **0 deri në 6 vjeç**, ndërkohë referuar Urdhrit nr. 76/1, datë 24.01.2018, “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, pikat 1-3, ky ndryshim kap grup moshën nga **1 deri në 6 vjeç**.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2 gërma “i”, ku përcaktohet që:

- i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

Për sa trajtuar më sipër në mungesë të dokumentacionit të sipërpërmendur, Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë **duhej ta kthente për rishqyrtim VKB-në nr. 120, datë 29.07.2022, pranë Këshillit Bashkiak Korçë**.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. S. M, znj. M. Z, z. Gj. T, z. D. K, znj. L. B, znj. O. B.

4. Me Vendimin nr. 122, datë 29.07.2022, të KB Bashkiak Korçë me objekt “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij në Bashkinë Korçë”, janë miratuar kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor si më poshtë:

-KVR-ja përbëhet nga 10 (dhjetë) anëtarë, nga të cilët të paktën 5 (pesë) janë vajza. Anëtarët e KVR-së janë si më poshtë vijon:

- Kryetar i Bashkisë;
- 4 (katër) përfaqësues nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë;
- 5 (pesë) përfaqësues anëtarë të këshillave studentorë/qeveritë e nxënësve;

-Sekretari i KVR-së përbëhet nga dy anëtarë: 1 (një) personi përgjegjës për sektorin e rinisë pranë bashkisë dhe 1 (një) përzgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit (organizatat/këshillat studentorë/qeveritë e nxënëse).

Me shkresën nr. 727/2 prot., datë 04.08.2022, z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 122, datë 29.07.2022. Dokumentacioni shoqërues mbi të cilën është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore është dërguar nga Bashkia Korçë me shkresën me nr. 6669 prot., datë 01.08.2022, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 727 prot., datë 01.08.2022.

Nga auditimi i praktikës të sipërpërmendur konstatohet se, nga Prefekti i Qarkut Korçë **është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore të VKB-në nr. 122, datë 29.07.2022, i pa bazuar në ligj**, konkretisht:

-Ligji nr. 75/2019, datë 04.11.2019, “Për rininë”, neni 10, ku përcaktohet që:

Neni 10. Këshilli vendor i rinisë

1. Këshilli vendor i rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Këshilli vendor i rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;

b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;

c) propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;

c) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.

2. Këshilli vendor i rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.

3. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të këshillit vendor të rinisë miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke iu referuar, për aq sa është e mundur, kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.

Duke u bazuar në vendimin e sipërpërmendur Bashkia Korçë ka përcaktuar kritere për përzgjedhjen e 10 (dhjetë) anëtarëve të Komisionit Vendor Rinor, ndërkohë që referuar dispozitës ligjore të sipërpërmendur përbërja e këtij komisioni duhet të ishte maksimalisht me 6 (gjashtë) anëtarë.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2 gërma “i”, ku përcaktohet që:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

Për sa trajtuar më sipër në mungesë të dokumentacionit të sipërpërmendur, Prefekti i Qarkut Korçë **duhej ta kthente për rishqyrtim** VKB-në nr. 122, datë 29.07.2022, pranë Këshillit Bashkiak Korçë.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. S. M, znj. M. Z, z. Gj. T, z. D. K, znj. L. B, znj. O. B.

5. Me Vendimin nr. 124, datë 29.07.2022, të KB Korçë me objekt “Për miratimin e propozimit të privatizimit të drejtëpërdrejtë të pasurisë nr. 2. ZK 2., dhënë me qira subjektit “K. G.” Sh.a”, është miratuar propozimi për privatizimin e pasurisë nr. 2. vol. 1., fq. 8. zk 2. me sipërfaqe 2,500 m² me vendodhje në Mbrojë, Drenovë Korçë. Me shkresën nr. 727/2 prot., datë 04.08.2022, z. N. J. Prefekt i Qarkut Korçë e ka kthyer **Vendimin nr. 124, datë 29.07.2022, të Këshillit Bashkiak Korçë si akt me karakter jo normativ**. Dokumentacioni shoqërues mbi të cilën është trajtuar si akt me karakter normativ është dërguar pranë Bashkisë Korçë me shkresën nr. 6669 prot., datë 01.08.2022, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 727 prot., datë 01.08.2022.

-Projektvendimi pa datë dhe pa numër protokolli me objekt “Për miratimin e propozimit të privatizimit të drejtëpërdrejtë të pasurisë nr. 2. ZK 2., dhënë me qira subjektit “K. G.” Sh.a”;

-Relacioni pa datë dhe pa numër protokolli me objekt “Për miratimin e propozimit të privatizimit të drejtëpërdrejtë të pasurisë nr. 2. ZK 2., dhënë me qira subjektit “K. G.”, i nënshkruar nga znj. A. D, znj. V. Z dhe miratuar nga z. S. F. Kryetar i Bashkisë Korçë;

-Kontrata e qirasë e datës 30.04.2014, lidhur ndërmjet z. F. S Kryetar i Komunës Drenovë dhe z. D. D përfaqësues ligjor i Shoqërisë Anonime “K. G.” Sh.a, me afat 10 vjeçar, me pagesë vjetore prej 25,000 lekë në vit për sipërfaqen 2,500 m².

-Çerifikata e pronësisë me numër serial 8., me datë lëshimi 07.04.2014, nga Zyra e Regjistrimit Korçë, me numër pasurie 2., zona kadastrale nr. 2., volumni 1., faqe 8., me adresë Mbrojë Korçë, me **lloj pasurie Shkëmb** me sipërfaqe totale 2,500 m² në pronësi të Komunës Drenovë.

-Harta e treguesve të regjistrimit;

-Kërkesa e subjektit për privatizimin e pasurisë administruar pranë Bashkisë Korçë praktikën me nr. 1529 prot., datë 22.02.2021;

-Shkresa me nr. 8131 prot., datë 30.09.2021, e z. S. F Kryetar i Bashkisë Korçë në lidhje me nxjerrjen e njoftimit për shpalljen për përzgjedhjen e ekspertëve vlerësues dhe kontabël që do të kryejnë vlerësimin e investimit të Shoqërisë “K. G.” Sh.a;

-Kërkesa e datës 07.10.2021, e znj. A. Ç Audituese Ligjore e liçesuar me liçencën me nr. 1., datë 15.10.2008, me Nipt K..., administruar pranë Bashkisë Korçë me praktikën nr. 8. prot., datë 07.10.2021;

-Urdhri nr. 589, datë 15.06.2022, i z. S. F Kryetar i Bashkisë Korçë me objekt “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e investimeve të kryera nga Shoqëria “K. G.” Sh.a” sipas kontratës së qirasë datë 30.04.2014”;

-Akti i vlerësimit i administruar në Bashkinë Korçë me praktikën nr. 5743 prot., datë 27.06.2022;

-Informacioni në lidhje me zhvillimin e procedurës së vlerësimit me shkresën nr. 6235 prot., datë 13.07.2022, miratuar nga z. S. F. Kryetar i Bashkisë Korçë;

Me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Kreu VIII, pika 4, citohet që:

Në kontratat e qirasë ose të enfiteozës, të lidhura për pasuri ku sipërfaqja e truallit është mbi 500 m², në rastet kur shoqëria qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse ka kryer investime në përputhje me planin e biznesit dhe me masën mbi 150 për qind të vlerës së truallit, si dhe kur shoqëria ka respektuar kushtet e kontratës, subjekteve kontraktuese, që kanë konsumuar mbi 5 vjet të kontratës, u lind e drejta e privatizimit të drejtëpërdrejtë të objektit të kontratës, sipas legjislacionit në fuqi.

Titullari i institucionit, që ka lidhur kontratën e qirasë enfiteozë, urdhëron ngritjen e grupit të vlerësimit e investimeve të kryera, të përbërë nga një ekspert vlerësues i liçencuar dhe nga një ekspert kontabël i autorizuar, të cilët hartojnë raportin për vlerësimin e investimeve të kryera nga shoqëria qiramarrëse për periudhën nga lidhja e kontratës deri në bilancin e vitit të fundit ushtrimor.

Me marrjen e raportit të ekspertëve, drejtoria përgjegjëse për monitorimin e kontratave të qirasë ose të enfiteozës bën krahasimin e vlerës së truallit të përcaktuar sipas çmimit të përcaktuar sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi me vlerën e investimeve të kryera në objekt, sipas raportit të ekspertëve dhe i'a paraqet ministrit. Kur vlera e investimeve është mbi 150 për qind e vlerës së truallit, ministri miraton fillimin e procedurave për privatizimin e drejtëpërdrejtë të objektit.

Në rastet kur për pasuritë, objekt i kontratës së qirasë, të drejtën e ushtrimit të përfaqësuesit të pronës shtetërore e ushtron pushteti vendore, atëherë ky organ i pushtetit vendor që ka lidhur kontratën, kryhen procesin e vlerësimit të investimeve deri në konkluzionin se vlera e investimeve të kryera nga sipërmarrësi është mbi 150 për qind e vlerës së truallit, sipas procedurave të mësipërme dhe më pas i'a përcjell ministrisë përgjegjëse për ekonominë me propozimin për privatizim të drejtëpërdrejtë të asaj pasurie.

Me Urdhrin nr. 589, datë 15.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë Korçë është ngritur grupi i punës për vlerësimin e investimeve të kryera nga Shoqëria “K. G.” Sh.a në objektin e dhënë me qira nga ish-Komuna Drenovë sipas kontratës së qirasë me nr. Rep., nr. 275 Kol., të përbërë nga znj. A. Ç Eksperte Kontabël i miratuar dhe M. S. E. Vlerësues i liçencuar. Më datë 27.06.2022, ka dal raportin i vlerësimit dorëzuar pranë Bashkisë Korçë.

Sipas raportit të vlerësimit vlera e investimit në pasuri të paluajtshme e cila përfshin murin rrethues, shtrim pllaka betoni, shtrim pusi është në vlerën 2,304,920 lekë.

Vlera e investimit në pasuri të paluajtshme (Çisterna) është 11,149,401 lekë, ku totali i investimeve shkon në vlerën 13,454,321 lekë.

Në zbatim të Urdhrit nr. 718, datë 19.07.2022, të z. S. F. Kryetar i Bashkisë është ngritur grupi i punës për krahasimin e vlerës së investimeve me **vlerën e truallit** dhënë me qira Shoqërisë “K. G.” Sh.a. Vlera e pasurisë së dhënë me qira u krye nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit Bashkia Korçë referuar hartës së vlerës së tokës (VKM nr. 89, datë 03.02.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”). Kjo vlerë në zonën kadastrale 2631 (Mbrojë) është 1,970 lekë/m² (2,500 * 1,970 = 4,925,000 lekë). Grupi i punës ka konstatuar se vlera e investimeve prej 13,454,321 lekë është më e madhe se 150% e vlerës së pasurisë së dhënë me qira (150% * 4,925,000 = 7,387,500 lekë).

Kontrata e sipërpërmendur është nënshkruar më datë 30.04.2014, si rrjedhojë kanë kaluar më shumë se 5 vjetë nga nënshkrimi i saj.

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, gërma “e”, parashikohet që i kërkohet Këshillit të miratojë propozimin për privatizimin i cili do t'i komunikohet Ministrit përkatës. Ministria e Financave është institucioni i cili miraton privatizimin e drejtpërdrejtë të pasurisë pronë shtetërore.

Për sa trajtuar më sipër konstatohet që, miratimi për propozimin e privatizimit të drejtpërdrejtë të pasurisë së sipërpërmendur i përket zërit kadastral truall ndërsa pasuria për të cilën ka nisur procesi i përket zërit kadastral shkëmb (referuar çertifikatës së pronësisë të sipërpërmendur), veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Kreu VIII, pika 4 dhe 5, ku përcaktohet që:

Pika 4. Për truallin dhënë në përdorim të tretëve në bazë të një kontrate qiraje ose enfiteozë, por të njohur dhe kthyer pronarit në zbatim të Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar, kur ndërtesa në pronësi të pronarit shtet nuk përdoret për interes publik, shteti detyrohet t'i paguajë subjektit të shpronësuar qiranë e truallit të përfshirë në kontratën e qirasë apo enfiteozës, për të cilën ai është njohur pronar, sipas vlerës të përcaktuar në kontratën e lidhur. Vlera e qirasë së truallit që i kalon pronarit do të jetë shuma e vlerës së qirasë së truallit të lirë funksional, me vlerën e qirasë së truallit nën ndërtesë. Qiraja për m² e truallit funksional do të jetë sipas tarifës së aplikuar në kontratë. Qiraja për m² e truallit nën ndërtesë, e cila në kontratë përfshihet në tarifën e qirasë së ndërtesës, do të llogaritet 20 për qind e tarifës së qirasë për ndërtesën të përcaktuar në kontratë. Kërkesa depozitohet pranë organit që ka në administrim pronën shtetërore të dhënë me qira ose enfiteozë, i cili bën konfirmimin e sipërfaqes së kthyer sipas vendimit të Agjencisë së Kthimit të Pronave dhe sipërfaqes përkatëse të dhënë me qira ose enfiteozë, nëpërmjet mbivendosjes së tyre. Me plotësimin e kësaj procedure, ky organ e dërgon praktikën tek organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose enfiteozës, për lidhjen e marrëveshjes me pronarët për dhënien e qirasë së truallit. Kjo procedurë nuk zbatohet, kur prona është pjesë e kapitalit të shoqërive tregtare shtetërore. Vlera e qirasë së truallit, i kalon pronarit, sipas procedurave të mësipërme, kur investimi i kryer nga subjekti që ka marrë me qira apo enfiteozë, është nën 150 për qind të vlerës së truallit, me kërkesë të pronarit të shpronësuar të tij.

Pika 5. Në kontratat e qirasë ose enfiteozës të lidhura për pasuri ku sipërfaqja e truallit është mbi 500 m², në rastet kur shoqëria qiramarrëse ose enfiteozë marrëse, ka kryer investime në përputhje me plan biznesin dhe në masën mbi 150 për qind të vlerës së truallit, si dhe kur shoqëria ka respektuar kushtet e kontratës, subjekteve kontraktuese që kanë konsumuar mbi 5 vjet të kontratës, i lind e drejta e privatizimit të drejtpërdrejtë të objektit të kontratës, sipas legjislacionit në fuqi. Titullari i institucionit që ka lidhur kontratën e qirasë ose enfiteozës, urdhëron ngritjen e grupit për vlerësimin e investimeve të kryera, të përbërë nga një ekspert vlerësues i licencuar dhe një ekspert kontabël i autorizuar, të cilët hartojnë raportin për vlerësimin e investimeve të kryera nga shoqëria qiramarrëse ose enfiteozmarrëse për periudhën nga lidhja e kontratës deri në bilancin e vitit të fundit ushtrimor të miratuar. Në rastet kur, objekti, para lidhjes së kontratës së qirasë ose enfiteozës, është përdorur me qira nga i njëjti subjekt, me të njëjtin qëllim, por me kontrata me afat më të vogël, ekspertët vlerësues të investimeve, në hartimin e raportit përkatës përfshijnë edhe investimet e kryera nga ky subjekt gjatë asaj periudhe. Me marrjen e raportit të ekspertëve drejtoria përgjegjëse për monitorimin e kontratave të qirasë ose enfiteozës, bën krahasimin e vlerës së truallit të përcaktuar sipas çmimit të përcaktuar në vendimin Nr.187, datë 06.3.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Shqipërisë”, me vlerën e investimeve të kryera në objekt, sipas raportit të ekspertëve dhe i paraqet tek Ministri. Kur vlera e investimeve është mbi 150 për qind e vlerës së truallit, ministri miraton fillimin e procedurave për privatizim të drejtpërdrejtë të objektit. Në rastet kur për pasurinë, objekt i kontratës së qirasë, të drejtën e ushtrimit të përfaqësuesit të pronës shtetërore e ushtron pushteti vendor, procesin e vlerësimit të investimeve deri në konkluzionin se vlera e investimeve të kryera nga

sipërmarrësi është mbi 150 për qind e vlerës së truallit, sipas procedurave të mësipërme, e kryen organi i pushtetit vendor që ka lidhur kontratën dhe e përcjell në Ministrinë përgjegjëse për ekonominë me propozimin për privatizim të drejtpërdrejtë të asaj pasurie. Pagesa e ekspertëve që hartojnë raportin e vlerësimit të investimeve të kryera nga qiramarrësit, do të jetë 100.000 (njëqind mijë) lekë për çdo ekspert dhe për çdo rast, urdhërohet nga titullari i institucionit urdhërues të misionit të vlerësimit të investimeve.

➤ **Bashkia Devoll**

6. Me Vendimin nr. 44, datë 30.05.2022, KB Devoll miraton dhënien e pëlqimit për dhënien me qera të fondit pyjor të sipërfaqes në pronësi të Bashkisë Devoll, subjektit A. A. (M. H. Q.) shpk për veprën e marrjes së ujit H. Q..

Prefekti i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të tyre me shkresën nr. 569/2 prot., datë 13.06.2022.

Nga auditmi i dosjes së mësipërme konstatohet se:

Praktika bashkëngjitur vendimit nuk është e plotë për arsye se mungon procesverbali i mbledhjes së këshillit, *veprim ky në kundërshtim me Urdhërin nr. 175 të Ministrit të Brendshëm, datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme Për organizmin dhe funksionimin e institucionit të Prefektit të Qarkut si dhe Aneksin 1 “Rregulla për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu 2, pika b, gërma 1 ku shprehet se : Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentat e mëposhtëm: 1. Procesverbali i mbledhjes së këshillit. si dhe gërma C ku shprehet se: Nëse akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm (i mësipërm), prefekti i qarkut ia kthen menjëherë aktin NJVQV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.*

Si për rrjedhojë haset kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2, gërma “i” ku përcaktohet që: *“Në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin.*

Si përfundim Prefekti i Qarkut Korçë duhej ta kthente vendimin e mësipërm të Këshilit Bashkiak për rishqyrtim.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. O. B, z. D. K, znj. S. M, z. Gj. T, z. L. B, znj. A. S.

7. Me Vendimin nr. 45, datë 30.05.2022, KB Devoll miraton dhënien me qira të fondit pyjor të sipërfaqes në pronësi të Bashkisë Devoll, subjektit “A.” Shpk për instalimin e shtyllës matëse Aneometër për identifikimin e intensitetit të erës.

Prefekti i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të tyre me shkresën nr. 569/2 prot., datë 13.06.2022.

Nga auditmi i dosjes së mësipërme konstatohet se:

Praktika bashkëngjitur vendimit nuk është e plotë për arsye se mungon procesverbali i mbledhjes së këshillit bashkiak, *veprim ky në kundërshtim me Urdhërin nr. 175 të Ministrit të Brendshëm, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme Për organizmin dhe funksionimin e institucionit të Prefektit të Qarkut si dhe Aneksin 1 “Rregulla për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu 2, pika b, gërma 1 ku shprehet se : Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentat e mëposhtëm: 1. Procesverbali i mbledhjes së këshillit. si dhe gërma C ku shprehet se: Nëse akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm (i mësipërm), prefekti i qarkut ia kthen menjëherë aktin NJVQV,*

duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

Si për rrjedhojë haset kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2, gërma “i” ku përcaktohet që: *“Në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin.*

Si përfundim Prefekti i Qarkut Korçë duhej ta kthente vendimin e mësipërm të Këshilit Bashkiak për rishqyrtim.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. O. B, z. D. K, znj. S. M, z. Gj. T, znj. L. B, znj. A. S.

8. Me Vendim nr. 84, datë 20.12.2022, KB Devoll ka vendosur ti akordojë familjes së z. J. D ndihmën emergjente në vlerën prej 753,948 lekë për dëmtimin e banesës nga rënia e zjarrit. Me shkresën nr. 1140/1 prot., datë 05.01.2023, Prefekti i Qarkut ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të vendimit.

Bashkangjitur aktit normativ ndodhet dhe gjithë praktika e ndjekur për ekzekutimin e këtij vendimi. Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimi i Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative, Bashkia Devoll ka hartuar relacionin ku shpjegohet procedura e vlerësimit të dëmit konform Ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen civile” si dhe VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”. Nga Komisioni i Vlerësimit të Emergjencave Civile janë hartuar preventivet për dëmet e anës ndërtimore dhe për dëmet në orendi dhe paisje.

Më datë 04.11.2022, ka dalë dhe raporti nga Sektori i MZSH-së ku vërtetohet se në objektin banesë në pronësi të z. J. D ka rënë zjarr dhe si pasojë e tij janë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale. Praktika është gjithashtu e shoqëruar dhe me foto për të vërtetuar dëmet e shkaktuara nga zjarri. Nga auditimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:

-Mungon çertifikata familjare e personit në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, kapitulli III, pika 2, gërma ç.

-Nga Prefektura e Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore në mungesë të dokumentacionit sipas VKM-së së mësipërme.

Ky vendim gjen kundërshtim dhe me Urdhërin nr. 175, datë 09.07.2020, të Ministrisë të Brendshme “Për miratimin e rregullores së brendshme Për organizmin dhe funksionimin e institucionit të Prefektit të Qarkut si dhe Aneksin 1 “Rregulla për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu 2, pika b, gërma VII ku shprehet se: **Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimarrjes për emergjencat civile)** si dhe gërma “c” ku shprehet se: **Nëse akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm (i mësipërm), prefekti i qarkut ia kthen menjëherë aktin NJVQV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.**

Haset kundërshtim me Ligjin nr.107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2, gërma “i” ku përcaktohet që: *“Në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin,* ku si

përfundim Prefekti i Qarkut Korçë duhej ta kthente vendimin e mësipërm të Këshillit Bashkiak për rishqyrtim.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. O. B, z. D. K, znj. S. M, z. Gj. T, z. D. K, znj. L. B, znj. A. S.

➤ **Bashkia Maliq**

9. Me Vendimin nr. 39, datë 29.04.2022, KB Maliq ka vendosur të miratojë ndihmën financiare për familjen e z. F. Ll në vlerën 412,000 lekë për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e tij.

Me shkresën nr. 460/2 prot., datë 11.05.2022, Prefekti i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të vendimit. Drejtorja e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka hartuar relacionin ku shpjegohet procedura e vlerësimit të dëmit konform Ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen civile” si dhe VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”. Nga Drejtorja e MZSH-së ka dalë vërtetimi nr. 2904 prot., që konfirmon se më datë 24.03.2022, në objektin godinë banimi në pronësi të z. F. Ll ka rënë zjarr.

Nga auditimi i praktikës së mësipërme konstatohet se:

Mungon certifikata familjare e personit në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, kapitulli III, pika 2, gërma ç.

Nga Prefektura e Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore në mungesë të dokumentacionit sipas VKM-së së mësipërme.

Ky vendim gjen kundërshtim dhe me Urdhërin nr. 175 të Ministrit të Brendshëm, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme Për organizmin dhe funksionimin e institucionit të Prefektit të Qarkut si dhe Aneksin I “Rregulla për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu 2, pika b, gërma Vii ku shprehet se : **Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimarrjes për emergjencat civile). si dhe gërma C ku shprehet se: Nëse akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm (i mësipërm), prefekti i qarkut ia kthen menjëherë aktin NJVQV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.**

Haset kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2, gërma “i”, ku përcaktohet që: “**Në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura.** Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin, ku si përfundim Prefekti i Qarkut Korçë duhej ta kthente vendimin e mësipërm të Këshillit Bashkiak për rishqyrtim.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. O. B, z. D. K, znj. S. M, z. Gj. T, znj. L. B, znj. A. S.

Nga auditimi me zgjedhje mbi bazueshmërinë ligjore të dhënë nga Prefekti i Qarkut Korçë të akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore për vitin 2023, konstatohet që:

➤ **Bashkia Korçë:**

1. Me Vendimin nr. 17, datë 25.01.2023, të KB Korçë me objekt “Për fillimin e procedurave të dhënies me qira, të ambientit me sipërfaqe 98m² të ndodhur në Pallatin e Sportit “Tamara Nikolla” pjesë e pasurisë nr. 1. ZK 8., sipas Gen Planit bashkëngjitur”, Bashkia Korçë ka miratuar nisjen e procedurës për dhënien me qira të ambientit me sipërfaqe 98 m² pjesë e Pallatit të Sportit “Tamara Nikolla”.

Me shkresën nr. 104/1 prot., datë 03.02.2023, z. N. J., Prefekti i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 17, datë 25.01.2023. Dokumentacioni shoqërues mbi të cilën është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore është dërguar nga Bashkia Korçë me shkresën me nr. 681 prot., datë 27.01.2023, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 104 prot., datë 30.01.2023.

Në pikat 1-2, të vendimit të sipërpërmendur citohet se: “1. Miratimin e dhënies me qira, të sipërfaqes prej 98 m², pjesë e pasurisë nr. 1. ZK 8., me vendodhje në Pallatin e Sportit Tamara Nikolla Korçë, sipas planimetrisë ngjitur. 2. Miratimin e dhënies me qira të objektit të sipërcituar me një vlerë jo më të vogël se 510.2/lekë/m² dhe me afat 10 (dhjetë) vjet”.

Nga auditimi i praktikës të sipërpërmendur konstatohet se, nga Prefekti i Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore të VKB-në nr. 17, datë 25.01.2023, i pa bazuar në ligj, konkretisht:

-VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, neni 6, ku përcaktohet që:

6. Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira, e kanë:

a) Institucioni shtetëror, ndërmarrja ose shoqëria shtetërore, jep me qira, për një afat deri në 1 (një) vit objekte që ka në administrim me sipërfaqe deri në 200 m² (ku të jetë përfshirë dhe sipërfaqja funksionale); objektet voluminoze, si depozita, silose etj. me vëllim deri në 300 m³, makineri, pajisje, linja teknologjike, të shkëputura, që janë të instaluar brenda këtyre sipërfaqeve. Ndërmarrjet, shoqëritë apo institucionet shtetërore nuk mund të japin me qira vetëm “truall të lirë” me sipërfaqe deri në 200 m.

b) Organi që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore, jep me qira deri në 20 vjet, sipërfaqe mbi 200 m², si dhe linjat teknologjike apo objektet voluminoze si depozita e silose me volum mbi 300 m³, që janë të instaluar brenda këtyre sipërfaqeve. Afati i lidhjes së kontratës për sipërfaqet 200-500 m² është deri në 10 (dhjetë) vjet, ndërsa për sipërfaqet mbi 500 m² është deri në 20 vjet.

Referuar dispozitës ligjore të sipërpërmendur Prefekti i Qarkut Korçë **duhej ta kthente për rishqyrtim** VKB-në nr. 17, datë 25.01.2023, pranë Këshillit Bashkiak Korçë, për arsye se sipërfaqja e ndërtesave deri në 200 m² jepet me afat kontrate qiraje deri në 1 vit dhe jo 10 vite.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Prefekturës së Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. S. M, znj. A. S, znj. M. Z, znj. F. R, z. Gj. T, z. P. P, z. L. M, z. D. K, znj. L. B, z. Z. B, znj. O. B.

2. Me Vendimin nr. 116, datë 31.08.2023, të KB Korçë me objekt “Mbi miratimin e ndihmës financiare zonjës Z. I, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e saj”, është aprovuar fondi në vlerën 412,795 lekë. Me shkresën nr. 747/1 prot., datë 01.09.2023, z. N. J Prefekt i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 116, datë 31.08.2023. Dokumentacioni shoqërues mbi të cilën është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore është dërguar nga Bashkia Korçë me shkresën me nr. 6628 prot., datë 31.08.2023, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 747 prot., datë 31.08.2023, ku pjesë përbërëse janë shkresat si më poshtë:

-Projektvendimi nr. 116, datë 31.08.2023, me objekt “Mbi miratimin e ndihmës financiare zonjës Z. I, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e saj”;

-Me shkresën nr. 4 prot., datë 20.07.2023, nga Drejtoria e MZSH-së Korçë është lëshuar vërtetimi “Për rënie zjarri” në banesën e znj. Z. I, nënshkruar nga z. K. C Drejtor i MZSH-së;

-Preventivi i datës 24.07.2023, i hartuar nga Komisioni i Ekspertëve i përbërë nga z. Gj. K, z. F. M dhe znj. O. B për dëmet e shkaktuara në orendi dhe pajisje në vlerën 143,200 lekë miratuar nga Këshilli Bashkiak Korçë;

-Preventivi i datës 24.07.2023, i hartuar nga z. F. M, znj. O. B dhe z. Gj. K për dëmet e shkaktuara në banesë në vlerën 539,191.7 lekë (539,191.7 lekë / 50% = 269,595.85 lekë);

-Shkresa me nr. 452/1 prot., datë 25.07.2023, ku znj. A. E Kryetar i Këshillit të Qarkut Korçë ka dërguar praktikën e sipërpërmendur pranë Bashkisë Korçë;

-Relacioni pa datë dhe pa numër protokolli, me objekt “Mbi miratimin e ndihmës financiare zonjës Z. I, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e saj”, i hartuar nga z. A. Q Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile, znj. V. Z, Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrolli, znj. A. Q, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe miratuar nga z. S. F, Kryetar i Bashkisë Korçë;

Nga auditimi i praktikës të sipërpërmendur konstatohet se, nga Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 116, datë 31.08.2023, në mungesë të dokumentacionit si më poshtë:

1. Procesverbalin e mbledhjes së këshillit;

2. Nuk disponohet kërkesa për ndihma financiare pranë Bashkisë Korçë nga znj. Z. I;

3. Nuk disponohet urdhri për ngritjen e grupit të punës nga Kryetari i Bashkisë Korçë për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore, i cili brenda pesë ditëve duhet të hartonte procesverbalin e konstatimit të dëmeve;

4. Nuk disponohet procesverbali i konstatimeve të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit;

5. Nuk disponohet çertifikata familjare e znj. Z. I në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë;

Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kapitulli III, pika 1, gërma “a”, “b”, “c”, pika 2, gërma “a” dhe “ç”, ku përcaktohet që:

III. Procedura në rastet kur nuk shpallet gjendja e emergjencës civile

Në rastin kur nuk është shpallur gjendja e emergjencës civile, fatkeqësisë natyrore, ndiqen këto procedura:

1. Procedurat e vlerësimit të dëmeve

a) Familjet që kanë pësuar dëme, shkaktuar nga fatkeqësi të ndryshme natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, paraqesin kërkesën e tyre për ndihmë financiare pranë organit të qeverisjes vendore përkatëse.

b) Drejtuesi i organit të qeverisjes vendore verifikon vërtetësinë e fakteve të paraqitura në kërkesë, nëpërmjet komisionit të ngritur me urdhër të tij, i cili mban dhe procesverbalin e konstatimit të gjendjes për dëmet e shkaktuara.

c) Afati kohor nga ngritja e komisionit deri në përfundimin e hartimit të procesverbalit është 5 (pesë) ditë.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare:

a) Procesverbali i konstatimit të gjendjes;

c) Certifikata familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë;

-Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, neni 15, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave harton “Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 12-13, dhe neni 18, ku përcaktohet që:

Neni 12. Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemën e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilogruar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë.

Neni 13. Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhrat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”.

Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.

Neni 18. Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen. Procesverbalet e mbledhjeve të forumit të organit shtetëror shtypen veças për çdo çështje dhe nënshkruhen nga mbajtësi dhe titullari ose zëvendësi i tij (përfshirë bënë procesverbalet e mbledhjes së këshillit të bashkisë, të qarkut e të komunës, që firmosen nga kryetari, sekretari ose i ngarkuari me drejtimin e mbledhjes dhe së paku nga 3 këshilltarë). Kur mbledhja është e përbashkët me përfaqësues të dy a më shumë subjekteve, procesverbali nënshkruhet nga mbajtësi dhe nga titullari ose zëvendësit e secilit subjekt.

-Urdhri nr. 175, datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe Aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, neni 4, pika 1, gërma “b” dhe “c”, ku përcaktohet që:

b. Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

i. Procesverbali i mbledhjes së këshillit;

ii. Procesverbali i dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji;

iii. Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore;

iv. Projektvendimin;

v. Çertifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASH-ja (në vendimarrjen e pronave), plan vendosjet;

vi. Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimarrjes me karakter financiar);

vii. Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimarrjes për emergjencat civile) etj.

c. Në rast se, akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë (i mësipërm), prefekti i qarkut ja kthen menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit;

-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 4, ku përcaktohet që:

4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

-Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2 gërma “i”, ku përcaktohet që:

i) në rastet kur vëren papajftueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

Për sa trajtuar më sipër në mungesë të dokumentacionit të sipërpërmendur, Prefekti i Qarkut Korçë duhej ta kthente për rishqyrtim VKB-në nr. 116, datë 31.08.2023, pranë Këshillit Bashkiak Korçë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. A. S, znj. S. M, z. P. P, z. D. K, znj. L. B, z. Z. B, znj. O. B.

3. Me Vendimin nr. 143, datë 26.10.2023, të KB Korçë me objekt “Mbi miratimin e ndihmës financiare z. L. Xh, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e tij”, është aprovuar fondi në vlerën 268,996.85 lekë. Me shkresën nr. 924/1 prot., datë 31.10.2023, z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 143, datë 26.10.2023. Dokumentacioni shoqëruar mbi të cilën është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore është dërguar nga Bashkia Korçë me shkresën me nr. 8556 prot., datë 27.10.2023, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 924 prot., datë 27.10.2023, ku pjesë përbërëse janë shkresat si më poshtë:

-Me shkresën nr. 5 prot., datë 11.10.2023, nga Drejtoria e MZSH-së Korçë është lëshuar vërtetimi “Për rënie zjarri” në banesën e z. L. Xh, nënshkruar nga z. K. C Drejtor i MZSH-së;

-Preventivi pa datë i hartuar nga Komisioni i Ekspertëve i përbërë nga z. Gj. K, z. F. M dhe z. R. L për dëmet e shkaktuara në orendi dhe pajisje në vlerën 149,000 lekë miratuar nga Këshilli Bashkiak Korçë;

-Preventivi i datës 17.10.2023, i hartuar nga z. F. M, z. R. L dhe z. Gj. K për dëmet e shkaktuara në banesë në vlerën 239,993.7 lekë (239,993.7 lekë / 50% = 119,996.85 lekë);

-Shkresa me nr. 607/1 prot., datë 17.10.2023, ku z. E. N Kryetar i Këshillit të Qarkut Korçë ka dërguar praktikën e sipërpërmendur pranë Bashkisë Korçë;

-Relacioni pa datë dhe pa numër protokolli, me objekt “Për përcaktimin e ndihmës financiare për z. L. Xh, të cilit është dëmtuar banesa nga rënia e zjarrit”, i hartuar nga z. A. Q Përgjegjës i Sektorit

të Emergjencave Civile, znj. V. Z Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrolli, znj. A. Q Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe miratuar nga z. S. F Kryetar i Bashkisë Korçë;

Nga auditimi i praktikës të sipërpërmendur konstatohet se, nga Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 143, datë 26.10.2023, në mungesë të dokumentacionit si më poshtë:

1. Procesverbalin e mbledhjes së këshillit;
 2. Projekt Vendimi nuk përmban të gjithë elementët përkatës si datë, numër protokollit si dhe nënshkrimin e Kryetarit të Këshillit Bashkiak Korçë;
 3. Nuk disponohet kërkesa për ndihma financiare pranë Bashkisë Korçë nga z. L. Xh;
 4. Nuk disponohet urdhri për ngritjen e grupit të punës nga Kryetari i Bashkisë Korçë për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore, i cili brenda pesë ditëve duhet të hartonte procesverbalin e konstatimit të dëmeve;
 5. Nuk disponohet çertifikata familjare e z. L. Xh në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë;
- Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kapitulli III, pika 1, gërma “a”, “b”, “c”, pika 2, gërma “a” dhe “ç”, ku përcaktohet që:

III. Procedura në rastet kur nuk shpallet gjendja e emergjencës civile

Në rastin kur nuk është shpallur gjendja e emergjencës civile, fatkeqësisë natyrore, ndiqen këto procedura:

1. Procedurat e vlerësimit të dëmeve

a) Familjet që kanë pësuar dëme, shkaktuar nga fatkeqësi të ndryshme natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, paraqesin kërkesën e tyre për ndihmë financiare pranë organit të qeverisjes vendore përkatëse.

b) Drejtuesi i organit të qeverisjes vendore verifikon vërtetësinë e fakteve të paraqitura në kërkesë, nëpërmjet komisionit të ngritur me urdhër të tij, i cili mban dhe procesverbalin e konstatimit të gjendjes për dëmet e shkaktuara.

c) Afati kohor nga ngritja e komisionit deri në përfundimin e hartimit të procesverbalit është 5 (pesë) ditë.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare:

a) Procesverbali i konstatimit të gjendjes;

ç) Certifikata familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë;

-Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, neni 15, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave harton “Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 12-13, dhe neni 18, ku përcaktohet që:

Neni 12. Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemën e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrat të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilogruar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë.

Neni 13. Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhrat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”. Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.

Neni 18. Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen. Procesverbalet e mbledhjeve të forumit të organit shtetëror shtypen veças për çdo çështje dhe nënshkruhen nga mbajtësi dhe titullari ose zëvendësi i tij (përjashtim bëjnë procesverbalet e mbledhjes së këshillit të bashkisë, të qarkut e të komunës, që firmosen nga kryetari, sekretari ose i ngarkuari me drejtimin e mbledhjes dhe së paku nga 3 këshilltarë). Kur mbledhja është e përbashkët me përfaqësues të dy a më shumë subjekteve, procesverbali nënshkruhet nga mbajtësi dhe nga titullari ose zëvendësit e secilit subjekt.

-Urdhri nr. 175, datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe Aneksin I, “Rregullat për procedurat

e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, neni 4, pika 1, gërma “b” dhe “c”, ku përcaktohet që:

b. Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

i. Procesverbali i mbledhjes së këshillit;

ii. Procesverbali i dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji;

iii. Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore;

iv. Projektvendimin;

v. Çertifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASH-ja (në vendimarrjen e pronave), plan vendosjet;

vi. Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimarrjes me karakter financiar);

vii. Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimarrjes për emergjencat civile) etj.

c. Në rast se, akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë (i mësipërm), prefekti i qarkut ja kthen menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit;

-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 4, ku përcaktohet që:

4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

-Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2 gërma “i”, ku përcaktohet që:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

Për sa trajtuar më sipër në mungesë të dokumentacionit të sipërpërmendur, Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë **duhej ta kthente për rishqyrtim** VKB-në nr. 143, datë 26.10.2023, pranë Këshillit Bashkiak Korçë.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. A. S, znj. S. M, z. P. P, z. Gj. N, z. D. K, z. Z. B, znj. O. B.

4. Me Vendimin nr. 144, datë 26.10.2023, të KB Korçë me objekt “Mbi miratimin e ndihmës financiare z. T. S, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e tij”, është aprovuar fondi në vlerën 779,490.85 lekë. Me shkresën nr. 924/1 prot., datë 31.10.2023, z. N. J Prefekt i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 144, datë 26.10.2023. Dokumentacioni shoqërues mbi të cilën është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore është dërguar nga Bashkia Korçë me shkresën me nr. 8556 prot., datë 27.10.2023, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 924 prot., datë 27.10.2023, ku pjesë përbërëse janë shkresat si më poshtë:

-Me shkresën nr. 4 prot., datë 26.09.2023, nga Drejtoria e MZSH-së Korçë është lëshuar vërtetimi “Për rënie zjarri” në banesën e z. T. S, nënshkruar nga z. K. C Drejtor i MZSH-së;

-Preventivi i datës 12.10.2023, i hartuar nga Komisioni i Ekspertëve i përbërë nga z. Gj. K, z. F. M dhe z. R. L për dëmet e shkaktuara në orendi dhe pajisje në vlerën 233,000 lekë miratuar nga Këshilli Bashkiak Korçë.

-Preventivi i datës 10.10.2023, i hartuar nga z. F. M, z. R. L dhe z. Gj. K për dëmet e shkaktuara në banesë në vlerën 1,092,981.7 lekë (1,092,981.7 lekë / 50% = 546,490.85 lekë).

-Shkresa me nr. 584/1 prot., datë 11.10.2023, ku z. E. N Kryetar i Këshillit të Qarkut Korçë ka dërguar praktikën e sipërpërmendur pranë Bashkisë Korçë;

-Relacioni pa datë dhe pa numër protokoll, me objekt “Për përcaktimin e ndihmës financiare për z. T. S, të cilit i është dëmtuar banesa nga rënia e zjarrit”, i hartuar nga z. A. Q Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile, znj.V. Z Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrolli, znj.A. Q Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe miratuar nga z. S. F Kryetar i Bashkisë Korçë;

Nga auditimi i praktikës të sipërpërmendur konstatohet se, nga Prefektura e Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 144, datë 26.10.2023, në mungesë të dokumentacionit si më poshtë:

1. Procesverbalin e mbledhjes së këshillit;
 2. Projekt Vendimi nuk përmban të gjithë elementët përkatës si datë, numër protokollit si dhe nënshkrimin e Kryetarit të Këshillit Bashkiak Korçë;
 3. Nuk disponohet kërkesa për ndihma financiare pranë Bashkisë Korçë nga z. T. S;
 4. Nuk disponohet urdhri për ngritjen e grupit të punës nga Kryetari i Bashkisë Korçë për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore, i cili brenda pesë ditëve duhet të hartonte procesverbalin e konstatimit të dëmeve;
 5. Nuk disponohet certifikata familjare e z. T. S në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë;
- Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kapitulli III, pika 1, gërma “a”, “b”, “c”, pika 2, gërma “a” dhe “ç”, ku përcaktohet që:

III. Procedura në rastet kur nuk shpallet gjendja e emergjencës civile

Në rastin kur nuk është shpallur gjendja e emergjencës civile, fatkeqësisë natyrore, ndiqen këto procedura:

1. Procedurat e vlerësimit të dëmeve

a) Familjet që kanë pësuar dëme, shkaktuar nga fatkeqësi të ndryshme natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, paraqesin kërkesën e tyre për ndihmë financiare pranë organit të qeverisjes vendore përkatëse.

b) Drejtuesi i organit të qeverisjes vendore verifikon vërtetësinë e fakteve të paraqitura në kërkesë, nëpërmjet komisionit të ngritur me urdhër të tij, i cili mban dhe procesverbalin e konstatimit të gjendjes për dëmet e shkaktuara.

c) Afati kohor nga ngritja e komisionit deri në përfundimin e hartimit të procesverbalit është 5 (pesë) ditë.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare:

a) Procesverbali i konstatimit të gjendjes;

c) Certifikata familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë;

-Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, neni 15, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave harton “Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 12-13, dhe neni 18, ku përcaktohet që:

Neni 12. Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemën e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilogruar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë.

Neni 13. Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhrat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”.

Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.

Neni 18. Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen. Procesverbalet e mbledhjeve të forumit të organit shtetëror shtypen veças për çdo çështje dhe nënshkruhen nga mbajtësi dhe titullari ose zëvendësi i tij (përjashtim bëjnë procesverbalet e mbledhjes së këshillit të bashkisë, të qarkut e të komunës, që firmosen nga kryetari, sekretari ose i ngarkuari me drejtimin e mbledhjes dhe së paku nga 3 këshilltarë). Kur mbledhja është e përbashkët me përfaqësues të dy a më shumë subjekteve, procesverbali nënshkruhet nga mbajtësi dhe nga titullari ose zëvendësit e secilit subjekt.

-Urdhri nr. 175, datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe Aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, neni 4, pika 1, gërma “b” dhe “c”, ku përcaktohet që:

b. Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

i. Procesverbali i mbledhjes së këshillit;

ii. Procesverbali i dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji;

iii. Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore;

iv. Projektvendimin;

v. Certifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASH-ja (në vendimarrjen e pronave), plan vendosjet;

vi. Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimarrjes me karakter financiar);
vii. Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimarrjes për emergjencat civile) etj.
c. Në rast se, akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë (i mësipërm), prefekti i qarkut ja kthen menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit;

-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 4, ku përcaktohet që:

4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

-Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2 gërma "i", ku përcaktohet që:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t'ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

Për sa trajtuar më sipër në mungesë të dokumentacionit të sipërpërmendur, Prefekti i Qarkut Korçë **duhej ta kthente për rishqyrtim** VKB-në nr. 144, datë 26.10.2023, pranë Këshillit Bashkiak Korçë.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. A. S, znj. S. M, z. P. P, z. Gj. N, z. D. K, z. Z. B, znj. O. B.

➤ **Bashkia Kolonjë:**

5. Me Vendimin nr. 4, datë 24.01.2023, të KB Kolonjë me objekt "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2023", janë miratuar kriteret për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike. Me shkresën nr. 108/2 prot., datë 06.02.2023, z. N. J., Prefekt i Prefekturës së Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 4, datë 24.01.2023.

Dokumentacioni shoqërues mbi të cilën është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore është dërguar nga Bashkia Kolonjë me shkresën me nr. 490 prot., datë 27.01.2023, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 108 prot., datë 30.01.2023, ku pjesë përbërëse janë shkresat si më poshtë:

-Projekt Vendimi nr. 4, datë 24.01.2023, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2023";

Nga auditimi i praktikës të sipërpërmendur konstatohet se, nga Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 4, datë 24.01.2023, në mungesë të dokumentacionit si më poshtë:

1. Procesverbalin e mbledhjes së këshillit;
2. Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore;
3. Dokumentacioni mbështetës për dhënien e ndihmës familjare konkretisht formularin për aplikimin për ndihmë ekonomike;

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat", neni 15, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave harton "Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", nenet 12-13, dhe neni 18, ku përcaktohet që:

Neni 12. Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemën e Republikës, intestimin "Republika e Shqipërisë", emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën "në përgjigje" ose "vijim të shkresës" (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e

ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilografuar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë.

Neni 13. Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhrat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilanci etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”. Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.

Neni 18. Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen. Procesverbalet e mbledhjeve të forumit të organit shtetëror shtypen veças për çdo çështje dhe nënshkruhen nga mbajtësi dhe titullari ose zëvendësi i tij (përjashtim bëjnë procesverbalet e mbledhjes së këshillit të bashkisë, të qarkut e të komunës, që firmosen nga kryetari, sekretari ose i ngarkuari me drejtimin e mbledhjes dhe së paku nga 3 këshilltarë). Kur mbledhja është e përbashkët me përfaqësues të dy a më shumë subjekteve, procesverbali nënshkruhet nga mbajtësi dhe nga titullari ose zëvendësit e secilit subjekt.

-Urdhri nr. 175, datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe Aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, neni 4, pika 1, gërma “b” dhe “c”, ku përcaktohet që:

b. Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

i. Procesverbali i mbledhjes së këshillit;

ii. Procesverbali i dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji;

iii. Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore;

iv. Projektvendimin;

v. Çertifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASH-ja (në vendimarrjen e pronave), plan vendosjet;

vi. Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimarrjes me karakter financiar);

vii. Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimarrjes për emergjencat civile) etj.

c. Në rast se, akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë (i mësipërm), prefekti i qarkut ja kthen menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit;

-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 4, ku përcaktohet që:

4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

-Ligjin nr. 57/2019, datë 18.07.2019, “Për asistencë sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 21, ku përcaktohet që:

Neni 22. “Roli i strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki”

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, për efekt të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar, kryen këto detyra:

a) dërgon nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar listën e plotë të familjeve/individëve në nevojë nën juridiksionin e bashkisë pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror për trajtim me ndihmë ekonomike;

b) përgatit listën e plotë dhe masat e përfitimit për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar për ekzekutimin e tyre;

c) harton kërkesën për buxhetin dhe projektbuxhetin për vitin pasardhës për ndihmën ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuar.

c) grumbullon dhe përgatit informacione e statistika, të cilat i dërgon pranë strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, mban regjistrin e përfituesve dhe ndjek shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar;

d) monitoron punën e administratorit shoqëror, për të shmangur veprime të kryera nga ana e tij në kundërshtim me këtë ligj;

dh) bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me zyrat vendore të punësimin për riintegrimin social të anëtarëve të familjeve në nevojë, të cilët janë në moshë aktive pune.

-VKM nr. 597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondit e kushtëzuar për ndihmë ekonomike”, Kapitulli II, pika 1, gërma “a”, ku përcaktohet që:

1. Administratori shoqëror identifikon familjet dhe individët në nevojë, i informon ata mbi procedurat e aplikimit dhe të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe i fton ata për aplikim. Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhore, së bashku me bashkëshortin/en, ose të vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kur aplikon për ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar, brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit, të dhënat e mëposhtme:

a) Formularin për aplikim për ndihmë ekonomike, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, dhe që përmbledh informacionin për:

i. demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin;

ii. llojin e banesës;

iii. pasuritë/asetet familjare;

iv. të ardhurat nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhurat e tjera;.....

Për sa trajtuar më sipër në mungesë të dokumentacionit të sipërpërmendur, Prefekti i Prefekturës Qarkut Korçë **duhej ta kthente për rishqyrtim** VKB-në nr. 4, datë 24.01.2024, pranë Këshillit Bashkiak Kolonjë.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Prefekturës së Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. A. S, znj. F. R, znj. M. Z, z. Gj. T, z. D. K, znj. L. B, znj. O. B.

6. Me Vendimin nr. 8, datë 24.01.2023, të KB Kolonjë me objekt “Për shprehje dakordësie”, është miratuar kërkesa për rikonstrukcionin e katit të parë të konviktit në qytetin e Leskovikut (godina me numër pasurie 3., ZK 2.) e cila do të përdoret si inkubator agrobiznesi të drejtuar nga gratë në qytetin e Leskovikut duke investuar në infrastrukturë e pajisje, si dhe ofrimin të trajnimeve teknike të grave. Me shkresën nr. 108/2 prot., datë 06.02.2023, z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 8, datë 24.01.2023.

Dokumentacioni shoqëruar mbi të cilën është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore është dërguar nga Bashkia Kolonjë me shkresën me nr. 490 prot., datë 27.01.2023, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 108 prot., datë 30.01.2023, ku pjesë përbërëse janë shkresat si më poshtë:

-Projekt Vendimi nr. 8, datë 24.01.2023, “Për shprehje dakordësie”;

-Kërkesa e FAO-s në Shqipëri e datës 19.01.2023;

Nga auditimi i praktikës të sipërpërmendur konstatohet se, nga Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 8, datë 24.01.2023, në mungesë të dokumentacionit si më poshtë:

1. Procesverbalin e mbledhjes së këshillit;

2. Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore;

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, neni 15, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave harton “Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 12-13, dhe neni 18, ku përcaktohet që:

Neni 12. Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stëmën e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrimit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilogruar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë.

Neni 13. Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhrat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshitetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”. Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.

Neni 18. Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen. Procesverbalet e mbledhjeve të forumit të organit shtetëror shtypen veças për çdo çështje dhe nënshkruhen nga mbajtësi dhe titullari ose zëvendësi i tij (përjashtim bëjnë procesverbalet e mbledhjes së këshillit të bashkisë, të qarkut e të komunës, që firmosen nga kryetari, sekretari ose i ngarkuari me drejtimin e mbledhjes dhe së paku nga 3 këshilltarë). Kur mbledhja është e përbashkët me përfaqësues të dy a më shumë subjekteve, procesverbali nënshkruhet nga mbajtësi dhe nga titullari ose zëvendësit e secilit subjekt.

-Urdhri nr. 175, datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe Aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, neni 4, pika 1, gërma “b” dhe “c”, ku përcaktohet që:

b. Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

i. Procesverbali i mbledhjes së këshillit;
ii. Procesverbali i dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji;
iii. Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore;
iv. Projektvendimin;
v. Çertifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASH-ja (në vendimarrjen e pronave), plan vendosjet;
vi. Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimarrjes me karakter financiar);
vii. Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimarrjes për emergjencat civile) etj.
c. Në rast se, akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë (i mësipërm), prefekti i qarkut ja kthen menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit;

-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 4, ku përcaktohet që:

4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

Nga auditimi i praktikës të sipërpërmendur konstatohet se, nga Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore të VKB-në nr. 8, datë 24.01.2023, i pa bazuar në ligj, konkretisht:

Në VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, neni 4/1, ku përcaktohet që:

Neni 4/1. Shërbimet e ofruara nga sistemi elektronik i lejeve:

1. Çdo subjekt, i cili kërkon të pajiset me leje apo të paraqesë deklaratë paraprake për kryerje punimesh, është i detyruar të dorëzojë aplikimin për leje apo deklaratën dhe dokumentacionin shoqërues nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

Referuar nenit 4/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, marrim informacion se: “Çdo subjekt, i cili kërkon të pajiset me leje apo të paraqesë deklaratë paraprake për kryerje punimesh, është i detyruar të dorëzojë kërkesën aplikimin për leje apo deklaratën dhe dokumentacionin shoqërues nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve”.

Këshilli Bashkiak nuk është organi kompetent për miratimin e deklaratave paraprake të punimeve apo lejeve të ndërtimit. Organi kompetent për miratimin e këtyre lejeve është Kryetari i Bashkisë, referuar nenit 12 dhe 13 të Ligjit nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Arsyeja e shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve është marrja e sigurisë së lartë se ndërhyrjet e kërkuara respektojnë të gjithë kriteret urbanistik, ndërtimor, të sigurisë, higjenës, etj. Nëpërmjet këtij sistemi, aplikanti ka detyrimin e marrjes së mendimit nga autoritetet e tjera të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Miratimi i lejeve të ndërtimit nga Këshilli Bashkiak nuk jep siguri se janë shqyrtuar dhe vlerësuar kriteret e ndryshme, duke veçuar ato të sigurisë, si dhe nuk është kërkuar dhe marrë mendimi nga autoritetet e tjera të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2 gërma “i”, ku përcaktohet që:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t'ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

Për sa trajtuar më sipër në mungesë të dokumentacionit të sipërpërmendur, Prefekti i Qarkut Korçë duhej ta kthente për rishqyrtim VKB-në nr. 8, datë 24.01.2024, pranë Këshillit Bashkiak Kolonjë.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Prefekturës së Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. A. S, znj. F. R, znj. M. Z, z. Gj. T, z. D. K, znj. L. B, znj. O. B.

➤ **Bashkia Pogradec:**

7. Me Vendimin nr. 31, datë 23.03.2023, KB Pogradec ka vendosur “Miratimin e listës së fondit kullosor, që mund të jepen me qira për kullotje e kositje bari me sipërfaqe prej 1512,75 ha, në ekonomitë kullosore: Golik-Kalivaç, Vërri-Debrovë, Pretushë-Lin, Guri Top-Gjemth, Dunicë-Llëngë dhe Niçë-Valamarë dhe Kontratës Tip”. Me shkresën nr. 304/1 prot., datë 30.03.2023, Prefekti i Qarkut Korçë z. N. J, ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 31, datë 23.03.2023.

Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike Bashkia Pogradec është hartuar relacioni mbi “Miratimin e listës së fondit kullosor, që mund të jepen me qira për kullotje e kositje bari me sipërfaqe prej 1512,75 ha, në ekonomitë kullosore: Golik-Kalivaç, Vërri-Debrovë, Pretushë-Lin, Guri Top-Gjemth, Dunicë-Llëngë dhe Niçë-Valamarë dhe Kontratës Tip” duke listuar disa rregulla dhe parime për dhënien e kullotave me qira ose përdorim për kullotje e kositje bari.

Bashkëngjitur vendimit, projekt-vendimit dhe relacionit Këshilli Bashkiak Pogradec ka vënë në dispozicion dhe listën e kullotave të gatshme për kullotje e kositje bari për vitin 2023, në pronësi të Bashkisë Pogradec.

Projekt-Vendimi është i pa protokolluar dhe i pa nënshkruar nga Kryetari i Këshillit Bashkiak Pogradec z. S. M. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, neni 15, “Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave harton “Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 12-13, dhe neni 18. Në praktikën e administruar nga Prefekti i Qarkut Korçë ku mbi të cilën duhet të shprehet për bazueshmërinë ligjore mungojnë certifikatat e pronësisë dhe plan-vendosjet. Veprime këto në kundërshtim me Urdhrin të Ministrit të Brendshëm nr. 175, datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizmin dhe funksionimin e institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe Aneksin 1 “Rregulla për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu 2, gërma “b”, pika V, ku përcaktohet që:

Çertifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASHK-ja (në vendimmarrjet e pronave), plan vendosjet, si dhe gërma c ku shprehet se: Nëse akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm (i mësipërm), prefekti i qarkut ia kthen menjëherë aktin NJVQV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2 gërma “i”, ku përcaktohet që:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin, ku si përfundim Prefekti i Qarkut Korçë duhej ta kthente vendimin e mësipërm të Këshilit Bashkiak Pogradec për rishqyrtim. **Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. S. M, z. Gj. T, z. D. K, znj. L. B dhe znj. O. B.

8. Me Vendimin nr. 73, datë 27.07.2023, të KB Pogradec me objekt “Për dhënien e ndihmës financiare znj. Sh. J, për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë”, është aprovuar fondi në vlerën 97,154 lekë.

Me shkresën nr. 694/1 prot., datë 15.08.2023, z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 73, datë 27.07.2023. Dokumentacioni shoqërues mbi të cilën është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore është dërguar nga Bashkia Pogradec me shkresën

me nr. 2867 prot., datë 02.08.2023, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 694 prot., datë 08.08.2023, ku pjesë përbërëse janë shkresat si më poshtë:

-Shkresa me nr. 2867/4 prot., datë 13.07.2023, e z. I. Xh., Kryetar i Bashkisë duke dërguar praktikën pranë Këshillit Bashkiak Pogradec;

-Projektvendimi pa datë dhe pa numër protokolli me objekt “Për dhënien e ndihmës financiare znj. Sh. J, për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë”;

-Preventivi pa datë dhe pa numër protokolli, i hartuar nga Komisioni i Vlerësimit të Emergjencave i përbërë nga znj. B. N, z. D. D, z. K. M, z. I. K dhe znj. D. Ç për dëmet e shkaktuara në banesë në vlerën 102,908 lekë (102,908 lekë / 50% = 51,454 lekë), miratuar nga Kryetari i Bashkisë;

-Preventivi pa datë dhe pa numër protokolli, i hartuar nga Komisioni i Vlerësimit të Emergjencave i përbërë nga znj. B. N, z. D. D, z. K. M, z. I. K dhe znj. D. Ç për dëmet e shkaktuara në orendi dhe pajisje në vlerën 45,700 lekë miratuar nga Kryetari i Bashkisë;

-Relacioni pa datë dhe pa numër protokolli, me objekt “Për dhënien e ndihmës financiare znj. Sh. J, për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë”, i hartuar nga z. R. Y, znj. M. Z, znj. B. N dhe znj. A. K;

-Folmulari i aplikimit nga znj. Sh. J., i administruar në Bashkinë Pogradec me praktikën nr. 1662 prot., datë 20.04.2023;

-Çertifikata familjare e datës 20.04.2023;

-Vërtetim banimi me shkresën nr. 95 prot., datë 20.04.2023, lëshuar nga Njësia Administrative Buçimas;

-Çertifikatë personale e datës 03.05.2023;

-Çertifikatë vdekje (nga akti) i datës 03.05.2023;

-Vërtetim banimi i datës 09.05.2023, lëshuar nga Njësia Administrative Buçimas;

-Urdhri nr. 274, datë 03.06.2023, i z. I. Xh Kryetar i Bashkisë Pogradec për ngritjen e komisionit të konstatimit të dëmeve në rast fatkeqësish i përbërë nga znj. M. Z kryetar i komisionit dhe anëtarët z. R. Y, z. K. L;

-Urdhri nr. 274, datë 03.06.2023, i z. I. Xh Kryetar i Bashkisë Pogradec për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dëmeve në rast fatkeqësish i përbërë nga znj. B. N kryetar i komisionit dhe anëtarët z. D. D, z. K. M, z. I. K, znj. D. Ç;

-Procesverbali i datës 20.04.2023, për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit i hartuar nga znj. M. Z, z. K. L, z. R. Y, znj. B. N;

Nga auditimi i praktikës të sipërpërmendur konstatohet se, nga Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 73, datë 27.07.2023, në mungesë të dokumentacionit si më poshtë:

1. Procesverbalin e mbledhjes së këshillit;

2. Akt-ekspertza nga PMNZSH-ja, në rastet e rënies së zjarrit;

Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kapitulli III, pika 2, gërma “dh”, ku përcaktohet që:

III. Procedura në rastet kur nuk shpallet gjendja e emergjencës civile

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare:

dh) Akt-ekspertiza nga PMNZSH-ja, në raste zjarri dhe vërtetimi nga Policia e Shtetit ose prokuroria e rrethit, në rast eksplozivi;

-Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, neni 15, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave harton “Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 12-13, dhe neni 18, ku përcaktohet që:

Neni 12. Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemën e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrit të korrespondencës (Mod. 1), vendin

dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur. Kur dokumenti është i daktilografuar, Kuvendit të Shqipërisë, Presidentit, Këshillit të Ministrave e Gjykatës Kushtetuese u dërgohet kopja e parë.

Neni 13. Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhrat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e joshetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet, etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”. Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.

Neni 18. Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen. Procesverbalet e mbledhjeve të forumit të organit shtetëror shtypen veças për çdo çështje dhe nënshkruhen nga mbajtësi dhe titullari ose zëvendësi i tij (përjashtim bëjnë procesverbalet e mbledhjes së këshillit të bashkisë, të qarkut e të komunës, që firmosen nga kryetari, sekretari ose i ngarkuari me drejtimin e mbledhjes dhe së paku nga 3 këshilltarë). Kur mbledhja është e përbashkët me përfaqësues të dy a më shumë subjekteve, procesverbali nënshkruhet nga mbajtësi dhe nga titullari ose zëvendësit e secilit subjekt.

-Urdhri nr. 175, datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe Aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, neni 4, pika 1, gërma “b” dhe “c”, ku përcaktohet që:

b. Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

i. Procesverbali i mbledhjes së këshillit;

ii. Procesverbali i dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji;

iii. Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore;

iv. Projektvendimin;

v. Çertifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASH-ja (në vendimarrjen e pronave), plan vendosjet;

vi. Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimarrjes me karakter financiar);

vii. Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimarrjes për emergjencat civile) etj.

c. Në rast se, akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë (i mësipërm), prefekti i qarkut ja kthen menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit;

-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 4, ku përcaktohet që:

4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

-Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2 gërma “i”, ku përcaktohet që:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

Për sa trajtuar më sipër në mungesë të dokumentacionit të sipërpërmendur, Prefekti i Qarkut Korçë duhej ta kthente për rishqyrtim VKB-në nr. 73, datë 27.07.2023, pranë Këshillit Bashkiak Pogradec.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. S. M, z. L. M, z. P. P, z. A. Xh, z. D. K, z. Z. B, znj. O. B.

9. Me Vendimin nr. 76, datë 26.07.2023, të KB Pogradec me objekt “Për dhënien e ndihmës financiare z. Sh. B, për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë”, është aprovuar fondi në vlerën 428,636 lekë. Me shkresën nr. 694/1 prot., datë 15.08.2023, z. N. J Prefekt i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 76, datë 26.07.2023. Nga auditimi i praktikës u konstatua se ka një parregullsi ne perlllogaritjen e preventivit të orendive konkretisht:

Në lidhje me referencat e çmimeve të evidentuara në preventivin e hartuar nga komisioni i vlerësimit të dëmeve të orendive dhe pajisjeve konstatohet se, për zërin “Kolltuk tresh” çmimi për njësi është 3,000 lekë ndërsa në preventiv është vlerësuar në vlerën 45,000 lekë me një diferencë në vlerën 42,000 lekë. Në total preventivi për dëmet e orendive, pajisjeve dhe objektit shkon në

vlerën 386,636 lekë ndërsa fondi i miratuar nga Këshilli Bashkiak Korçë është në vlerën **428,636 lekë**.

Për sa trajtuar më sipër Prefekti i Qarkut Korçë ka miratuar bazeshmërinë ligjore të aktit, pa marrë në konsideratë fakti që ka gabim në përlllogaritje të preventivit nga komisioni për vlerësimin e dëmeve për orenditë dhe pajisjet.

Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kapitulli III, pika 1, gërma “a”, “b”, “c”, pika 2, gërma “c”, ku përcaktohet që:

III. Procedura në rastet kur nuk shpallet gjendja e emergjencës civile

Në rastin kur nuk është shpallur gjendja e emergjencës civile, fatkeqësisë natyrore, ndiqen këto procedura:

1. Procedurat e vlerësimit të dëmeve

a) Familjet që kanë pësuar dëme, shkaktuar nga fatkeqësi të ndryshme natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, paraqesin kërkesën e tyre për ndihmë financiare pranë organit të qeverisjes vendore përkatëse.

b) Drejtuesi i organit të qeverisjes vendore verifikon vërtetësinë e fakteve të paraqitura në kërkesë, nëpërmjet komisionit të ngritur me urdhër të tij, i cili mban dhe procesverbalin e konstatimit të gjendjes për dëmet e shkaktuara.

c) Afati kohor nga ngritja e komisionit deri në përfundimin e hartimit të procesverbalit është 5 (pesë) ditë.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare:

c) Preventivat e dëmeve nga ana ndërtimore në objektet e banimit, si dhe dëmeve në orendi, mobilie dhe pajisje elektroshtëpiake;

-Urdhri nr. 175, datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe Aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu 2, pika b, gërma VII, ku përcaktohet që:

Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimarrjes për emergjencat civile), si dhe gërma c ku shprehet se: Nëse akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm (i mësipërm), prefekti i qarkut ia kthen menjëherë aktin NJVQV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

-Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2 gërma “i”, ku përcaktohet që:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

Për sa trajtuar më sipër në mungesë të dokumentacionit të sipërpërmendur, Prefekti i Qarkut Korçë **duhej ta kthente për rishqyrtim** VKB-në nr. 76, datë 26.07.2023, pranë Këshillit Bashkiak Pogradec.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. S. M, z. L. M, z. P. P, z. A. Xh, z. D. K, z. Z. B, znj. O. B.

➤ **Bashkia Devoll:**

10. Me Vendimin nr. 85, datë 30.11.2023, të KB Devoll me objekt “Për dhënien e miratimit për dhënien me qira të sipërfaqes 27.6 ha në ngastra me nr. 160b, në ekonominë pyjore “Qafë Zvezde-Trestenik”, është miratuar dhënia e qira e sipërfaqes prej 27.6 ha pjesë e fondit pyjor kullësor me vendodhje “Qafë Zvezde-Trestenik”. Me shkresën nr. 1034/1 prot., datë 13.12.2023, z. N. J. Prefekt i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 85, datë 30.11.2023. Dokumentacioni shoqërues mbi të cilën është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore është dërguar nga Bashkia Devoll me shkresën me nr. 4034 prot., datë 06.12.2023, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 1034 prot., datë 06.12.2023, ku pjesë përbërëse janë shkresat si më poshtë:

-Projektvendimi nr. 77, datë 20.10.2023, me objekt “Për dhënien e miratimit për dhënien me qira të sipërfaqes 27.6 ha në ngastra me nr. 160b, në ekonominë pyjore “Qafë Zvezde-Trestenik”;

-Relacioni pa datë dhe pa numër protokollit me objekt “Për dhënien e miratimit për dhënien me qira të sipërfaqes 27.6 ha në ngastra me nr. 160b, në ekonominë pyjore “Qafë Zvezde-Trestenik”, i nënshkruar nga znj. E. A dhe miratuar nga z. E. D Kryetar i Bashkisë Devoll;

-Plan vendosje e ngastrës me nr. 160b;

Nga auditimi i praktikës të sipërpërmendur konstatohet se, nga Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 85, datë 30.11.2023, në mungesë të dokumentacionit si më poshtë:

1. Procesverbalin e mbledhjes së këshillit;

2. Raporti mbi studimin tekniko për dhënien në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqes në pronësi publike të Bashkisë Devoll;

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin i Ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016, “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, Shtojca nr. 1, ku përcaktohet:

Raport mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim /heqje nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqes në pronësi të bashkisë.....

-Urdhri nr. 175, datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe Aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, neni 4, pika 1, gërma “b” dhe “c”, ku përcaktohet që:

b. Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

i. Procesverbali i mbledhjes së këshillit;

ii. Procesverbali i dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji;

iii. Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore;

iv. Projektvendimin;

v. Çertifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASH-ja (në vendimarrjen e pronave), plan vendosjet;

vi. Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimarrjes me karakter financiar);

vii. Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimarrjes për emergjencat civile) etj.

c. Në rast se, akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë (i mësipërm), prefekti i qarkut ja kthen menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit;

-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 4, ku përcaktohet që:

4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

-Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2 gërma “i”, ku përcaktohet që:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

Për sa trajtuar më sipër në mungesë të dokumentacionit të sipërpërmendur, Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë **duhej ta kthente për rishqyrtim** VKB-në nr. 85, datë 30.11.2023, pranë Këshillit Bashkiak Devoll.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. A. S, znj. S. M, z. A. Xh, z. Gj. T, z. Gj. N, z. D. K, znj. L. B, znj. z. Z. B, znj. O. B.

11. Me Vendimin nr. 86, datë 30.11.2023, të KB Devoll me objekt “Për dhënien e miratimit për dhënien me qira të sipërfaqes 33 ha në ngastra me numër pasurie 1. në ekonominë pyjore kullimore “Bilisht”, është miratuar dhënia e qira e sipërfaqes prej 33 ha pjesë e fondit pyjor kullor me vendodhje “Bilisht”. Me shkresën nr. 1034/1 prot., datë 13.12.2023, z. N. J Prefekt i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 85, datë 30.11.2023. Dokumentacioni shoqëruar mbi të cilën është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore është dërguar nga Bashkia

Devoll me shkresën me nr. 4034 prot., datë 06.12.2023, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 1034 prot., datë 06.12.2023, ku pjesë përbërëse janë shkresat si më poshtë:
-Projektvendimi nr. 78, datë 20.10.2023, me objekt “Për dhënien e miratimit për dhënien me qira të sipërfaqes 33 ha në ngastra me numër pasurie 1878 në ekonominë pyjore kullimore “Bilisht”;
-Relacioni pa datë dhe pa numër protokolli me objekt “Për dhënien e miratimit për dhënien me qira të sipërfaqes 33 ha në ngastra me numër pasurie 1878 në ekonominë pyjore kullimore “Bilisht”, i nënshkruar nga znj. E. A dhe miratuar nga z. E. D Kryetar i Bashkisë Devoll;
-Plan vendosje e ngastrës me nr. 1878;

Nga auditimi i praktikës të sipërpërmendur konstatohet se, nga Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 86, datë 30.11.2023, në mungesë të dokumentacionit si më poshtë:

1. Procesverbalin e mbledhjes së këshillit;

2. Raporti mbi studimin tekniko për dhënien në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqes në pronësi publike të Bashkisë Devoll;

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin i Ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016, “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, Shtojca nr. 1, ku përcaktohet:

Raport mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim /heqje nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqes në pronësi të bashkisë.....

-Urdhri nr. 175, datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe Aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, neni 4, pika 1, gërma “b” dhe “c”, ku përcaktohet që:

b. Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

i. Procesverbali i mbledhjes së këshillit;

ii. Procesverbali i dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji;

iii. Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore;

iv. Projektvendimin;

v. Çertifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASH-ja (në vendimarrjen e pronave), plan vendosjet;

vi. Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimarrjes me karakter financiar);

vii. Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimarrjes për emergjencat civile) etj.

c. Në rast se, akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë (i mësipërm), prefekti i qarkut ja kthen menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit;

-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 4, ku përcaktohet që:

4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

-Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2 gërma “i”, ku përcaktohet që:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

Për sa trajtuar më sipër në mungesë të dokumentacionit të sipërpërmendur, Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë **duhej ta kthente për rishqyrtim** VKB-në nr. 86, datë 30.11.2023, pranë Këshillit Bashkiak Devoll.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe grupi i punës znj. A. S, znj. S. M, z. A. Xh, z. Gj. T, z. Gj. N, z. D. K, znj. L. B, znj. z. Z. B, znj. O. B.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Prefektura e Qarkut Korçë është paraqitur observacioni me shkresën nr. 343/17 prot., datë 10.09.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 563/7 prot., datë 13.09.2024, nga z. N. J, Prefekt i Qarkut Korçë dhe Grupi i Punës znj. O. B, z. D. K, znj. L. B, znj. A. S dhe znj. S. M ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimin nr. 1, datë 26.07.2024, (faqe nr.1-7) lidhur me përcaktimin e natyrës juridike të akteve (akt administrativ Normativ, Kolektiv dhe Individual) të miratuara nga Këshillat e Bashkive Korçë, Pogradec, Maliq, Devoll, Kolonjë, Pustec dhe Këshilli i Qarkut Korçë, me qëllim verifikimin e bazueshmërisë ligjore të tyre, institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, Sektori Juridik, sqaron edhe njëherë se vazhdimisht ka kërkuar nga bashkitë e qarkut që për secilin akt të miratuar, duhet që (Drejtoria Juridike në bashki në bashkëpunim me Sekretarin e Këshillit bashkiak), të përcaktojnë natyrën juridike të aktit si detyrim ligjor. Ky proces pune (përcaktimi i karakterit juridik të aktit) është detyrim i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (Drejtorive juridike dhe sekretarëve të këshillave bashkiakë). Megjithëse nga institucioni i Prefektit në takimet e zhvilluara me Kryetarët dhe Sekretarët e Këshillave Bashkiakë si dhe referuar shkresave drejtuar bashkive dhe këshillave bashkiakë, disa herë i'u është tërhequr vëmendja për detyrimin ligjor që ato kanë për respektimin e nenit 8 gërma "a" dhe 16 pika 2 gërma "a" të Ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e Qarkut" të ndryshuar. Ky detyrim është realizuar vetëm nga Bashkia Devoll (nëpërmjet relacionit të posaçëm nga Drejtoria e Juridike e kësaj bashkie mbi përcaktimin e natyrës juridike të akteve). Ndërsa 5 bashkitë e tjera dhe Këshilli i Qarkut Korçë, vazhdojnë të mos përcaktojnë dhe relatojnë mbi natyrën juridike të akteve të miratuara. Institucioni i Prefektit të Qarkut, gjatë punës për verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ, ka bërë ndarjen e akteve në përputhje me nenin 3 të Kodit të Procedurave Administrative, duke konfirmuar vetëm aktet e këshillave të cilat i ka konsideruar si akte administrative me karakter normativ. Këtu përmendim faktin se aktet e Këshillave Bashkiake, janë akte administrative të një natyre të veçantë, ku brenda objektivit të tyre, në shumë raste konstatohet se akti ka në përmbajtje natyrë normative, kolektive dhe njëkohësisht edhe individuale. Pikërisht është ky interpretim që në disa raste sjell vështirësi në përcaktimin e karakterit administrativ të aktit nga institucioni ynë. Për këto raste, me qëllim verifikimin e ligjshmërisë kemi konkluduar që akti të futet në kompetencën e Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë së tij. Vlerësojmë edhe njëherë se verifikimi i ligjshmërisë së këtyre akteve, jo vetëm që nuk pengon procesin e punës dhe zbatueshmërinë e tyre nga NJVV-të apo subjektet që përfshihen për zbatim, por nëpërmjet argumentave të dhëna e të bazuara në ligj nga ana jonë, kemi sugjeruar dhe orientuar NJVV-të, për zbatim korrekt të tyre. Në çdo rast nga institucioni është parë me përparësi forma, qëllimi i nxjerrjes së aktit dhe përmbajtja e dispozitave konkrete të tij, duke përmbushur kërkesat e nenit 98 dhe 99 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr. 6, datë 29.04.2022, "Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative".

Qëndrimi i grupit të auditimit: Problematika e konstatuar nga grupi i auditimit ka të bëjë jo vetëm me administrimin e akteve me karakter jo normativ të depozituara nga bashkitë pranë Prefekturës së Qarkut Korçë, por edhe me trajtimin e akteve e karakter jo normativ si akte me karakter normativ. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

2. Pretendimi i subjektit: Shqyrtimi i dokumentacionit të akteve. (faqe nr. 40-84 të Projekt Raportit dhe Akt-Konstatimit nr. 1). Në lidhje me konstatimin dhe gjetjet që lidhen me verifikimin të ligjshmërisë së akteve dhe dokumentacionit që ato duhet të kenë bashkëlidhur, ku i referoheni Aneksit nr. 1, të Rregullores së Brendshme për organizimin dhe Funksionimin e institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, si procesverbalet e mbledhjeve, procesverbalet e dëgjësive publike, relacionet e akteve, projektvendime, certifikata pronësie, pasqyrat financiare dhe dokumentacion për emergjencat civile, argumentojmë si vijon:

a. Referuar përcaktimeve të rregullores së këshillave bashkiake, mbledhjet e këshillave bashkiakë, zhvillohen sipas përcaktimeve që bën këshilli dhe transmetohen në kohë reale online. Sekretari i Këshillit, gjatë mbledhjes mban me shkrim procesverbalin e mbledhjes për atë që është e mundur, administron sistemin audio dhe menjëherë pas mbarimit të mbledhjes së këshillit nis punën për zbardhjen e procesverbalit të plotë të mbledhjes sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e Këshillit. Në përfundim bashkëngjit procesverbalin, vendimeve të miratuara në mbledhjen e këshillit.

b. Pas zbardhjes së procesverbalit, sipas përcaktimeve të rregullores së funksionimit të këshillit bashkiak, ashtu siç keni konstatuar nga leximi i shkresës përcjellëse të akteve nga NJVV-të gjatë procesit të

auditimit, sekretari dhe kryetari i këshillit, fut për miratim procesverbalin e mbledhjes së kaluar në mbledhjen pasardhëse të këshillit bashkiak. Ky procesverbal pasi u është vënë më parë në dispozicion të gjithë këshilltarëve, shqyrtohet në mbledhjen e këshillit bashkiak dhe miratohet me shumicën e votave sipas nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar. Pra, procesverbali nuk nënshkruhet vetëm nga tre këshilltarë sikurse evidentohet në aktin e konstatimit, por miratohet me shumicën 50+1 % të të gjithë anëtarëve të këshillave bashkiakë. Gjithashtu, gjatë procesit të depozitimit të akteve nga institucioni i Prefektit i kushtohet rëndësi e veçantë numrit të votave për miratimin e aktit, ku për çdo rast, (vendimet e këshillave) citojnë numrin e votave të nevojshme që kanë çuar në miratimin e tyre.

c. Në lidhje me mënyrën e zbardhjes së procesverbalit të akteve, formës dhe elementëve përbërës së tij, theksojmë se institucioni i Prefektit i kushton vëmendje të veçantë procesverbalit gjatë procesit të verifikimit në vend të akteve në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, ku gjatë këtij procesi pune është konstatuar se procesverbalet e mbledhjes janë të plotë, diskutimet e këshilltarëve lidhur me projekt akteve po ashtu janë zbardhur të plota si dhe në mënyrë të qartë jepen të shprehura kuorumi për fillimin e mbledhjes dhe numri i votave që ka marrë secili nga aktet e miratuara.

d. Sa konstatoni në lidhje me zbatimin e Aneksit nr. 1, të Rregullores së Brendshme për organizimin dhe Funksionimin e institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, miratuar nga Ministri i Brendshëm, shpjegojmë se ky akt administrativ ka karakter orientues. Në këtë rast, theksojmë se ligji përcakton qartë nenin konkret dhe autorizimin ligjor të organit që ka pasur detyrim për nxjerrjen e aktit nënligjor. (Neni 24 i ligjit nr.107/2016, ngarkon Këshillin e Ministrave, të nxjerrë vendimin në zbatim të pikës 1, të nenit 18, të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe jo ndonjë organ tjetër publik).

e. Duke krahasuar ligjin dhe urdhërin e ministrit si akt administrativ nënligjor, përparësi ka ligji nr. 107/2016, "Për Prefektin e qarkut", i cili në nenin 16 pika 2 citon se, "Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën e mëposhtme. "Pra ligjvënësi ka përcaktuar qartë dhe në mënyrë shteruese kompetencën e Prefektit lidhur me verifikimin e përputhshmërisë së akteve me ligjin. Ashtu si përmendëm më lart, ky ligj dhe neni i posaçëm i tij, përveç Këshillit të Ministrave nuk i ka dhënë autorizim ndonjë organi tjetër shtetëror me qëllim nxjerrjen e akteve administrative nënligjore, që të mund të interpretonte në mënyrë shteruese përcaktimet e nenit 16 të ligjit. Neni 118 i Kushtetutës përcakton se, ligji mund të ngarkojë organet e parashikuara në Kushtetutë të nxjerrin akte nënligjore për çështje të caktuara në bazë të procedurave të përcaktuara në ligj, por organi i përcaktuar në ligj nuk mund t'ia delegojë këtë kompetencë një organi tjetër. Po ashtu, megjithëse neni 4 pika 1 gërma "b" i Aneksit nr. 1, të urdhërit të Ministrit, citon se.. Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentat e mëposhtme... si procesverbalet e mbledhjeve, procesverbalet e dëgjësive publike, relacionet e akteve, projektvendime, certifikata pronësie, pasqyrat financiare dhe dokumentacion për emergjencat civile", sqarojmë se dokumentat e cituara kanë të bëjnë me faza të ndryshme para dhe pas vendimarrjes së këshillave bashkiakë. Rast pas rasti, kur institucioni i Prefektit të Qarkut, ka vlerësuar të nevojshme dhe për një verifikim sa më objektiv të aktit, ka kërkuar nga bashkia dokumentacion apo informacione shtesë, të cilat shërbejnë për një verifikim ligjor të plotë të aktit. Në këtë rast për konfirmimin ose jo të bazueshmërisë ligjore të aktit, ka shërbyer, referimi dhe argumentimi ligjor në relacionet shoqërues së akteve të përpiluara e nënshkruara nga drejtoritë dhe strukturat drejtuese të Bashkive dhe Këshilli i Qarkut Korçë, të cilat nëpërmjet dispozitave ligjore konkrete shprehin në mënyrë të qartë, procedurat ligjore që janë ndjekur dhe do të ndiqen para dhe pas miratimit të akteve në këshillat bashkiakë, kompetencën e organit për propozimin e projektaktit, qëllimin dhe efektet që krijohen. Në sintezë të arsytimit ligjor të mësipërme, sqarojmë se institucioni i Prefektit ka zbatuar parimin e hierarkisë dhe epërsisë së akteve në Republikën e Shqipërisë.

f. Kërkimi i dokumentacionit apo i një informacioni shtesë që lidhet me një akt të nxjerrë nga Këshilli Bashkiak është në vlerësim dhe bindje të institucionit të Prefektit, si organi që vlerëson se akti është marrë ose jo në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ndërsa përgjegjësia lidhur me vërtetësinë dhe përmbajtjen e relacioneve i takon strukturave dhe titullarit të bashkisë, të cilët e kanë nënshkruar atë, si dhe komisioneve e këshillave bashkiake, që kanë verifikuar rast pas rasti dokumentacionin mbi të cilin

është nxjerrë relacioni. Po në këtë frymë ka konkluduar edhe Kuvendi i Shqipërisë me miratimin e Ligjit nr. 36/2024 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për Prefektin e Qarkut”, ku në nenin 7 pika 2, përcakton se “Aktet me karakter normativ shoqërohen me një relacion përmbledhës të arsyeve për nxjerrjen e tyre, duke argumentuar për problematikat, qëllimet, objektivat që synohen të arrihen, përparësitë, si dhe efektet e pritshme nga miratimi”. Pavarësisht sa sqarohet në relacionet përmbledhës që kanë shërbyer në këshill për miratimin e akteve, vlerësojmë se kërkimi i një numri të madh dokumentacioni tjetër (me qëllim provimin e vërtetësisë së relacioneve që shoqërojnë aktet) do të çonte në cënimin e sigurisë juridike të funksionimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, duke marrë në konsideratë këtu edhe parimet dhe përkufizimet e Ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999, “Për ratifikimin e “Kartës Europiane të Autonomisë Vendore” dhe nenit 15 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar. Prefekti i Qarkut është një institucion i cili realizon verifikimin e ligjshmërisë së akteve të nxjerra nga Njësiti e Vetëqeverisjes Vendore, ku ligji i njeh të drejtën të konstatojë përputhshmërinë e akteve administrative me ligjin dhe qëllimin e tij. Nëse konstatohet se akti administrativ nuk është në përputhje me dispozitat ligjore, pas detajimit të argumentave për një qëndrim të tillë, Prefekti i kërkon NJVV-ve rishikimin e akteve me qëllim përshtatjen e tyre me dispozitat ligjore. Megjithatë, garantojmë se institucioni do të angazhohet për vlerësimin e rekomandimeve të përmendura më sipër; në përputhje me kompetencat që i njeh ligji.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Së pari: Grupi i auditimit sqaron se pretendimet e observimet bien ndesh me pretendimin Tuaj që keni paraqitur në observacion për arsye se në rastin e parë i referoheni disa bazave ligjore në lidhje me problematikën e konstatuar nga grupi i auditimit dhe në përfundim citoni se Ne do të angazhohemi ta përmbushim si Rekomandim.

Së dyti: Për sa i përket nenit 118 të Kushtetutës ju bëjmë me dijeni se, Urdhri i Ministrit të Brendshëm i referohet ligjit të Prefektit për më tepër në nenin 102 të Kushtetutës, Ministri i Linjës ka të drejtë të nxjerri urdhra, udhëzime për zbatim për njësiti e varësisë. Në rastin konkret urdhri i Ministrit është akt i detyrueshëm për zbatim nga Prefektura.

Së treti: Për sa i përket procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillave Bashkiak ju bëjmë me dijeni se, në asnjë rast grupi i auditimit nuk është shprehur që bashkitë nuk e disponojnë si dokument, por që bashkëlidhur praktikës nuk ndodhet ky dokumentacion dhe në kushte të tilla Prefekti i Qarkut Korçë ka dhënë konfirmimin e bazueshmërisë ligjore mbi aktin në mungesë të dokumentacionit përkatës.

Së katërti: Në observacion janë paraqitur disa procesverbale mbledhjesh të Këshillave Bashkiak të cilat nuk kanë qenë të bashkëlidhur praktikës mbi të cilën ka shprehur konfirmimin mbi bazueshmërinë Prefekti.

Së pesti: Ligji për Prefektin i vitit 2024, nuk përfshin periudhën objekt auditimi. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

3. Pretendimi i subjektit: Verifikimi në vend i akteve të vetëqeverisjes vendore (Projekt Raporti i Auditimit/fleta nr. 7-nr. 8 e Akt-Konstatimit nr. 1). Në lidhje me këtë konstatim, institucioni i Prefektit vlerëson konstatimin tuaj dhe do të zbatojë rekomandimin e lënë, me qëllim që verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve të kryhet në përputhje me nenin 17 pika 1 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar. Përmendim se afati prej jo më pak se një herë në tre muaj për verifikimin në vend i ligjshmërisë së akteve ka filluar të përmirësohet prej 6-mujori të dytë të vitit 2023. Për vitin 2024 ky proces është bërë një herë në tre muaj, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Për sa trajtuar në observacion ju bëjme me dije se problematika e konstatuar nga grupi i auditimit i përket viteve 2022-2023, dhe vitit 2024 që shpreheni Ju. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

4. Pretendimi i subjektit: Organi Këshillues i Prefektit (Projekt Raporti i Auditimit/faqja nr.8 e Akt-Konstatimit nr. 1). Në lidhje me këtë konstatim, institucioni i Prefektit do të vlerësojë rekomandimin e lënë, me qëllim formalizimin me urdhër dhe funksionimin e organit këshillues sipas përcaktimeve të nenit 23 të Ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e Qarkut”, të ndryshuar. Sa më sipër, shohim të arsyeshme të sqarojmë se, Prefekti i Qarkut gjatë takimeve të zhvilluara (task-forca, komitete, komisione e takime të tjera tematike apo ato të deleguara nga pushteti qëndror) ka mbledhur të gjithë drejtuesit e degëve

territoriale në qark, drejtuesit e Drejtorisë Vendore të Policisë në Qark, përfaqësues të OJF si dhe përfaqësues nga shoqëria civile, ku gjithmonë përveç tematikës së takimit, janë diskutuar edhe probleme që lidhen me funksionimin e strukturave të administratës shtetërore e vendore në qark si dhe ato që kanë të bëjnë me fushën e përgjegjësisë së Prefektit të Qarkut, në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të punës. Këto takime ndodhen të dokumentuara në format elektronik dhe procesverbale shkresore pranë institucionit tonë. Por pa dyshim, konstatimin tuaj do ta vlerësojmë për të formalizuar Organin Këshillues pranë Prefektit të Qarkut.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Për sa trajtuar në observacion nga ana Juaj konfirmohet problematika e konstatuar nga grupi i auditimit, në lidhje me mos marrjen e masave për ngritjen e Organit Këshillues pranë Prefektit të Qarkut. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

5. Pretendimi i subjektit: Ndjekja e procedurave ligjore, pas kthimit të aktit nga institucioni i Prefektit dhe lënies në fuqi të akteve nga këshillat e NJVV-ve në qark. (Projekt Raporti i Auditimit/fleta nr. 9-nr. 11 e Akt-Konstatimit nr. 1). Në lidhje me 3 rastet e përmendura Projekt Raport dhe në Akt Konstatim, që i përkasin Bashkisë Korçë, Kolonjë dhe Pogradec, mbi lëninën në fuqi nga këshillat bashkiakë të akteve të kthyera, institucioni do të vlerësojë menjëherë rekomandimin e lënë me qëllim që për rastet në vijim, të ndjekë plotësisht procedurat ligjore sipas përcaktimit të nenit 16 të Ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e Qarkut”, të ndryshuar.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Për sa trajtuar në observacion nga ana Juaj konfirmohet problematika e konstatuar nga grupi i auditimit, në lidhje me mos marrjen e masave për ndjekjen e rrugëve ligjore në rastet e mos shqyrtimit të akteve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Prefektura e Qarkut Korçë është paraqitur observacioni me shkresën nr. 343/17 prot., datë 10.09.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 563/7 prot., datë 13.09.2024, nga z. N. J Prefekt i Qarkut Korçë dhe Grupi i Punës znj. O. B, z. D. K, z. Z. B, znj. L. B, znj. S. M, znj. A. S, znj. M. Z, znj. F. R dhe z. L. M ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konkluzionet e dërguara në Projekt Raport, të cilat lidhen me konstatimin e mbajtur nga audituesit (faqe nr. 1-7 të akt-konstatimit nr. 2) lidhur me përcaktimin e natyrës juridike të akteve (akt administrativ Normativ, Kolektiv dhe Individual) të miratuara nga Këshillat e Bashkive Korçë; Pogradec; Maliq; Devoll; Kolonjë; Pustec dhe Këshilli i Qarkut Korçë, me qëllim verifikimin e bazueshmërisë ligjiore të tyre, institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, Sektori Juridik, në vazhdimësi ka kërkuar nga Bashkitë e Qarkut që për secilin akt të miratuar, Drejtoria Juridike në bashki në bashkëpunim me Sekretarin e Këshillit bashkiak, të përcaktojnë natyrën juridike të aktit si detyrim ligjor. Ky proces pune (përcaktimi i karakterit juridik të aktit) është detyrim i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (Drejtorive juridike dhe sekretarëve të këshillave bashkiakë). Nga institucioni i Prefektit në takimet e zhvilluara me Kryetarët dhe Sekretarët e Këshillave Bashkiake si dhe shkresave drejtuar bashkive dhe këshillave bashkiake, i’u është tërhequr vëmendje për detyrimin ligjor që bashkitë kanë për respektimin e nenit 8 gërma “a” dhe 16 pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e Qarkut” të ndryshuar. Ky detyrim është realizuar vetëm nga Bashkia Devoll (nëpërmjet relacionit të posaçëm nga Drejtoria e juridike e kësaj bashkie mbi përcaktimin e natyrës juridike të akteve). Ndërsa 5 bashkitë e tjera dhe Këshilli i Qarkut Korçë, megjithë instistimin tonë, nuk kanë përcaktuar dhe relatuar mbi natyrën juridike të akteve të miratuara. Institucioni i Prefektit të Qarkut, gjatë punës për verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ, ka bërë ndarjen e akteve në përputhje me nenin 3 të Kodit të Procedurave Administrative, duke konfirmuar vetëm aktet e këshillave të cilat i ka konsideruar, si akte administrative me karakter normativ. Këtu përmendim se aktet e Këshillave Bashkiake, janë akte administrative të një natyre të veçantë, ku brenda objektit të aktit në shumë raste konstatohet se përmbajtja e tij ka natyrë normative, kolektive dhe individuale. Pikërisht është ky interpretim që në disa raste sjell vështirësi në përcaktimin e karakterit administrativ të aktit nga institucioni ynë. Për këto raste, me qëllim verifikimin e ligjshmërisë kemi konkluduar që akti të futet në kompetencën e Prefektit për

verifikimin e ligjshmërisë së tij. Sa më sipër, vlerësojmë se verifikimi i ligjshmërisë së këtyre akteve, jo vetëm që nuk pengon procesin e punës dhe zbatueshmërinë e tyre nga NJVV-të apo subjektet që përfshihen për zbatim, por nëpërmjet argumentave të dhëna e të bazuara në ligj nga ana jonë, kemi sugjeruar dhe orientuar NJVV-të, për zbatim korrekt të tyre. Theksojmë se në çdo rast nga institucioni është parë me përparësi forma, qëllimi i nxjerrjes së aktit dhe përmbajtja e dispozitave konkrete të tij, duke përbushur kërkesat e nenit 98 dhe 99 të Kodi i Procedurës Administrative, si dhe Udhëzimit të Ministrisë të Drejtësisë nr. 6, datë 29.04.2022, “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Problematika e konstatuar nga grupi i auditimit ka të bëjë jo vetëm me administrimin e akteve me karakter jo normativ të depozituara nga bashkitë pranë Prefekturës së Qarkut Korçë, por edhe me trajtimin e akteve e karakter jo normativ si akte me karakter normativ. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

2. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket verifikimit të ligjshmërisë së akteve dhe dokumentacionit që duhet të depozitohen bashkëlidhur (faqe 6 e akt-konstatimit), ku i referoheni urdhërit nr. 175, datë 09.07.2020, të Ministrisë të Brendshme dhe Aneksit nr. 1, të Rregullores së Brendshme për organizimin dhe Funksionimin e institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë neni 4 gërma “b”, sipas së cilit akti i NJVV, që depozitohet pranë Prefektit të Qarkut, duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme si, procesverbalet e mbledhjeve, procesverbalet e dëgjësive publike, relacionet e akteve, projektvendime, çertifikata pronësie, pasqyrat financiare dhe dokumentacion për emergjencat civile, shohim me vend të argumentojmë sipas arsytimit të bërë në shpjegimet e dhëna për atë pjesë të Projekt Raportit që lidhet me Akt Konstatimin nr.1, me të njëjtin objekt.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Së pari: Ju si institucion bini ndesh me pretendimet që keni paraqitur në observacion për arsye se në rastin e parë i referoheni disa bazave ligjore në lidhje me problematikën e konstatuar nga grupi i auditimit dhe në përfundim citoni se Ne do të angazhohemi ta përbushim si Rekomandim.

Së dyti: Për sa i përket nenit 118 të Kushtetutës ju bëjmë me dijeni se, Urdhri i Ministrisë të Brendshme i referohet ligjit të Prefektit për më tepër në nenin 102 të Kushtetutës, Ministri i Linjës ka të drejtë të nxjerri urdhra, udhëzime për zbatim për njësitë e varësisë. Në rastin konkret urdhri i Ministrisë është akt i detyrueshëm për zbatim nga Prefektura.

Së treti: Për sa i përket procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillave Bashkiak ju bëjmë me dijeni se, në asnjë rast grupi i auditimit nuk është shprehur që bashkitë nuk e disponojnë si dokument, por që bashkëlidhur praktikës nuk ndodhet ky dokumentacion dhe në kushte të tilla Prefekti i Qarkut Korçë ka dhënë konfirmimin e bazueshmërisë ligjore mbi aktin në mungesë të dokumentacionit përkatës.

Së katërti: Në observacion janë paraqitur disa procesverbale mbledhjesh të Këshillave Bashkiak të cilat nuk kanë qenë të bashkëlidhur praktikës mbi të cilën ka shprehur konfirmimin mbi bazueshmërinë Prefekti.

Së pesti: Ligji për Prefektin i vitit 2024, nuk përfshin periudhën objekt auditimi. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

3. Pretendimi i subjektit: Verifikimi në vendi akteve të vetëqeverisjes vendore (Projekt Raporti i Auditimit, / faqe nr. 6-nr. 7 e Akt-Konstatimit nr. 2). Në lidhje me këtë konstatim, institucioni i Prefektit do të vlerësojë menjëherë rekomandimin e lënë, me qëllim që verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve të kryhet në përputhje me nenin 17 pika 1 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar. Përmendim se afati prej jo më pak se një herë në 3 muaj për verifikimin në vend i ligjshmërisë së akteve ka filluar të përmirësohet prej 6-mujori të dytë të vitit 2023, ndërsa për vitin 2024 ky proces është realizuar një herë në 3 muaj, në përputhje me përcaktimet e ligjit. I gjithë procesi i verifikimit në vend të akteve për periudhën objekt auditimi (2022-2023) është realizuar 100%.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa trajtuar në observacion ju bëjme me dije se problematika e konstatuar nga grupi i auditimit i përket viteve 2022-2023, dhe vitit 2024 që shpreheni Ju. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

4. Pretendimi i subjektit: Organi Këshillues i Prefektit (Projekt Raporti i Auditimit/fleta nr. 7 e Akt-Konstatimit nr. 2). Në lidhje me këtë konstatim, institucioni i Prefektit do të vlerësojë menjëherë rekomandimin e lënë, me qëllim formalizimin me urdhër dhe funksionimin e organit këshillues sipas përcaktimeve të nenit 23 të Ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e Qarkut”, të ndryshuar. Ashtu si kemi shpjeguar dhe më parë, sqarojmë se Prefekti i Qarkut gjatë takimeve të zhvilluara (task-forca, komitete, komisione e takime të tjera tematike apo ato të deleguara nga pushteti qendror) ka mbledhur të gjithë drejtuesit e degëve territoriale në qark, drejtuesit e Drejtorisë Vendore të Policisë në Qark, përfaqësues të OJF si dhe përfaqësues nga shoqëria civile, ku gjithmonë përveç tematikës së takimit, janë diskutuar edhe probleme që lidhen me funksionimin e strukturave të administratës shtetërore e vendore në qark si dhe ato që kanë të bëjnë me fushën e përgjegjësisë së Prefektit të Qarkut, në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të punës. Këto takime ndodhen të dokumentuara në format elektronik dhe procesverbale shkresore pranë institucionit tonë. Pa dyshim, konstatimin tuaj do ta vlerësojmë për të formalizuar Organin Këshillues pranë Prefektit të Qarkut.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa trajtuar në observacion nga ana Juaj konfirmohet problematika e konstatuar nga grupi i auditimit, në lidhje me mos marrjen e masave për ngritjen e Organit Këshillues pranë Prefektit të Qarkut. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

5. Pretendimi i subjektit: Ndjekja e procedurave ligjore, pas kthimit të aktit nga institucioni i Prefektit dhe lënies në fuqi të akteve nga këshillat e NJVV-ve në qark. (Projekt Raporti i Auditimit/façe nr. 9- e Akt-Konstatimit nr. 2). Në lidhje me 1 rast të përmendur në Projekt Raport dhe në Akt Konstatim, që i përket Bashkisë Kolonjë, lidhur me lëninën në fuqi nga këshillat bashkiakë të akteve të kthyer, institucioni do të vlerësojë menjëherë rekomandimin e lënë me qëllim që për rastet në vijim, të ndjekë procedurat ligjore sipas përcaktimit të nenit 16 të ligjit 107/2016, “Për prefektin e Qarkut”, të ndryshuar. Nga auditimi konstatohet se vendimi nr. 76 i Këshillit të Bashkisë Pogradec i datës 26.07.2023, “Për dhënien e ndihmës financiare z. Sh. B, për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë”, ka parregullsi në përlllogaritjen e preventivit të orientive lidhur me referencat e çmimeve të evidentuara, konkretisht për zërin “Kolltuk tresh” çmimi për njësi është 3000 lekë ndërsa në preventive është vlerësuar 45.000 lekë. Sipas konstatimit të audituesve duhej që institucioni i Prefektit ta kthente për rishqyrtim vendimin e Këshillit Bashkiak Pogradec, për arsye të mos rakordimit të vlerës, njësi/çmim. Argumentimi: Konstatimi për VKB-në nr. 76, rezulton një “Lapsus/ gabim njerëzor, lidhur me vlerën për njësi”. Nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në zërin “Divane/kolltukë” rezulton një listë prej 21 artikuj bazuar në mesataren e çmimeve me vlera minimale 9.304 lekë dhe vlerë maksimale 387.485 lekë për njësi. Bazuar në lista e DPT nuk ka asnjë artikull me zërin “Kolltuk tresh” me vlerë 3000 lekë. Për këtë arsye dhe ndodhur në kushtet ku në preventiv është përcaktuar vlera 45.000 lekë, vlera rezulton brenda kufijve të përcaktuar nga DPT. Kjo vlerë është përcaktuar si e tillë në sajë të konstatimit/vlerësimit të komisionit të vlerësimit të ngritur nga bashkia Pogradec. Ndaj vlerësojmë se ky fakt nuk duhet të përbëjë argument për mos konfirmimin e bazueshmërisë ligjore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit i referohet preventivit të certifikuar nga grupi i punës. Për më tepër e njëjta situatë është konstatuar edhe në rastin e një emergjence civile për të cilën Prefektuara e ka kthyer për rishqyrtim preventivin (pra ka analizuar me detajë çdo zë të preventivit) ndërkohë që për problematikën e konstatuar në vendimin nr. 76, e konsideron lapsus. Në kushte të tilla nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë nuk janë marrë masat e duhura për të ndjekur të gjitha hapat ligjore dhe administrative të përcaktuar në ligjin e Prefektit. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

6. Pretendimi i subjektit: Vendime të Konstatuara (Projekt Raporti i Auditimit / façe nr. 14-nr. 16 e Akt-Konstatimit nr. 2).

a. Në lidhje me konstatimin tuaj se vendimi nr. 31, datë 23.03.2023, i Këshillit të Bashkisë Pogradec, me objekt: “Miratimin e listës së fondit kullor, që mund të jepen me qira, për kullotje dhe kositje bari, me sipërfaqe prej 1512.75 Ha, në ekonomitë kullorë “Golik-Kalivaç, “Vërrri-Debrovë, “Pretushë-Lin, “Guri Top-Gjemth”, “Dunicë-Llëngë” dhe “Niçë-Valamarë” dhe kontratës Tip, nuk duhej të konfirmohej por të ishte kthyer nga Prefekti i Qarkut si i pambështetur në ligj, pasi mungojnë (çertifikatat e pronësisë dhe plan-vendosjet e pronës) shpjegojmë se: Vendimi nr. 31, datë 23.03.2023, është konfirmuar nga institucioni i Prefektit, pasi ky akt është gjetur në bazuar në përcaktimet e nenit 3 pika 2 dhe nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë; në pikën 2 të nenit 16 të Ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e Qarkut” të ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar; si dhe Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë nr. 6, datë 29.04.2022, “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”. Nga përmbajtja dhe objekti i aktit, rezulton se Këshilli i Bashkisë Pogradec është bazuar në nenin 15 të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për fondin Kullor” të ndryshuar; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish-komunave/bashkive” të ndryshuar; në udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016, “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”, si dhe nenin 9 pka 1.2 “E drejta dhe përgjegjësia e pronësisë” dhe nenin 54 gërma “e/1” të Ligjit nr. 139/2015, ku sipas këtyre dispozitave:

-Gërma “a”, njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

-Gërma “c”, e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t’ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër.

-Gërma “e/1”, këshilli miraton dhënien në përdorim të pronave të tretëve ose dhënien për zhvillim të pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private.

Sa më sipër, konstatohet qartë fakti se Këshilli i Bashkisë Pogradec, në zbatim të referencës ligjore të përmendur mësipër, nëpërmjet Vendimit nr. 31, datë 21.03.2023, ka shprehur vullnetin e tij në parim duke dhënë pëlqimin për sipërfaqe nga fondi kullor, të cilat mund të jepen me qira si dhe ka miratuar kontratën tip, që do të lidhet midis bashkisë dhe subjektit/subjekteve fitues që do të dalin nga procedura e konkurimit. Miratimi në parim i këtij akti vërtetohet edhe në pikën 3 të tij, nëpërmjet të cilës këshilli sankionon se.. “Për vazhdimin e procedurave të parashikuara në udhëzimin nr. 2/2016, të Ministrit të Mjedisit”, ngarkohet struktura përgjegjëse në bashki..”

Po ashtu, sipërfaqja e fondit kullor, objekt i Vendimit të KB Pogradec nr. 31, datë 21.03.2023, i është transferuar Bashkisë Pogradec me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish-komunave/bashkive” të ndryshuar. Ky akt nënligjor në pikën 40 të tij përcakton se sipërfaqet pyjore dhe kullorë, sipas listës së inventarit, që transferohen në pronësi të Bashkisë Pogradec, janë sipas shtojcës 38, bashkëlidhur këtij vendimi. Kjo shtojcë përmban listën e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 909 (nëntëqind e nëntë), ndërsa karakteri detyrues i aktit nënligjor nr. 433/2016 i ndryshuar, jepet në pikën 66 dhe 70, të cilat ngarkojnë kryetarët e bashkive për regjistrimin e sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullor publik, të transferuara në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sipas legjislacionit në fuqi si dhe detyrimin e Ministri i Mjedisit, kryetarët e bashkive dhe Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar pretendimeve të paraqitura në observacion janë të pa bazuara ligjërisht për arsyen se nuk disponohet së paku plani i vendosjes në zbatim të Urdhrit nr. 175, datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe Aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

7. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit dhe konstatimin tuaj se konfirmimi i bazueshmërisë ligjore të vendimit nr. 17, datë 25.01.2023, i Këshillit të Bashkisë Korçë, me objekt “Për fillimin e procedurave të dhënies me qira të ambientit me sipërfaqe 98 m², të ndodhur në pallati i sportit “Tamara Nikolla”, pjesë e pasurisë nr. 1/12 ZK 8561, sipas Genplanit bashkëngjitur” është i pa bazuar në ligj, me arsyetimin se sipas këshillit të Bashkisë Korçë... “Miratimi i dhënies me qira e sipërfaqes prej 98 m² do të jetë për një afat **deri në 10 vjet**, kur ndërkohë sipas përcaktimit të pikës 6 gërmat “a” dhe “i” të kreut I të VKM-së nr. 54/2014, objektet në administrim të institucioneve shtetërore, me sipërfaqe deri në 200 m² (ku të jetë përfshirë dhe sipërfaqja funksionale) jepen me qira për një afat deri në 1 (një) vit. Sa më sipër, gjatë verifikimit ligjor të aktit (Vendim i KB Korçë nr. 17, datë 25.01.2023,) institucioni i Prefektit ka marrë në konsideratë se: Së pari, kjo pasuri është në pronësi dhe jo në administrim të Bashkisë Korçë dhe referuar nenit 9 pka 1.2 dhe 54 gërma “e/1” të Ligjit nr.139/2015, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë kompetencë të plotë në lidhje me ushtrimin e të drejtës së pronësisë. Sipas kësaj dispozite, ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Gjithashtu kjo pasuri i është transferuar bashkisë Korçë nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1532, datë 19.11.2008, “Për miratimin e listës përfundimtarë të pronave të paluajtshme publike është shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Korçë” të ndryshuar. Së dyti, sipërfaqja prej 98 m², e miratuar për tu dhënë në përdorim me afat deri në 10 vjet, referuar relacionit bashkëlidhur aktit, rezulton se do i nënshtrohet procedurave të konkurimit për dhënien me qira të saj, ku në pikën 2 të vendimit përcaktohet, “Miratimi i dhënies me qira të objektit të sipërcituar me vlerë jo më të vogël se 510.2 lekë m², dhe për një afat deri në 10 vjet”. Së treti, institucioni i Prefektit të Qarkut, gjatë procesit të vlerësimit ligjor të këtij akti dhe akteve të tjera të ngjashme, i ka kushtuar rëndësi procedurave për zhvillimin e konkurimit publik, të cilat lidhen me dhënien e pëlqimit paraprak apo miratimin që bëjnë këshillat bashkiakë për dhënien me qira të objekteve dhe sipërfaqeve në pronësi të bashkive. E shohim me vend të sqarojmë se institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, nuk do të konfirmonte bazueshmërinë ligjore të këtij akti nëse Këshilli i Bashkisë Korçë do të jepte sipërfaqen e objektit prej 98 m² me afat deri në 10 vjet, pa konkurim publik, pasi nëpërmjet zhvillimit të procedurave të konkurimit do i hapej rrugë jo një, por disa subjekteve të cilët me ofertat e tyre do të ngrinin vlerën minimale për m², që ka përcaktuar bashkia sipas vendimit nr. 54/2014, të ndryshuar, dhe udhëzimit në zbatim të saj (referoju Buletinit të APP- së nr. 14, datë 12.02.2023, faqe 565-566).

Oëndrimi i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër problematika e ngritur nga grupi i auditimit, nuk ka të bëjë me statusin e pronës por për miratimin e dhënies së sipërfaqes prej 98 m² me qira për një afat 10 vjeçar ndërkohë që VKM nr. 54/2014, për sipërfaqet deri në 200 m² jepen me qira me afat 1 vjeçar. Afati i dhënies me qira është elementi më i rëndësishëm për arsye se, favorizon apo disfavorizon subjektin për privatizim të pronës shtetërore. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Prefektura e Qarkut Korçë është paraqitur observacioni me shkresën është paraqitur observacioni me shkresën nr. 3434/17 prot., datë 10.09.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 563/7 prot., datë 13.09.2024, nga z. N. J., Prefekt i Qarkut Korçë dhe Grupi i Punës znj. O. B, z. D. K, z. Z. B, z. L. B, znj. S. M, znj. A. S, znj. M. Z, znj. F. R, z. Gj. N, z. A. Xh dhe z. L. M, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit: Së pari sqarojmë se sa i përket konstatimeve tuaja, që lidhen me mungesën e depozitimit të procesverbalit të mbledhjeve, lutemi ti referoheni sqarimit të bërë nga institucioni i Prefektit në shpjegimet dhe komentet që kanë të bëjnë me gjetjet dhe komentet e Projekt Raportit, (akt-konstatimi nr. 1.). Sipas përcaktimeve të rregullores së funksionimit të këshillit bashkiak, sekretari dhe kryetari i këshillit, fut për miratim procesverbalin e mbledhjes së kaluar në mbledhjen pasardhëse të këshillit bashkiak etj.) Ky procesverbal pasi u është vënë më parë në dispozicion të gjithë këshilltarëve, shqyrtohet në mbledhjen e këshillit bashkiak dhe miratohet me shumicën e votave sipas nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar) etj. Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit tuaj (fleta nr. 3-5, pika 2), i cili i referohet Vendimit nr. 105, datë 30.06.2022, të Këshillit të Bashkisë Korçë, me objekt: për një ndryshim në VKB Korçë nr. 137, datë 25.11.2021, “Për

nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2022”, citoni se:

- “Duke u bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, Bashkia Korçë ka kryer një ndryshim në paketën fiskale të miratuar me VKB Korçë nr. 105, datë 30.06.2022, duke aplikuar një tarifë nga 200,000 lekë në 20,000 lekë, në rastet e zëvendësimit të liçencës bazë 5-vjeçare për diferencën e periudhës kohore të papërfunduar, të pabazuar në ligj”.

- “Për më tepër që ulja e nivelit të taksave dhe tarifave vendore nuk mund të kryhet në vitin e fundit të mandatit të kryetarit të bashkisë, parashikuar në Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar.

a. Sa më sipër, institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, shpjegon se kjo gjetje nuk qëndron pasi referuar pikës 1 të VKB Korçë nr.105/2022 citon.. “Në rast të zëvendësimit të liçencës bazë 5-vjeçare që ka si qëllim, ndryshimin e elementëve të përdoruesit të stacionit të pajisur me liçencën bazë, tarifa do të jetë 20,000 lekë për çdo rast zëvendësimi për diferencën e periudhës kohore të papërfunduar”.

b. Referuar arsyetimit të dhënë në relacionin e Bashkisë Korçë, citohet se: “Në disa raste të konstatuara në stacionet e tregëtimit me pakicë të hidrokarbureve të cilat kanë dalë nga tregu dhe këto janë zëvendësuar me subjekte të tjera duhet të pajisen me zëvendësimin e elementëve të liçencës bazë me afat 5-vjeçar të tregëtimit me pakicë të hidrokarbureve në konsumatorët fundorë”. Tarifa për këtë dublikat liçence e përcaktuar në VKB Korçë nr. 137, datë 25.11.2021, kapitulli III, faqe.nr. 20, paragrafi shënim është 20% e vlerës së plotë të 1,000,000 lekë, e cila përlllogaritet në vlerën 20,000 lekë, vlerë e cila po të vlerësohet në logjikën ekonomike rëndon situatën e operatorëve ekonomike pasi duhet të paguhej e njëjta vlerë, si në rastin kur zëvendësimi mund të bëhet vitin e parë apo të dytë të liçencës, ashtu edhe në vitin apo muajin e fundit të vlefshmërisë së saj”.

Ndryshimi i elementëve të përdoruesit të stacionit përfshin rastet e mëposhtme:

- Ndryshim i emrit të subjektit shpk.
- Ndryshimin e numrit unik të identifikimit të subjektit të regjistruar në QKB.

Sa më sipër konkludojmë se nuk jemi para rastit që ju arsyetoni dhe përkon me uljen e tarifës nga 200,000 lekë në 20,000 për zëvendësimin e liçencës, por para atyre rasteve që përkojnë me zëvendësim të elementëve të përdoruesit të stacionit, (Ndryshim i emrit të subjektit Shpk.; Ndryshimin e numrit unik të identifikimit të subjektit të regjistruar në QKB), dhe kjo për arsye të daljes nga tregu i tregëtimit me pakicë të hidrokarbureve në konsumatorët fundorë, për subjektet që zhvillojnë aktivitetin në territorin e bashkisë Korçë, për çdo rast zëvendësimi për diferencën e periudhës kohore të papërfunduar. Në këtë rast Bashkia Korçë, në gjykimin tonë, me të drejtë ka vlerësuar të mbrojë subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tregëtimit me pakicë të hidrokarbureve në konsumatorët fundorë, duke bërë bazuar në kompetencat që ka edhe rregullimin ligjor të VKB Korçë nr. 137, datë 25.11.2021.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket pretendimeve të evidentuara në observacion nga ana Juaj në lidhje me paligjshmërinë e VKB Korçë me nr. 105, datë 30.06.2022, ju bëjmë me dije se:

Grupi i auditimit e ka analizuar me kujdes relacionin, konkretisht pretendimet të cilat janë ngritur nga Bashkia Korçë se do të aplikohet një tarifë nga 200,000 lekë në 20,000 lekë duke marrë në konsideratë faktin që për një periudhë kohe të shkurtër janë mbyllur disa aktivitete që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre për arsye të falimentimit të tyre edhe pse në relacion nuk evidentohet asnjë rast në të cilën këto lloj subjektesh kanë mbyllur aktivitetin. Në aktkonstatim është evidentuar e gjithë përmbajta e relacionit mandje në mënyrë të detajuar. Në arsyetim e grupit të auditimit konsiderohet ulje tarife nga 200,000 lekë në 20,000 lekë në momentin e ndryshimit të emrit të subjektit në momentin e kalimit të pronësisë nga një operator ekonomik tek tjetri. Për më miratimi për ndryshimin e kësaj tarife (ulja e tarifës) është kryer në vitin e fundit të Kryetarit të Bashkisë Korçë, veprim i cili bie në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 5, gërma “d”, ku përcaktohet që: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk mund të ulin nivelin e taksave apo të tarifave vendore në buxhetin e vitit të fundit të mandatit të tyre, me përjashtim të rasteve kur ekziston një plan i detajuar ndër vite, i cili është miratuar nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore”. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

2. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit tuaj (faqe nr. 7-8, pika 4), i cili i referohet Vendimit nr. 120, datë 29.07.2022, të Këshillit të Bashkisë Korçë, me objekt: “Ndryshimi i kuotës ushqimore të fëmijëve të çerdheve dhe kopshteve me ushqim në qytetin e Korçës” nga 125 lekë në ditë në 150 lekë në ditë, dhe nga 2,750 lekë në 3,300 lekë, citoni se: “Duke u bazuar në vendimin e sipërpërmendur Bashkia Korçë, ndryshimin e kuotës ushqimore e ka aplikuar për fëmijët të çerdheve dhe kopshteve për grup moshën **0 deri në 6 vjeç**, ndërkohë referuar urdhërit nr. 76/1, datë 24.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç, pikat 1-3, ky ndryshim përfshin grup moshën nga 1 deri në 6 vjeç”.

a. Sa më sipër, institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, argumenton se kjo gjetje nuk qëndron, pasi ndryshimi i kuotës ushqimore të aplikuar për fëmijët e çerdheve dhe kopshteve për grup moshën 0 deri në 6 vjeç, referuar Vendimit nr. 120, datë 29.07.2022, të Këshillit të Bashkisë Korçë, mbështetet në urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 76/1, prot datë 24.01.2018, “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç” të ndryshuar, pika 10 e tij dhe shtojcat respektive, pjesë përbërëse të urdhërit, si dhe në shkresën nr. 3242/4, datë 19.06.2018 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, drejtuar të gjitha Bashkive në Republikën e Shqipërisë, Pika 5 e në vijim., ku përfshihen:

Menu për çerdhe fëmijët 1-3 vjeç, verë - dimër;

Menu për kopshte për fëmijët 3-6 vjeç, verë dimër;

Menu 5 ditore për fëmijët 1-3 vjeç në çerdhe, dimër-verë

Menu 5 ditore për fëmijët 3-6 vjeç në çerdhe, dimër-verë

Menu 5 ditore për fëmijët në çerdhe, foshnjët 6-8 muaj, pranverë-verë;

Menu 5 ditore për fëmijët në çerdhe, foshnjët 6-8 muaj, vjeshtë-dimër;

Menu 5 ditore për fëmijët në çerdhe, foshnjët 8-10 muaj vjeshtë-dimër;

Menu 5 ditore për fëmijët në çerdhe, foshnjët 8-10 muaj vjeshtë-dimër;

Menu 5 ditore për fëmijët në çerdhe foshnjët 10-12 muaj, pranverë-verë;

Menu 5 ditore për fëmijët në çerdhe, foshnjët 10-12 muaj, vjeshtë-dimër

<https://shendetesia.gov.al/shendeti-i-nenes-dhe-femijes/>

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit i referohet vendimarrje së Këshillit Bashkiak Korçë nr. 120, datë 29.07.2022, në të cilën citohet se: “... Në zbatim të Urdhrit nr. 457, datë 13.06.2018, “Për një ndryshim të Urdhrit nr. 76/1, datë 24.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të Çerdheve dhe Kopshteve për fëmijë nga 0-6 vjeç.....”, pra nuk i referohet shkresës me nr. 3242/4 prot., datë 19.06.2018. Në Urdhrit nr. 76/1, datë 24.01.2018, përfshihet grup moshë nga 1-6 vjeç ndërsa nga Bashkia Korçë është përfshirë grup moshë nga 0-6 vjeç. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

3. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit tuaj, për Vendimin nr. 122, datë 29.07.2022, të Këshillit të Bashkisë Korçë, me objekt: “Miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij në Bashkinë e Korçës”, ku arsyetoni se pika 2 e nenit 10 të Ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, përcakton se: “Këshilli vendor i rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë..”, institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të tij, duke arsyetuar se:

a. Për konstatimin si të ligjshëm të këtij akti është marrë në konsideratë edhe fakti se ky akt nuk krijon efekte financiare për arsye të numrit të anëtarëve të këshillit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit i referohet dispozitës ligjore konkretisht nenit 10, pika 2, e Ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, ku Këshilli Vendor duhet të jetë maksimalisht me 6 anëtarë dhe jo me 10, sipas Vendimit nr. 122, datë 29.07.2022. Gjithashtu sjellim në vëmendje që në asnjë rast nuk jemi shprehur se është krijuar efekt financiar. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

4. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit mbi miratimin e ndihmave financiare në raste fatkeqësish, sqarojmë në mënyrë të përmbledhur si vijon: Në

vendimin nr. 329, datë 16.05.2012, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, kapitulli III, “Procedura në rastet kur nuk shpallet gjendja e emergjencës civile”, në pikën 1, “Procedura e vlerësimit të dëmeve” saktësohet radha e punës dhe veprimet që ndërmerren nga bashkia ku ka ndodhur fatkeqësia që nga momenti i njoftimit, ngritja e grupeve të punës, kërkesa deri në konstatimin e gjendjes, etj të cilat nuk janë detyrimet tona, ndërsa në pikën 2, përcaktohet “Dokumentacioni i nevojshëm, për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare” për familjet që pësojnë fatkeqësi të ndryshme. Në këtë pikë nuk përcaktohet dhe kërkohet si dokument kërkesa e personit për ndihmë për fatkeqësinë e ndodhur pasi e gjithë procedura që ndërmerret nga bashkia për ti ardhur në ndihmë fillon mbi bazën e kërkesës që shtetasi ka bërë dhe të informacionit të marrë mbi zjarrit e rënë apo ngjarjen që ka ndodhur. Për rrjedhojë, ky dokument është pjesë e shqyrtimit nga ana e bashkisë respektive dhe në të gjitha rastet administrohet dhe ruhet nga ana e tyre. Gjetje të kësaj natyre rezultojnë edhe në (Akt-Konstatimet e tjera) Vendimin nr. 143, datë 26.10.2023, të Këshillit Bashkiak Korçë me objekt “Mbi miratimin e ndihmës financiare z. L. Xh, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e tij”, Vendimin nr. 144, datë 26.10.2023, të Këshillit Bashkiak Korçë me objekt “Mbi miratimin e ndihmës financiare z. T. S, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e tij”, në Vendimin nr. 116, datë 31.08.2023, të Këshillit Bashkiak Korçë me objekt “Mbi miratimin e ndihmës financiare zonjës Z. I, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e saj”, në Vendimin nr. 84, datë 20.12.2022, të Këshillit Bashkiak Devoll “Për akordimin e ndihmës financiare familjes së z. J. D për dëmtimin e banesës nga rënia e zjarrit”, në Vendimin nr. 73, datë 27.07.2023, të Këshillit Bashkiak Pogradec “Për dhënien e ndihmës financiare znj.Sh. J, për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë”, si dhe në në Vendimin nr. 39, datë 29.04.2022, të Këshillit Bashkiak Maliq “Për dhënien e ndihmës financiare z. F. Ll, për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e tij”, mungesa e kërkesës së personit, certifikatës familjare në momentin e ndodhjes së ngjarjes, procesverbali i konstatimit të gjendjes dhe dokumenti i MZSH-së, të cilat mund të jenë kërkuar për të na i sjellë (plotësim) bashkive por nuk është mundur një gjë e tillë. Në të gjitha bashkitë janë hartuar urdhërat e kryetarit të bashkisë për ngritjen e Komisionit të Konstatimit të Gjendjes dhe Urdhëri për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara, dokumente të cilat rifreskohen kur ka ndryshime dhe lëvizje të anëtarëve të komisionit të cilat ruhen dhe administrohen në çdo bashki, theksojmë faktin që këto dokumente nuk janë pjesë e dokumenteve që dërgohen në Prefekturë, ose nga ana formale do të ishte një fotokopje bashkëlidhur dosjes. Gjetje të cilat ju i keni konstatuar në Vendimin nr. 143, datë 26.10.2023, të Këshillit bashkiak Korçë me objekt “Mbi miratimin e ndihmës financiare z. L. Xh, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e tij” dhe në Vendimin nr.116, datë 31.08.2023, të Këshillit Bashkiak Korçë me objekt “Mbi miratimin e ndihmës financiare zonjës Z. I, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e saj”. Në lidhje me Vendimin nr. 3, datë 28.01.2022, të Këshillit të Bashkisë Maliq për rakordimin e ndihmës financiare për familjen e z.I. G. për dëmet e shkaktuara në magazinën e tij, me shkresën tonë nr. 129/2 prot., datë 15.02.2022, nuk është konfirmuar bazueshmëria ligjore e këtij vendimi, pasi nuk i përgjigjet objektit bazuar në VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012, (Për kriteret dhe procedurat për dhënien e ndihmës shtetore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Së pari referuar Urdhrit nr. 175, datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe Aneksi I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, neni 4, pika 1, citohet se: “Dokumentacioni përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimarrjes për emergjencat civile etj.)”, pra i referohet edhe kërkesave të dispozitave ligjore për emergjencat civile. Për shpërblimin e personave përkatës në rastin e fatkeqësive natyrore aplikohet VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, së bashku me dokumentacionin përkatës. Së dyti në asnjë rast grupi i auditimit nuk shprehet që bashkitë përkatëse sipas rasteve të konstatuara nuk e disponojnë këtë dokumentacion por evidentohet problematika që nga Prefektura e Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore duke

mos u shqyrtuar i gjithë dokumentacioni përkatës. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

5. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit tuaj (faqe nr.18, pika 10), i cili i referohet Vendimit nr. 8, datë 24.01.2023, të Këshillit të Bashkisë Kolonjë, me objekt: “Për shprehje dakortësie”, citoni se: “vendimi është depozituar në mungesë dokumentacioni si, a) mungesa e procesverbalit të mbledhjes dhe b). Relacioni përkatës që spjeron respektimin e procedurës ligjore, sipas shpjegimeve tona dhe arsytimit të dhënë më parë nuk qëndron, për arsye se:

a. Gjatë verifikimit të bazueshmërisë ligjore të aktit ka rezultuar se VKB Kolonjë nr. 8/2023, plotëson të gjithë elementët që përcaktojnë nenet 99-100 të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë dhe se ky akt ka të bëjë vetëm me autorizimin ligjor që këshilli bashkiak i jep organit ekzekutiv të bashkisë për ndjekjen e procedurave të mëtejshme sipas përcaktimve ligjore, ashtu si përmendet në pikën 2 të tij. Të gjitha procedurat që ju përmendni në pikën 8 të akt-konstatimit nr. 3, datë 06.07.2024, janë parashikuar të ndiqen nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Kolonjë, pas hyrjes në fuqi të VKB Kolonjë nr. 8/2023. Kompetenca që Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, i njuh këshillit të Bashkisë Kolonjë përcaktohet në mënyrë të qartë në nenin 9 pka 1.2 “E drejta dhe përgjegjësia e pronësisë” dhe nenin 54 gërma “e/1” të Ligjit nr. 139/2015, ku sipas këtyre dispozitave:

-Gërma “a”, njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj,

-Gërma “c”, e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t’ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër.

-Gërma “e/1”, këshilli miraton dhënien në përdorim të pronave të tretëve ose dhënien për zhvillim të pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private.

b. Institucioni i Prefektit të Qarkut gjatë procedurave të verifikimit të bazueshmërisë ligjore të aktit, në mungesë të relacionit, i është referuar dhe ka marrë në konsideratë arsyetimet e bëra me kërkesën e datës 19.01.2023, nga përfaqësuesi i Zyrës së FAO në Shqipëri, për krijimin e kushteve për ngritjen e një inkubatori agrobiznesi në qytetin e Leskovikut, Bashkia Kolonjë.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Në pikën 1, të Vendimit nga Këshilli Bashkiak është miratuar kërkesa për rikonstruksionin e katit të parë të konviktit, dhe jo dhënia e dakortësisë për miratimin e lejes rikonstruksionit. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

6. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit (faqe nr.20, pika 11), për Vendimin nr. 4, datë 24.01.2023, të Këshillit të Bashkisë Kolonjë, me objekt: “Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të bllok ndihmës ekonomike deri në 6%, për vitin 2023”, ku citoni se: vendimi nr. 4/2023, është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut në mungesë dokumentacioni, a) Procesverbali i mbledhjes; b) Relacioni përkatës që spjeron respektimin e procedurës ligjore; c) Dokumentacion mbështetës për dhënien e ndihmës familjare, konkretisht formularin për aplikimin për ndihmë ekonomike.

a. Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, pasi krahasoi objektin e vendimit nr. 4/2023, “Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar”, me konstatimet e grupit të auditimit lidhur me këtë akt. (Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore dhe dokumentacion mbështetës për dhënien e ndihmës familjare, konkretisht formularin për aplikimin për ndihmë ekonomike), konkludon se gjetja/konstatimi juaj nuk qëndron pasi ai lidhet me ato vendime të cilat nxirren çdo muaj nga këshillat bashkiakë për familje konkrete dhe objekt, “Dhënien e ndihmës ekonomike, nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar të

bllok-ndihmës ekonomike deri në 6%”, duke iu referuar një procedure tjetër, e cila aplikohet çdo muaj, referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 59/2019. Ndërsa rasti konkret ka të bëjë me një vendim të Këshillit të Bashkisë Kolonjë që nxirret një herë në çdo fillim viti dhe ka për objekt “Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të bllok ndihmës ekonomike deri në 6%, për vitin 2023”.

b. Në këtë rast shpjegojmë se Këshilli i Bashkisë Kolonjë, ka ushtruar drejt kompetencën e tij të dhënë me aktin nënligjor (vendim i Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar.

Paragrafi IV i VKM nr. 597/2019, “Përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, përcakton se:

-Këshilli bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

-Këshilli bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, duke përdorur fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

c. Gjithashtu për këtë rast ka rezultuar se, vendimi nr. 4/2023, i KB Kolonjë, gjendet i shoqëruar me relacion dhe projektvendim, të hartuar nga specialisti dhe drejtori i Shërbimit Social në Bashkinë Kolonjë, i cili mban nënshkrimin edhe të titullarit të bashkisë.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit i referohet mungesës së dokumentacionit konkretisht relacioni shpjegues si dhe formularëve të personave përfitues dokumentacion i cili është kusht për të përfituar ndihmën ekonomike. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

7. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit (faqe nr. 24-26, pika 13), për vendimin nr. 85, datë 30.11.2023, të Këshillit të Bashkisë Devoll, me objekt: “Dhënie miratimi, për dhënie me qira të sipërfaqes prej 27.6 ha, në ngastrën me nr. 160/b, në ekonominë pyjore Qafë Zvezdë-Trestenik”, ku citoni se: vendimi nr. 85/2023, është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut në mungesë dokumentacioni, a) Procesverbali i mbledhjes; b) Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqes në pronësi publike, të Bashkisë Devoll, sqarojmë si më poshtë: Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, pasi krahasoi vendimin nr. 85/2023, dhe dokumentacionin bashkëlidhur tij, ka konstatuar se, së bashku me aktet e këshillit bashkiak Devoll të miratuara në mbledhjen e datës 30.11.2023, është përcjellë edhe një kopje e procesverbalit të mbledhjes të mbajtur me shkrim nga Sekretari i Këshillit, (në tre faqe të cilin ua kemi dërguar bashkë me observacionin tonë). Sa i përket konstatimit se raportit-tekniko ekonomik, nuk ndodhet i administruar bashkëlidhur aktit nr.85/2023, sqarojmë se ky raport u gjend i administruar bashkëlidhur praktikës së akteve të këshillit të datës 30.11.2023, dhe është përpiluar nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Devoll. Përmendim se ky raport është shënuar si referim ligjor në vendimin nr. 85, datë 30.11.2023, (Raport tekniko-ekonomik nr. 2993, datë 26.09.2023), si dhe në pikën 3, të këtij akti.

Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit që i përket Akt-Konstatimit (fleta nr. 26-27, pika 14), për vendimin nr. 86, datë 30.11.2023, të Këshillit të Bashkisë Devoll, me objekt: “Dhënie miratimi, për dhënie me qira të sipërfaqes prej 33 ha, në ngastrën me numër pasurie 1878, në ekonominë pyjore kullosore Bilisht” ku citoni se, vendimi nr. 86/2023 është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut në mungesë dokumentacioni, a) Procesverbali i mbledhjes; b) Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqes në pronësi publike, të Bashkisë Devoll, sqarojmë si më poshtë: Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, pasi krahasoi vendimin nr. 86/2023, dhe dokumentacionin bashkëlidhur tij, konstaton se bashkë me aktet e këshillit bashkiak Devoll të miratuara në mbledhjen e datës 30.11.2023, është përcjellë edhe një kopje e procesverbalit të mbledhjes të mbajtur me shkrim nga Sekretari i Këshillit, (në tre faqe, të cilin e kemi dërguar bashkë me observacionin). Sa i përket raportit-tekniko ekonomik, i cili nuk ndodhet i administruar bashkëlidhur aktit nr. 85/2023, sqarojmë se ky raport u gjend i administruar bashkëlidhur praktikës së akteve të këshillit të datës 30.11.2023, dhe është

përpiluar nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Devoll. Ky raport është shënuar si referim ligjor edhe në vendimin nr. 86, datë 30.11.2023, (Raport tekniko-ekonomik nr. 2994, datë 26.09.2023), si dhe në pikën 3 të këtij akti.)

Oëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket dy vendimeve të sipërcituar ku është konstatuar se bashkëlidhur praktikës nuk disponohen raportet tekniko, për të cilat është dhënë edhe konfirmimi i bazueshmërisë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë konfirmohet edhe nga vetë Ju në observacion. Grupi i auditimit nuk është shprehur në asnjë rast se në relacion nuk citohet se bashkitë përkatëse nuk e disponojnë si dokumentacion por ky dokumentacion nuk ndodhet bashkëlidhur praktikës. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 5 procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të publikuar në SPE, nga Prefektura e Qarkut Korçë për vitet 2022-2023 me fond limit në total 1,846,194 lekë pa Tvsh ose 63.1% e vlerës së fondit të prokuruar, janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:

-Në 2 raste nuk argumentohet sasia e kërkuar e karburantit për procedurën me objekt “Furnizimi me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil 10 ppm) me kartë elektronike për sasinë 5,591 litra”, me fond limit 799,858 lekë pa Tvsh viti 2022 dhe “Furnizim me lëndë djegëse për automjetet, Diesel (Gazoil 10 ppm)”, me fond limit 799,528 lekë pa Tvsh viti 2023;

-Në 2 raste janë vendosur kriteret jo në përputhje me shërbimin/investimin e kërkuar, nuk janë të argumentuara dhe çënojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar, për procedurën me objekt “Furnizimi me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil 10 ppm) me kartë elektronike për sasinë 5,591 litra”, me fond limit 799,858 lekë pa Tvsh viti 2022 dhe “Furnizim me lëndë djegëse për automjetet, Diesel (Gazoil 10 ppm)”, me fond limit 799,528 lekë pa Tvsh viti 2023;

-Në 1 rast nga KPVV nuk është publikuar në SPE procesverbali mbi argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, për procedurën me objekt “Blerje pjesë këmbimi dhe vendosje”, me fond limit 40,000 lekë pa Tvsh viti 2022.

-Në 1 rast është shpallur fitues OE me vlerë oferte 959,829.6 lekë me Tvsh në kushtet e mos plotësimit të kërkesave të parashikuara në Ftesës për Ofertë, për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizimi me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil 10 ppm) me kartë elektronike për sasinë 5,591 litra” me fond limit 799,858 lekë pa Tvsh viti 2022;

-Në 4 raste asnjë anëtar i komisionit të marrjes në dorëzim nuk është specialist fushe;

-Në 2 raste mallrat nuk janë bërë hyrje në institucion brenda afateve të përcaktuara në kontratën e furnizimit për procedurën me objekt “Blerje pjesë këmbimi dhe aksesori”, me fond limit 66,666 lekë pa Tvsh viti 2022 dhe “Blerje pjesë këmbimi dhe shërbim vendosje për automjetet e Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë”, me fond limit 140,000 lekë pa Tvsh viti 2023. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” neni 36, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 44, neni 76, pika 2, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 42 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 11. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 26-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Korçë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim

shmangien e mangësive të evidentuara në përlogaritjen e fondit limit, dokumentimin dhe argumentimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave. Në rast se nga operatorët ekonomik nuk respektohet afati për dorzimin e mallrave referuar afateve të përcaktuara në ftesën për ofertë, të bëhet skualifikimi i tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, për vitet 2022-2023 nga Sektori Juridik pranë Prefekturës së Qarkut Korçë nuk është hartuar një regjistër në formë shkresore në të cilin të administrohen aktet ligjore, nënligjore si dhe urdhrat e udhëzimet e nxjerra nga titullari i institucionit. Databaza në programin Excel disponohet vetëm për shkresat për të cilat është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore mbi aktet normative të nxjerra nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në juridiskionin e Prefekturës së Qarkut Korçë, veprime këto në kundërshtim me rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e punës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë miratuar me Urdhrin e Prefektit të Qarkut Korçë nr. 119, datë 15.12.2020, neni 15, gërma “g”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Prefektura e Qarkut Korçë, Sektori Juridik të marrë masa për hartimin e një regjistri në të cilin të administrohen aktet ligjore, nënligjore si dhe urdhrat e udhëzimet e nxjerra nga titullari i institucionit duke përmbytur njëkohësisht edhe detyrimet ligjore respektive.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, për vitet 2022-2023 në total janë 139 vendime të këshillave bashkiak të dërguara nga Bashkitë Korçë, Maliq, Pustec, Pogradec, Kolonjë dhe Devoll për konfirmim të bazueshmërisë ligjore, drejtuar Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë të cilat konsiderohen akte jo me karakter normativ e ndarë kjo 67 vendime për vitin 2022 dhe 72 vendime për vitin 2023. Gjithashtu në disa raste nga Prefekti i Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore për akte të cilat nuk konsiderohen si akte normative por si akte administrative individuale dhe kolektive. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 16, pika 2, Ligjin nr. 44/2015, datë 22.05.2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 3, pika 2 dhe Ligjin nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, neni 2 pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Korçë t’u drejtohet në rrugë institucionale organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit të vet që, pranë institucionit të prefektit duhet të paraqiten për verifikimin e ligjshmërisë, vetëm aktet me karakter normativ.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të verifikimit në vend i akteve të njësisë të vetëqeverisjes vendore për vitet 2022-2023 konstatohet se grupi i punës i ngritur me urdhër të Prefektit të Qarkut Korçë ka zhvilluar takime me sekretarët e këshillave për çdo NJVQV dhe nëpunësit e protokolleve përkatëse. Në lidhje me ecurinë e fazave të tjera të procesit janë dërguar njoftimet planit të kontrollit për verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve normative. Gjithashtu nga grupi i punës janë mbajtur aktet e konstatimit në çdo NJVQV si dhe janë dërguar pranë çdo bashkie shkresat për njohje me akt-kontrollet mbi verifikimin periodik sipas korrespondencës përkatëse shkresore. Për vitin 2022 verifikimi i ligjshmërisë nga grupi i punës është kryer një herë në vit ndërsa për vitin 2023 një herë në gjashtë muaj, ndërkohë që ky proces

duhet të realizohet jo më pak se një herë në tre muaj. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 17, pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Prefektura e Qarkut Korçë të marrë masa për realizimin rregullisht të verifikimeve në vend të akteve normative, duke shqyrtuar me detaje përmbajtjen e tyre dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm shoqërues që garanton ligjshmërinë e vendimarrjes, në mënyrë që të shmangen risqet e pavlefshmërisë së tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, për vitet 2022-2023, nga Prefekti i Qarkut Korçë nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e Organit Këshillues, duke mos realizuar njëkohësisht detyrimin mbi trajtimin apo dhënien e mendimeve mbi problematikat institucionale, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 23, pikat 1-3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Korçë të marrë masa për të vendosur në funksion dhe për të organizuar mbledhje mujore me Organin Këshillues me qëllim diskutimin e problematikave institucionale, për të shqyrtuar dhe dhënë mendime në lidhje me problematikat e përgjegjësive të prefektit të qarkut, duke marrë në konsideratë edhe thirrjen në këto mbledhje të specialistëve të fushave përkatëse në çështje specifike.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se për vitet 2022-2023, në katër raste Prefekti i Qarkut Korçë nuk i është drejtuar gjykatës kompetente duke kërkuar deklarimin e pavlefshmërisë së këtyre akteve të rishqyrtuara si rezultat i problematikave të konstatuara, lidhur me saktësisë e bazës ligjore të evidentuar në këto vendime, përkatësisht:

-Vendimi nr. 21, datë 28.02.2022, i KB Kolonjë “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2022”;

-Vendimi nr. 24, datë 28.02.2022, i KB Kolonjë “Për miratimin e përballimit të shpenzimeve të emergjencave civile të shkatuara nga reshjet e dëborës të datës 29.01.2022, dhe datës 01.01.2022, në territorin e Bashkisë Kolonjë”;

-Vendimi nr. 94, datë 18.11.2021, i KB Pogradec “Për një ndryshim në Vendimin nr. 15, datë 01.03.2017, “Për miratimin e orareve dhe stacioneve për linjat rreth qytetëse”;

-Vendimi nr. 25, datë 27.02.2023, i KB Kolonjë “Për mbulimin e shpenzimeve për përmballimin e fatkeqësisë natyrore, lidhur me kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale të shkatuara nga reshjet e dëborës, erave të forta, temperaturave ekstreme të datës 03.02.2023, në territorin e Bashkisë Kolonjë”. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 16, pika 2, gërma “iii”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Korçë të marrë masa që në vazhdimësi, në rastet evidentimi të papajtueshmëri ligjore për akte të rishqyrtuara, t’i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative, duke kërkuar deklarimin e pavlefshmërisë të këtyre akteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i akteve normative të miratuara nga Prefekti i Qarkut Korçë për periudhën objekt auditimi, konstatohet se janë konfirmuar **13** akte normative,

për të cilat nga bashkitë janë dërguar me mangësi në dokumentacionin shoqërues respektivisht: **5** akte me objekt dhënien me qira të sipërfaqeve (ngastrave) të fondit pyjor kullor pa statusin juridik të pronës, plan vendosjet dhe raportet teknike; **1** akt normativ për dhënien e ndihmës ekonomike pa formularët e aplikimit dhe të përzgjedhjes fitues nga përfituesit e ndihmës ekonomike dhe **7** akte normative për dhënien e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore pa vërtetimin për rënie zjarri, çertifikatat familjare, urdhrat për ngritjen e komisioneve për konstatimin e dëmit, procesverbalet për konstatimin e dëmeve etj.

Veprime këto në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 4, Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2 gërma “i”, dhe Urdhrin nr. 175, datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe Aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, neni 4, pika 1, gërma “b” dhe “c”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Prefektura e Qarkut Korçë të marrë masa që të mos pranojë dhe konfirmojë aktet normative të dërguara nga bashkitë të pa shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm justifikues i cili garanton se vendimmarrja ka respektuar të gjitha përcaktimet ligjore kur jepet në përdorim/shfrytëzim të pasurisë publike, ndihmave ekonomike apo shpërblimet në rastet e fatkeqësive natyrore.

Gjithashtu, të kërkohet nga bashkitë që i gjithë dokumentacioni i dërguar nga bashkitë të jetë i inventarizuar dhe me listën e dokumentacionit që përmban dosja.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, me Vendimin nr. 111, datë 30.06.2022, të KB Korçë është miratuar nisja e punimeve në pronën shtetërore. Dokumentacioni shoqërues për dhënien e bazueshmërisë ligjore është dërguar nga Bashkia Korçë me shkresën me nr. 5995 prot., datë 05.07.2022, administruar nga Prefektura e Qarkut Korçë me praktikën nr. 657 prot., datë 05.07.2022. Referuar nenit 4/1 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, marrim informacion se: “Çdo subjekt, i cili kërkon të pajiset me leje apo të paraqesë deklaratë paraprake për kryerje punimesh, është i detyruar të dorëzojë kërkesën aplikimin për leje apo deklaratën dhe dokumentacionin shoqërues nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve”.

Nga auditimi konstatohet se Këshilli Bashkiak nuk është organi kompetent për miratimin e deklaratave paraprake të punimeve apo lejeve të ndërtimit. Organi kompetent për miratimin e këtyre lejeve është Kryetari i Bashkisë, referuar nenit 12 dhe 13 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Shqyrtimi i aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve kryer me qëllim që të garantohet marrja e sigurisë së lartë se ndërhyrjet e kërkuara respektojnë të gjithë kriteret urbanistik, ndërtimor, të sigurisë, higjienës, etj. Nëpërmjet këtij sistemi, aplikanti ka detyrimin e marrjes së mendimit nga autoritetet e tjera të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Miratimi i lejeve të ndërtimit nga Këshilli Bashkiak nuk garanton siguri se janë shqyrtuar dhe vlerësuar kriteret të ndryshme, duke veçuar ato të sigurisë, si dhe nuk është kërkuar dhe marrë mendimi nga autoritetet e tjera të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Për sa trajtuar më sipër konstatohet se, VKB-ja me nr. 111, datë 30.06.2022, është dërguar pranë Prefekturës së Qarkut Korçë me shkresën nr. 5995 prot., datë 05.07.2022, administruar me praktikën nr. 657/1 prot., datë 07.07.2022, nuk është konfirmuar apo refuzuar nga Prefekti i Prefekturës së Qarkut Korçë, veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016,

neni 16, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Nga Prefekti i Qarkut Korçë të merren masa në vazhdimësi që mos të lejohet kalimin në heshtje të akteve me karakter normativ, por të shprehet lidhur mbi bazueshmërinë ligjore të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, me Vendimin nr. 105, datë 30.06.2022, të KB Korçë me objekt *“Për një ndryshim në Vendimin nr. 137, datë 25.11.2021, “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2022”*, Bashkia Korçë ka kryer një ndryshim në paketën fiskale të miratuar me VKB nr. 105, datë 30.06.2022, duke aplikuar një tarifë nga 200,000 lekë në 20,000 lekë në rastet e zëvendësimit të liçencës bazë 5 (pesë vjeçare) për diferencën e periudhës kohore të papërfunduar, veprim ky i pa parashikuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Nga auditimi konstatohet se reduktimi i nivelit të taksave dhe tarifave vendore është kryer në vitin e fundit të mandatit të Kryetarit të Bashkisë, në kundërshtim me kwrkesat e parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *“Për financat e vetëqeverisjes vendore”* i ndryshuar, neni 5, gërma “d”. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*, neni 9, gërma “b”, neni 35, pika 5, gërma “ç”, neni 54, gërma “f”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *“Për sistemin e taksave vendore”*, i ndryshuar, neni 35, pikat 1-2 dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, *“Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”* i ndryshuar, pika 10. Me shkresën nr. 657/1 prot., datë 07.07.2022, Prefekti i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 105, datë 30.06.2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Korçë të marrë masa për rikthimin, shqyrtimin e akteve normative në fushën e tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarburet dhe derivatet e tyre, të cilat kanë të bëjnë me uljen e tarifave vendore në prag të periudhave zgjedhore me qëllim mos favorizimin e subjekteve të caktuara në vitin e fushatës zgjedhore.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, me Vendimin nr. 120, datë 29.07.2022, të KB Korçë me objekt *“Ndryshimin e kuotës ushqimore të fëmijëve të çerdheve dhe kopshteve me ushqim në qytetin e Korçës”*, është miratimi i ndryshimit të kuotës ushqimore nga 125 lekë në ditë dhe kuotë mujore prej 2,750 lekë në 3,300 lekë. Ndryshimi i kuotës ushqimore është aplikuar për fëmijët e çerdheve dhe kopshteve për grup moshën nga 0 deri në 6 vjeç, ndërkohë referuar Urdhrit nr. 76/1, datë 24.01.2018, *“Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”*, pikat 1-3, ky ndryshim kap grup moshën nga 1 deri në 6 vjeç. Me shkresën nr. 727/2 prot., datë 04.08.2022, Prefekti i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 120, datë 29.07.2022.

b. Me Vendimin nr. 122, datë 29.07.2022, të KB Korçë me objekt *“Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij në Bashkinë Korçë”*, janë miratuar kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor. Në këtë vendim Bashkia Korçë ka përcaktuar kriteret për përzgjedhjen e 10 (dhjetë) anëtarëve të Komisionit Vendor Rinor, ndërkohë që referuar Ligjit nr. 75/2019, datë 04.11.2019, *“Për rininë”*, neni 10, përbërja e këtij komisioni duhet të ishte

maksimalisht me 6 (gjashtë) anëtarë. Me shkresën nr. 727/2 prot., datë 04.08.2022, Prefekti i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 122, datë 29.07.2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10. Rekomandimi: Nga Prefekti i Qarkut Korçë të analizohet situata dhe të merren masa që në vazhdimësi së bashku me Sektorin Juridik, për ato akte të cilat janë të pa bazuara në ligj si ato të natyrës për caktimin e kuotave ushqimore për kopshtet dhe çerdhet, apo ngritjen e këshillave vendor, të kthehen për rishqyrtim drejt Këshillave Bashkiak përkatës për t'u bërë saktësimi i bazës ligjore dhe më pas të shprehet për bazueshmërinë e tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se me Vendimin nr. 8, datë 24.01.2023, të KB Kolonjë me objekt *“Për shprehje dakordësie”*, është miratuar kërkesa për rikonstrukcionin e katit të parë të konviktit në qytetin e Leskovikut (godina me numër pasurie 3/192, ZK 2430) e cila do të përdoret si inkubator agrobiznesi të drejtuar nga gratë në qytetin e Leskovikut duke investuar në infrastrukturë e pajisje, si dhe ofrimit të trajnimeve teknike të grave. Referuar nenit 4/1 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1, është përcaktuar se: *“Çdo subjekt, i cili kërkon të pajiset me leje apo të paraqesë deklaratë paraprake për kryerje punimesh, është i detyruar të dorëzojë kërkesën aplikimin për leje apo deklaratën dhe dokumentacionin shoqërues nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve”*.

Nga auditimi konstatohet se Këshilli Bashkiak nuk është organi kompetent për miratimin e deklaratave paraprake të punimeve apo lejeve të ndërtimit, por Kryetari i Bashkisë, referuar nenit 12 dhe 13 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”*. Arsyeja e shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve është marrja e sigurisë së lartë se ndërhyrjet e kërkuara respektojnë të gjithë kriteret urbanistik, ndërtimor, të sigurisë, higjienës, etj. Nëpërmjet këtij sistemi, aplikanti ka detyrimin e marrjes së mendimit nga autoritetet e tjera të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Miratimi i lejeve të ndërtimit nga Këshilli Bashkiak nuk jep siguri se janë shqyrtuar dhe vlerësuar kriteret e ndryshme, duke veçuar ato të sigurisë, si dhe nuk është kërkuar dhe marrë mendimi nga autoritetet e tjera të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Me shkresën nr. 108/2 prot., datë 06.02.2023, Prefekti i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 8, datë 24.01.2023.

b. Me Vendimin nr. 17, datë 25.01.2023, të KB Korçë me objekt *“Për fillimin e procedurave të dhënies me qira, të ambientit me sipërfaqe 98 m² të ndodhur në Pallatin e Sportit “Tamara Nikolla” pjesë e pasurisë nr. 1/12 ZK 8561, sipas Gen Planit bashkëngjitur”*, Bashkia Korçë ka miratuar nisjen e procedurës për dhënien me qira të ambientit me sipërfaqe 98 m² pjesë e Pallatit të Sportit “Tamara Nikolla” me afat 10 vjeçar. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, *“Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enftëozë apo kontrata të tjera shtetërore”* i ndryshuar, neni 6, sipërfaqja e ndërtesave deri në 200 m² jepet me afat kontrate qiraje deri në një vit dhe jo 10 vjet. Me shkresën nr. 104/1 prot., datë 03.02.2023, Prefekti i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 17, datë 25.01.2023. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Korçë të marrë masa për shqyrtimin e kujdesshëm të dokumentacionit dhe hapave që kanë ndjekur bashkitë në çështjet e dhënien së lejeve të ndërtimit pa kaluar në sistemin e-leje dhe tejkalimin e afateve për dhënien me qira të pasurisë shtetërore, duke mos u mjaftuar vetëm me faktin e bazës ligjore të cituar në vendime apo relacione, por të

verifikohet edhe në mënyrë të dokumentuar se janë ezauruar të gjitha këto përcaktime ligjore, përpara vendimarrjes për përfundimin e procesit.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, me Vendimin nr. 76, datë 26.07.2023, të KB Pogradec me objekt me objekt “Për dhënien e ndihmës financiare z. Sh. B, për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë”, është aprovuar fondi në vlerën 428,636 lekë. Nga auditimi i praktikës u konstatua se ka një parregullsi në përlllogaritjen e preventivit të orendive. Në total preventivi për dëmet e orendive, pajisjeve dhe objektit shkon në vlerën 386,636 lekë ndërsa fondi i miratuar nga Këshilli Bashkiak Korçë është në vlerën 428,636 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016, datë 27.10.2016, neni 16, pika 2, gërma “i”, VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kapitulli III, pika 1, gërma “a”, “b”, “c”, pika 2, gërma “a” dhe “ç”. Me shkresën nr. 694/1 prot., datë 15.08.2023, Prefekti i Qarkut Korçë ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të VKB-së nr. 76, datë 26.07.2023. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Korçë të marrë masa për rikthimin, shqyrtimin e akteve normative në fushën e dhënies së ndihmës financiare për përballimin e fatkeqësive natyrore, të cilat kanë pasaktësi në përlllogaritjen e preventivave të vlerësimit të dëmit, me qëllim dhënien e shpërblimit financiar në përputhje me legjislacionin e emergjencave civile.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Në mbështetje të shkronjës “c” neni 15, “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “Llojet e masave disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me Ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Prefektit të Qarkut Korçë, që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për 11 punonjësit e mëposhtëm:

1. **znj. O. B**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm;
2. **z. D. K**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik;
3. **znj. A. S**, me detyrë Juriste në Sektorin Juridik;
4. **znj. S. M**, me detyrë Juriste në Sektorin Juridik;
5. **znj. L.B**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara;
6. **z. Gj. T**, me detyrë Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara;
7. **znj. M. Z**, me detyrë Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara;

8. znj. F. R., me detyrë Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara;

9. z. Z. B., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave;

10. L. M., me detyrë Specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave;

11. A. Xh., me detyrë Specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave.

Për problematikat e përbashkëta, në cilësinë e grupeve të punës për dhënien e konfirmimit mbi bazueshmërinë të akteve të organeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore të pabazuara në ligj për 6 raste për vitet 2022-2023.

B.1. Për të gjithë punonjësit e tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të auditimit, **lihet në kompetencë të Prefektit të Qarkut Korçë**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

B.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për dy ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara ekzistojnë, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e masës disiplinore:

1. znj. M. G., me detyrë ish-Sekretar i Përgjithshëm për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 20.07.2022.

2. z. P. P., me detyrë ish-Specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 08.01.2024. Për 2 punonjësit e mësipërm masa disiplinore do të ishte “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”.

B.3. Mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 5 të Ligjit nr. 107, datë 27.10.2016, “Për Prefektin” dhe Urdhrin nr. 175, datë 09.07.2020, të Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Prefektit të Qarkut si dhe aneksin i të rregullave për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, **i rekomandojmë Ministrit të Brendshëm**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për Prefektin e Qarkut **z. N. J.**, për mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative dhe mungesës së administrimit të dokumentacionit tekniko ligjor për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në zbatim të gërma “a” nenit 8, dhe neni 16 të Ligjit nr. 107, datë 27.10.2016, “Për Prefektin”, trajtuar gjerësisht në faqet 38 - 93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.